



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETAR I KKT

Z. EDI RAMAS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGjisë

Znj. BELINDA BALIUKU

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Z. Ornildi Demollari

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak

Nr. 51, Datë 03.07.2020

Kryetar i Bashkisë

Z. Gëzim Topçiu

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË MALIQ

PLANI I ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 5, Datë 14.10.2020

DPKZHT: Znj. ENKELEJDA JONUSLLARI

KONSULENT: "GAIA S.A. MELETION", Dimitrios Mamounis, Nr. Liç.554







## PËRMBAJTJA

1.	PLANI I PROPOZUAR I PERDORIMIT TE TOKËS.....	5
1.1.	Strukturim e territorit sipas pesë sistemeve territoriale .....	5
1.2.	Strukturim i territorit në zona dhe njësi strukturore .....	7
1.3.	Propozim i përdorimit të tokës sipas kategorive dhe nënkategoriave.....	11
1.4.	Zonat e rëndësisë kombëtare .....	15
1.5.	Zonat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe urban .....	18
1.6.	Shpërndarja e popullësisë në territor & Plani i strehimit .....	20
1.7.	Njësitë që i nënshtrohen hartimit të PDV-së .....	22
1.8.	Mënyra e ndërhyrjes në territor .....	24
1.9.	Instrumentet për drejtimin e zhvillimit.....	25
2.	PLANI I SHËRBIMEVE DHE INFRASTRUKTURAVE PUBLIKE .....	27
2.1.	Infrastruktura e transportit.....	27
2.2.	Infrastruktura inxhinierike .....	29
2.3.	Shërbimet sociale.....	32
3.	PLANI I MBROJTJES SË MJEDISIT .....	36
3.1.	Trajtimi i ndikimeve në ajër .....	36
3.2.	Trajtimi i ndikimeve në ujëra .....	37
3.3.	Trajtimi i ndikimeve në peizazh .....	38
3.4.	Parashtrimi i varianteve për zgjidhje të problematikes të hotspot-eve .....	39
3.5.	Parashikimet për shtimin dhe/ose zgjerimin e hapësirave të gjelbra .....	40
3.6.	Konkluzion për trajtimin e ndikimeve mjedisore të propozimeve të Planit .....	41
4.	PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E PPV-SË .....	42
4.1.	Plani i Veprimit .....	42
4.1.1.	Zhvillim e njësive strukturore sipas prioritetit .....	42
4.1.2.	Infrastruktura publike .....	42
4.1.3.	Projekte prioritare / Pilote të zhvillimit .....	44
4.2.	Plani i investimeve kapitale.....	57
4.3.	Ndryshimet në kuadrin ligjor dhe administrative në nivel vendor .....	72
4.4.	Indikatorët e monitorimit për zbatimit të PPV-së .....	73
4.5.	Evidentimi i faktorëve që mund të çojnë në nevojën e rishikimit të PPV-së.....	76
5.	KAPACITETI INSTITUCIONAL.....	77
5.1.	Vlerësimi i shpejtë i kapaciteteve institucionale të Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) të Bashkisë .....	77





5.2. Zhvillimi i kapaciteve dhe marrëveshjet e zbatimit .....	88
ANEKS .....	98
1. DIREKTIVAT/ToR PËR PLANIN SEKTORIAL .....	98
2. DIREKTIVAT/ToR PËR PDV .....	102
3. RAPORTI I DËGJESËS PUBLIKE .....	123
4. RAPORTI I FORUMIT I BASHKËRENDIMIT PËR PLANIFIKIMIN NË NIVEL VENDOR.....	131





## 1. PLANI I PROPOZUAR I PERDORIMIT TE TOKËS

### 1.1. Strukturim e territorit sipas pesë sistemeve territoriale

Strategjia territoriale e propozuar që synon zhvillimin e qëndrueshëm të Bashkisë, e cila do të zbatohet përmes një sërë projektesh strategjike të propozuara dhe pilot (plani i veprimit), riorganizuar formimin ekzistues hapësinor. Kjo sjell si rezultat modifikimin e kufizuar dhe specifik në vende konkrete të gjithë sistemeve territoriale (rurale, natyrore, ujore, urbane dhe infrastrukturore). Për këtë arsy, ndryshimet dhe modifikimet janë të dëshirueshme dhe të domosdoshme pasi ato synojnë:

- përmirësimin e kushteve dhe sigurimin e një standardi të lartë jetese dhe pune për të gjithë popullsinë, e cila pritet të rritet gjatë 15 viteve të ardhshme (shih Tabelën 1.1.1).
- sigurimin e infrastrukturës teknike të nevojshme për heqjen ose zvogëlimin e situatave negative që janë krijuar dhe përmirësimin e situatës ekzistuese,
- shëmangjen e konflikteve dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së përdorimit të tokës,
- forcimin dhe pasurimin e aktiviteteve ekonomike;
- rritjen e mbrojtjes së mjedisit natyror, kulturor dhe të peizazhit.

	Popullsia 2018*	Parashikimi 2023	Parashikimi 2033
<b>GORË</b>	1,565	1,565	1,565
<b>LIBONIK</b>	8,922	8,967	9,102
<b>MALIQ</b>	4,290	4,333	4,465
<b>MOGLICË</b>	951	951	951
<b>PIRG</b>	7,652	7,690	7,807
<b>POJAN</b>	10,864	10,918	11,083
<b>VRESHTAS</b>	7,513	7,551	7,665
<b>Bashkia MALIQ</b>	<b>41,757</b>	<b>41,975</b>	<b>42,638</b>

\* vlerësimi nga PPV

Tabela 1.1.1: Parashikimi i popullsisë për Bashkinë e Maliqit

Shpërndarja e pesë sistemeve në rajonin e Bashkisë paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Sistemi Territorial	Sipërfaqja eksistuese	Sipërfaqja e vlerësuar pas aplikimit të projekteve të propozuara	Përqindja e ndryshimit
Sistemi natyror	52,624 (71.81%)	51,982 (70.93%)	-1.22%
Sistemi ujor	464 (0.63%)	998 (1.36%)	115.16%
Sistemi bujqësor	18,273 (24.93%)	18,356 (25.05%)	0.45%
Sistemi urban	1,691 (2.31%)	1,718 (2.34%)	1.58%
Sistemi infrastrukturor	233 (0.32%)	232 (0.32%)	-0.51%

Tabela 1.1.2: Ndryshtësi i sistemeve territoriale (sipërfaqje në Ha)

Sistemi territorial	Sistemi territorial i	Sipërfaqja (Ha)	Vërejtje



<b>eksistues</b>	<b>propozuar</b>		
Bujqësor	Infrastrukturor	6.66	Ndryshimi rezulton nga zgjerimi i rrugëve ekzistuese dhe hapja e rrugëve të reja, si edhe ndërtimi i infrastrukturave inxhinierike të tjera (p.sh. HEC, riciklimi).
	Natyror	25.80	Ndryshimi rezulton nga kriimi i një zone mbrojtëse të limit Devoll dhe i përronje.
	Urban	205.32	Ndryshimi rezulton nga racionalizimi i kufijve të zonave urbane dhe përcaktim i zonave të reja për strehim, shërbime, industri, ekonomi.
	Ujor	40.68	Ndryshimi rezulton kriimi liqenit artificial për shkak të digës për HEC Mogicë.
Natyror	Bujqësor	180.67	Ndryshimi rezulton nga kriimi i zonave të përshtatshme për strukturat në funksion të blektorisë.
	Ujor	472.84	Ndryshimi rezulton nga kriimi i liqenit artificial për shkak të digës për HEC Mogicë.
	Infrastrukturor	12.34	Ndryshimi rezulton nga zgjerimi i rrugëve ekzistuese dhe hapja e rrugëve të reja.
	Urban	31.00	Ndryshimi rezulton nga racionalizimi i kufijve të zonave urbane.
Urban	Bujqësor	177.68	Ndryshimi rezulton nga racionalizimi i kufijve të zonave urbane si edhe përfshirjen e zonave me struktura në funksion të bujqësisë dhe blektorisë.
	Natyror	22.61	Ndryshimi rezulton nga racionalizimi i kufijve të zonave urbane.
	Ujor	8.10	Ndryshimi rezulton nga kriimi i liqenit artificial për shkak të digës për HEC Mogicë.
	Infrastrukturor	1.43	Ndryshimi rezulton nga zgjerimi i rrugëve ekzistuese dhe hapja e rrugëve të reja si kriimi i terminalit.
Infrastrukturor	Bujqësor	2.93	Ndryshimi rezulton nga mos përdorimi i rrugëve ose për shkak të riprojektimit të tyre ose për shkak të krijeve të liqenit artificial.
	Natyror	5.82	
	Ujor	12.63	

Tabela 1.1.3: Ndryshimet analitike i sistemeve territoriale

Ndryshimi më i madh do të vijë nga zbatimi i projekteve që janë në zhvillim e sipërpara hartimit të PPV dhe nuk është rezultat i tij. Bëhet fjalë për kriimin e një liqeni artificial në kuadër të ndërtimit të HEC, është rezultat i një projektit që kishte ekzistuar dhe së shpejti do të përfundojë dhe do të përfshihet në hartimin e PPV-së. Kjo zonë fizikisht i përkiste sistemeve bujqësore dhe infrastrukturore ndersa tanë është pjesë e sistemit ujor.

Rikonstruksioni i rrugëve të ndryshme që lidhin vendbanimet me njëri-tjetrin, i cili do të kërkojnë disa raste zgjerim ose përmirësim të hapësirës së tyre, konfigurimit të tyre, ka si rezultat konsumin e tokave natyrore dhe bujqësore. Për pjesën tjetër, sistemi urban mirëmbahet dhe zgjerohet në pikat të këçanta përmes forcimit të zonave të mbrojtjes në të dy anët e lumenjve dhe rrjedhave ujore/ përenjve.



Disa sipërfaqe të tokës bujqësore ndryshojnë karakter dhe kryesisht shdërrohen në zona urbane, për shkak të racionalizimit të kufijve të miratuarë të zonave urbane dhe përcaktimit të zonave të reja për strehim, shërbime, industri, ekonomi, akomodim. Edhe pse boniteti i këtyre sipërfaqeve nuk është i njohur, bëhet fjalë për prona që gjenden në kufijtë e vendbanimeve dhe shumë shpesh ose një pjesë e tyre ka ndryshuar karakter (truall) ose ato janë plotësisht të strukturuara. Si rrjedhim, shndërrimi i sipërfaqeve specifike të tokës bujqësore kontribuon në humbjen e sipërfaqeve me prodhimtari të lartë të produkteve bujqësore/blegtorale dhe në copëzimin e tokës. Por përfundimisht, sistemi bujqësor rritet për shkak të përfshirjes së zonave ekzistuese në strukturat në funksion të bujqësisë dhe banesave rurale (të cilat më parë ishin pjesë e sistemit urban), krijimit të zonave të përshtatshme për strukturat në funksion të blektorisë (që më parë ishin pjesë e sistemit natyror) si dhe përmes përmirësimit të tokave të braktisura te lëna djerrë.

Në të njëjtën kohë, duhet të theksohet se ndryshime cilësore do të ndodhin në lidhje me menaxhimin dhe shfrytëzimin e tokave natyrore dhe bujqësore përmes ndërhyrjeve të ndryshme (përmirësim metodash, infrastruktura mbështetëse, kufizim të ndërtimit të rrallë, duke reduktuar burimet e ndotjes, etj).

Sistemi territorial urban është i racionalizuar dhe i organizuar në baza të reja. Zona të zëna kryesisht nga objektet bujqësore janë caktuar në sistemin korrespondues. Ndërkohë, sigurohen hapësira të reja janë për përdorime moderne urbane që do tu shërbejnë qëllimeve strategjike (p.sh. përgatitje, rekreacion, biznes). Në veçanti, zgjerimi i sistemit urban në zonën urbane Maliq-Libonik ka si qëllim, nga njëra anë mbulimin e nevojave të ardhshme për vendbanime dhe nga ana tjetër zhvendosjen ose pritjen e aktiviteteve të reja ekonomike dhe sociale, duke u fokusuar në rolin e qytetit si qendër urbane dhe ekonomike e Bashkisë, por edhe si qendër rurale rajonale. Kështu, është i nevojshëm pozicionimi:

- i shërbimeve sociale të reja dhe/ose plotësuese (p.sh. kulturore, sportive),
- i zonave për pritjen e aktiviteteve ekonomike (p.sh. industriale, tregtare),
- i operimit të një karakteri rajonal me fokus në rekreacion dhe kulturë.

Edhe në sistemin e infrastrukturës do të ketë ndryshime. Në njëren anë, restaurohet venddepozitimi jo sanitar me kthimin e tij në një hapësirë të gjelbër, pa ndërtim, në përputhje me planin e miratuar rajonal të menaxhimit të mbeturinave, nga ana tjetër, propozohet infrastrukturë teknike për t'i shërbyer popullsisë dhe bizneseve (p.sh. impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura).

Disa vepra mbeten treguese dhe merret parasysh ndikimi i zbatimit të tyre në sistemet territoriale. Të tillë janë nga njëra anë projektet komplekse dhe të mëdha të rëndësishë kombëtare, që gjenden ende në nivel konceptimi dhe zhvillimi i të cilave kërkon studime të mëtejshme të detajuara dhe nuk varen nga Bashkia (të tilla si ndërtimi i tubacionit të gazit, ndërtimi i linjësh ekurudhore dhe istacionit dhe përmirësimii SH3 në segment rrugor të myllur) dhe nga ana tjetër projekte lokale të një shkalle më të vogël (p.sh. shpime, rezervuare uji), specifikimet tekniketë të cilave nuk janë finalizuar dhe si rrjedhim lokalizimi i tyre hapësinor nuk është i mundur pasi lokacionet e sakta dhe hapësirat e projekteve teknike do të përcaktohet nga studime më specifike.

## 1.2. Strukturim i territorit në zona dhe njësi strukturore

### Ndarja e territorit në zona

Zonat sipas VKM nr. 686, datë 22.11.2017, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" e ndryshuar me VKM nr. 232, dt. 17.04.2019, formojnë një entitet të vetëm që analizohet në nivel të kategorisë së përdorimit të tokës. Brenda kufijve të një zone, lejonen të jenë më shumë kategori



përdorimi të tokës që i përkasin të njëjtë sistem territorial. Kodi i çdo zone duhet të jetë unik, i dallueshmë dhe në përputhje me Shtojcën II të vendimit të lartpërmendur, kodi i zonës duhet të përfshijë emrin e Bashkisë, pa qenë e nevojshme të duket i gjithë emri, por vetëm dy shkronjat e saj (prsh. Maliq-MQ), kodi i sistemit territorial dhe kodi i kategorisë së përdorimit të tokës, i cili mbizotëron ndaj të tjerëve brenda kësaj zone dhe numri rendor i zonës. Kodet e përdorura të sistemeve territoriale dhe kategorive për këtë emërim të zonave janë siç përcaktohen nga Shtoja I e VKM nr. 686, dt. 22.11.2017, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" e ndryshuar me VKM nr. 232, dt. 17.04.2019. Për shembull, një zonë e cila i përket sistemit urban, në të cilin kategoria kryesore e përdorimit të tokës është banimi do të ketë kod: MQ\_UB\_A\_1.

Për përcaktimin e zonave në Bashkinë e Maliqit u morrën parasysh, përvèç kriterieve të përmendura në nenin 76, si edhe:

- Shtrirja dhe gjendja e sistemeve ekzistuese të tokës, përdorimet ekzistuese të tokës dhe aktivitetet.
- Veprimtaria aktuale ekonomike dhe specializimi.
- Plani strategjik i propozuar me objektivat për mbrojtjen, rritjen dhe menaxhimin e qëndrueshmë të zonave natyrore dhe bujqësore, të burimeve ujore dhe të territorit urban.

Në territorin e Bashkisë dallohen zonat e mëposhtme për çdo sistem territorial:

**Zonat e Sistemit Urban**, përfshijnë të gjitha zonat e banuara që rrethohen nga vija e gjelbër si dhe industria. Këto zona kanë një ose më shumë njësi. Kështu, në varësi të njësisë të cilës i takon një zonë, propozohen zona për banim, shërbime sociale dhe argëtimi, industriale ekonomike, arsimi, shëndetësie, infrastrukturës inxhinierike etj. Në sistemin urban ekzistojnë zona të kategorive të ndryshme. Ekzistojnë zona me karakter specifik siç janë zonat ushtarake ose zonat në të cilat përfshihen pasuritë kulturore, ose shërbime shëndetësore, si dhe zona me karakter të përzier të cilat përbajnjë aktivitete të lidhura me veprimtarinë ekonomike dhe profesionale në të cilat ndodhen ndërmarrje dhe shërbime industriale etj.

Konkretnisht në Bashki gjenden zonat e mëposhtme:

- Zonë me përdorim kryesisht banim, me kod MQ\_UB\_A\_1,2, 3 etc.
- Zonë me karakter të përzier, me kode MQ\_UB\_IE\_1, 2, 3 etc., MQ\_UB\_IS\_1, 2, 3 etc., MQ\_UB\_S\_1, 2, 3 etc., MQ\_UB\_SHA\_1, 2, 3 etc.
- Zonë me karakter specifik, me kode MQ\_UB\_V\_1, 2, 3 etc., MQ\_UB\_ZU\_1, 2, MQ\_UB\_AS\_1, 2, 3 etc., MQ\_UB\_M\_1, 2, 3 etc., MQ\_UB\_SH\_1, 2, 3 etc.,

**Zonat e Sistemit Infrastrukturor**, përfshijnë zona që propozohen për vendosjen e infrastrukturës inxhinierike për t'i shërbyer nevojave të banorëve dhe mbështetjes ekonomike të Bashkisë. Sistemi infrastrukturor i bashkisë përbehet nga katër zona infrastrukturore:

- Zonë e infrastrukturës së transportit, me kod MQ\_IN\_INT\_1.
- Zonë e infrastrukturës energetike, me kod MQ\_IN\_IEN\_1, 2.
- Zonë e infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve, me kod MQ\_IN\_IMB\_1.
- Zonë e infrastrukturës së kanalizimeve, me kod MQ\_IN\_IUK\_2.

**Zonat e Sistemit Bujqësor**, të cilat përfshijnë zonat që kultivohen në Bashki. Bëhet fjalë për zona pjellore të cilat shtrihen përgjatë fushës të Maliqit të cilat mbështesin ekonominë vendase. Propozohen aktivitete ekonomike në ndihmë të bujqësise dhe të blegtorisë, agroturizmit dhe infrastrukturë teknike dhe strehimi me kushte të caktuara ndërtimi në tokë bujqësore duke synuar





mbrojtjen maksimale dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore. Në Bashki ekzistojnë katër kategori zonash:

- Zonë me karakter bujqësor, banim dhe aktivitete ekonomike bujqësore, me kod MQ\_B\_BA\_1, 2, 3 etc.
- Zonë me karakter bujqësor, aktivitete ekonomike bujqësore dhe infrastrukturë mbështetëse, me kod MQ\_B\_EB\_1, 2, 3 etc.
- Zonë me karakter bujqësor dhe aktivitete ekonomike bujqësore, me kod MQ\_B\_B\_1, 2, 3 etc.
- Zonë me karakter bujqësor dhe infrastrukturë mbështetëse, me kod MQ\_B\_IB\_1, 2, 3 etc.

Zonat e Sistemit Natyror, përfshijnë zonat natyrore të Bashkisë, si pyjet, kullotat, shkurret dhe zonat të cilat janë të përshtatshme për zhvillimin e strukturave akomoduese dhe argëtuese në kontekstin e ekoturizmit. Në Bashki ka dy kategori zonash:

- Zonë e tokës natyrore, me kod MQ\_N\_N\_1, 2, 3, etc.

Zonat e Sistemit Ujor, përfshijnë zonat ujore të Bashkisë, si liqenet, lumenjtë, burimet dhe përrrenjtë. Në sistemin ujor ekziston një kategori zone:

Zona e aseteve ujore, me kod MQ\_U\_U\_4, 5, 6.

#### Ndarja e territorit në njësi

Zonat e lartpërmendura dallohen në një ose më shumë njësi, që i korrespondojnë një sistemi të vetëm territorial. Ndarja e territorit në njësi është kryer në bazë të kritereve si p.sh. përdorime, zhvillimi i synuar, etj. Në çdo njësi përcaktohen një ose më shumë kategori përdorimesh të tokës (përdorim i përzier) sipas nënkatgorive/ funksioneve përkatëse.

Kodi për çdo njësi strukturore do të duhet të jetëunik dhe i dallueshëm. Sipas përcaktimeve nga Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit kodit i njësive strukturore sipas të cilave do të ndahen zonat është: "Kodi i bashkisë\_Kodi i Sistemit\_Kodi i Nënkatgorisë së Përdorimit të Tokës\_Nr i zonës/Nr i njësisë". Kodet e nënkatgorive të përdorimit të tokës të cilat janë përdorur për emërtimin e njësive përcaktohen nga Shtojca I e VKM nr.686 dt. 22.11.2017, "Miratimi i rregullores së planifikimit të territorit" e ndryshuar me VKM nr. 232, dt. 17.04.2019. Për shembull, një njësi e cila i përket sistemit urban ku kategoria themelore e zonës të së cilës i përket është banimi dhe nënkatgoria kryesore është banimi me shërbime dhe zona së të cilës përket është zona 1, do të marrë kod: MQ\_UB\_A2\_1/1.

Sistemi Urban përfshin të gjitha zonat e banuara. Bëhet fjalë për zonat që rrethohen nga Vija e Gjelbër si dhe zonat e industriale. Kështu, në varësi të njësisë së cilës i përket një zonë, propozohen aktivitetet qëndrore të qytetit, të banimit, të shërbimeve, aktivitetet sociale dhe rekreative, industriale dhe ekonomike, të arsimimit, të shëndetit, të kulturës, të hapësirave të gjelbëruara, të infrastrukturës inxhinierike, etj. Në sistemin urban bëjnë pjesë 2 kategori zonash të cilat grupohen në kategori njësitë si më poshtë:

«Zonë me karakter të përzier» kjo zonë përbëhet nga 11 kategori njësie të cilat paraqesin një karakter të përzier. Përdorimet më të rëndësishme që hasim në këtë zonë janë banimi, përfshirë shërbimet që i shërbejnë nevojave të përditshme të banorëve, hapësira publike dhe sportive, objekte të arsimit primar dhe mirëqenies sociale, shërbime publike dhe objekte fetare, aktivitete tregtare, objekte rekreacioni dhe akomodimi. Në njësitë në të cilat janë propozuar për të funksionuar si zona industriale aktivitetesh propozohen si aktivitete prodhuase industriale jo





shqetësuese, receptorë të organizuar ekonomik, parqe industriale dhe park logistik. Në njësinë me nënkategoriinë IE2-Industri e rrëndë lejohen industri shqetësuese si miniera (p.sh. Industri përpunimi metalesh, gurore, miniera), objekte të përpunimit të burimeve minerale dhe depo industriale. Në këto zona gjenden njësi me kode:

- MQ\_UB\_A2\_nr.zone/nr.njësie,
- MQ\_UB\_AR1\_nr.zone/nr.njësie,
- MQ\_UB\_AR2\_nr.zone/nr.njësie,
- MQ\_UB\_AR3\_nr.zone/nr.njësie,
- MQ\_UB\_IE1\_nr.zone/nr.njësie,
- MQ\_UB\_IE2\_nr.zone/nr.njësie,
- MQ\_UB\_IE3\_nr.zone/nr.njësie,
- MQ\_UB\_IS2\_nr.zone/nr.njësie,
- MQ\_UB\_IS6\_nr.zone/nr.njësie,
- MQ\_UB\_S1\_nr.zone/nr.njësie,
- MQ\_UB\_S2\_nr.zone/nr.njësie.

«Zonë me karakter specifik» përbëhet nga njësi secila prej të cilave ka një karakter të veçantë. Nënkategori kryesore të përdorimeve të tokës që gjenden në këtë zonë janë të përbashkëta dhe terrene sportive, njësi të arsimit primar, përdorime tregtare dhe zona ekonomike, rekreative dhe të akomodimit, objekte ushtarake, varreza dhe pasuritë kulturore. Në këto zona gjenden njësitë me kode:

- MQ\_UB\_AS1\_nr.zone/nr.njësie,
- MQ\_UB\_AS2\_nr.zone/nr.njësie,
- MQ\_UB\_AS3\_nr.zone/nr.njësie,
- MQ\_UB\_M1\_nr.zone/nr.njësie,
- MQ\_UB\_SH1\_nr.zone/nr.njësie,
- MQ\_UB\_V1\_nr.zone/nr.njësie,
- MQ\_UB\_ZU1\_nr.zone/nr.njësie.

Sistemi infrastrukturor përbëhet nga 4 kategori të zonave të organizuara në njësi si më poshtë:

«Zonë e infrastrukturës energjitike» përfshin të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të plotësuar nevojat energjitike të një zonë. Kjo zonë është e kategorizuar në dy kategori njësie, në të cilat propozohet të ketë si përdorime kryesore, respektivisht, infrastrukturat elektrike dhe hidroenergjitike. Në këto zona gjenden njësitë me kode:

- MQ\_IN\_IEN1\_nr.zone/nr.njësie,
- MQ\_IN\_IEN2\_nr.zone/nr.njësie.

«Zonë e infrastrukturës të menaxhimit të mbetjeve» përfshin një kategori njësi në të cilën propozohet të ketë infrastrukturë për grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave. Në këtë zonë gjendet njësi me kod MQ\_IN\_IMB1\_nr.zone/nr.njësie, MQ\_IN\_IMB2\_nr.zone/nr.njësie.

«Zonë e infrastrukturës të transportit» është 1 kategori njësie dhe përfshin përdorime që lidhen me infrastrukturën e transportit rrugor dhe hekurudhor. Në këto zona gjenden njësi me kode MQ\_IN\_INT1\_nr.zone/nr.njësie.

«Zonë e infrastrukturës të kanalizimeve» është 1 kategori njësie, të cilat kryesisht shfrytëzojnë infrastrukturën e kanalizimeve. Në këto zona gjenden njësi me kode MQ\_IN\_IUK2\_nr.zone/nr.njësie.

Sistemi Bujqësor përbëhet nga katër kategori zonash bujqësore të cilat përqëndrohen kryesisht në Fushën e Maliqit. Këto zona përfshijnë zona që kultivojnë dhe mbështesin ekonominë vendase. Janë propozuar përdorime që lidhen me aktivitetet bujqësore të kombinuara me banimin, infrastrukturën teknike, si dhe njësitë përpunimin e produkteve bujqësore dhe projektet e rikuperimit të tokës që synojnë mbrojtjen maksimale dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore. Zonat e sistemit bujqësor ndahen në njësi si më poshtë:





«Zonë me karakter bujqësor, banim dhe aktivitete ekonomike bujqësore» kjo zonë përfshin një kategori njësie, me përdorimin mbizotërues banimin, bujqësor dhe infrastrukturën e nevojshme mbështetëse për ekonominë rurale. Në këto zona gjenden njësi me kode:

- MQ\_B\_BA1\_nr.zone/nr. njësie,

«Zonë me karakter bujqësor, aktivitete ekonomike bujqësore dhe infrastrukturë mbështetëse» kjo zonë përfshin njësi, me përdorime mbizotëruese që mbështesin aktivitetet ekonomike rurale dhe infrastrukturën rurale si rrjetet e ujitjes dhe kullimit dhe agroturizmi. Në këto zona gjenden njësi me kode:

- MQ\_B\_EB1\_nr. zone/nr. njësie
- MQ\_B\_EB2\_nr. zone/nr. njësie.

«Zonë me karakter bujqësor dhe aktivitete ekonomike bujqësore» është kategorizuar në 1 kategori njësie e cila ka përdorim kryesor toke me qëllim mbështetjen e aktiviteteve ekonomike rurale. Në këto zona gjenden njësi me kod MQ\_B\_B1\_nr. zone/nr. njësie, MQ\_B\_B2\_nr. zone/nr. njësie.

«Zonë me karakter bujqësor dhe infrastrukturë mbështetëse» kjo zonë përfshin një kategori njësie, e cila përfshin infrastrukturen e nevojshme për mbështetjen e kulturave bujqësore. Në këto zona gjenden njësitë me kod MQ\_B\_IB3\_nr. zone/nr. njësie.

Sistemi Natyror përfshin 2 kategori zonash të cilat janë të organizuara në pesë kategori njësish. Kategorizimi i njësisë është realizuar me qëllim menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe zonave me vegjetacion të ulët dhe grupohen në kategori njësi si më poshtë:

«Zonë e tokës natyrore» është kategorizuar në tre kategori njësish, përdorimet e të cilëve mbizotëruese janë pyjet, kullotat, shkurret dhe tokë pa frutë. Në këto zona gjenden njësi me kode:

- MQ\_N\_N1\_nr.zone/nr.njësie,
- MQ\_N\_N2\_nr.zone/nr.njësie,
- MQ\_N\_N3\_nr.zone/nr.njësie,
- MQ\_N\_N4\_nr.zone/nr.njësie
- MQ\_N\_N5\_nr.zone/nr.njësie

Sistemi i ujit përfshin një zonë që kategorizohet në tre kategori njësi të cilat kanë si përdorim liqene, lumenj, përrenj dhe burime. Në këto zona gjenden njësitë me kode

- MQ\_U\_U4\_nr. zone/nr. njësie,
- MQ\_U\_U5\_nr. zone/nr. njësie,
- MQ\_U\_U6\_nr. zone/nr. njësie.



### 1.3. Propozim i përdorimit të tokës sipas kategorive dhe nënkatgorive

Bazuar në nen 76 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 686 dt. 22.11.2017, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit" e ndryshuar me VKM nr. 232, dt. 17.04.2019, zona është pjesë përbërëse e sistemit territorial që detajohet në nivelin e kategorisë së përdorimit të tokës dhe mund të përbajë disa kategori përdorimi toke, pjesë të një sistemi të vetëm territorial. Gjatë procesit të zonimit do të përcaktohen kategoritë përdorimit të tokës, që do të lejohen në secilën zonë, një ose më shumë, (përdorim të përzier). Zonimi merr parasysh, sipas nenit 79, kriteret si më poshtë:

- Harmonizimin e përdorimeve të tokës, brenda një zonë ose midis zonave fqinjë.



- Ruajtjen dhe përmirësimin e karakterit të një zonë dhe harmonizimin e interesave publike dhe private në zhvillimin e saj.
- Përmirësimin e lëvizshmërisë, rregullimin e trafikut dhe sigurimin e aksosit të barabartë për të gjithë.
- Zhvillimin e qëndrueshëm të gjithë territorit.

Territori i Bashkisë së Malit u nda në zona, ku secila zonë u nda në njësitë përkatëse. Në çdo njësi do të lejohet një ose disa kategori bazë e përdorimit të tokës (përdorim të përzier). Të gjitha kategoritë bazë të përdorimit të tokës, prej të cilave do të zgjidhen, parashikohen në nenin 80 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 686, dt. 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit" e ndryshuar me VKM nr. 232, dt. 17.04.2019 me kodet dhe përbajtjen përkatëse si më poshtë:

- Kategoria "Banim (A)", përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksione dhe aktivitete të banimit.
- Kategoria "Shërbime (S)", përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e shërbimeve tregtare, akomoduese dhe zyre.
- Kategoria "Industri ekonomi (IE)", përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e industrisë së lehtë e të rëndë, si dhe funksione ekonomike komplekse.
- Kategoria "Institucione (IS)", përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e administrit publik, shërbimeve publike, sociale, diplomatike, financiare dhe fetare.
- Kategoria "Arsim (AS)", përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e arsimit në të gjitha nivelet: parashkollar, i ulët, i mesëm dhe i lartë, sipas legjisacionit përkatës.
- Kategoria "Shëndetësi (SH)", përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e shërbimit ambulator dhe spitalor, sipas legjisacionit përkatës.
- Kategoria "Aktivite shqoqërore dhe argëtimi (SHA)", përfshin territore dhe struktura në shërbim të aktiviteteve kulturore e sportive, parqe dhe hapësira publike.
- Kategoria "Monumente (M)", përfshin territore dhe struktura, pjesë të trashëgimisë kulturore dhe historike.
- Kategoria "Zona ushtarake (ZU)", përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet ushtarake, sipas legjisacionit përkatës.
- Kategoria "Varreza (V)", përfshin territoret dhe strukturat në shërbim të varrezave.
- Kategoria "Infrastrukturë transporti (INT)", përfshin infrastrukturat e transportit rrugor, hekurudhor, ujor, ajror dhe multimodal; rrjetet e përbëra nga linjat, stacionet dhe struktura të tjera në shërbim të tyre.
- Kategoria "Infrastrukturë energjitike (IEN)", përfshin infrastrukturat e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nga burime hidrike, lëndë djegëse, eolike e diellore, si dhe infrastrukturat e gazifikimit, përfshirë linjat dhe strukturat mbështetëse.
- Kategoria "Infrastrukturë telekomunikacioni (ITK)", përfshin rrjetet, antenat dhe strukturat që mundësojnë telekomunikacionin.
- Kategoria "Infrastrukturë e ujësjellës – kanalizimeve (IUK)", përfshin rrjetet dhe strukturat në shërbim të furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza.
- Kategoria "Infrastrukturë menaxhimi mbetjesh (IMB)", përfshin strukturat në shërbim të grumbullimit, depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta.

Kategoria "Bujqësi (B)", përfshin tokat bujqësore me kultura të përhershme apo sezionale bujqësore, si dhe tokat qërrë, sipas legjisacionit përkatës.





- Kategoria "Infrastrukturë bujqësore (IB)", përfshin infrastrukturën në shërbim të aktivitetit bujqësor që mundëson vadirjen dhe kullimin e tokave bujqësore.
- Kategoria "Ekonomi bujqësore (EB)", përfshin strukturat dhe infrastrukturat në funksion të ekonomisë bujqësore e blegtore, si dhe shërbimet e agroturizmit.
- Kategoria "Bujqësi - Banim (BA)", përfshin banimin në funksion të aktivitetit bujqësor.
- Kategoria "Tokë natyrore (N)", përfshin territoret natyrore, si: pyje, kullota, livadhe, shkurre e të tjera, të paprekura nga aktiviteti njerëzor.
- Kategoria "Ujëra (U)", përfshin të gjithë trupat ujorë: dete, laguna, këneta, liqene, lumenj, përrenj e burime ujore, sipas legjisacionit përkatës.

Për disa prej kategorive të lartpërmendura u përcaktuan nënkatgoritë, të cilat propozojmë të zbatohen në njësitë e formuara nga ky plan, në përputhje me karakterin, veçoritë dhe qëllimin për mbrojtje ose mënyrën e zhvillimit të tyre.

Nënkatgoritë, dallojnë në përbajtjen e tyre, pra, nëse lejohen apo ndalojen disa përdorime të kategorisë bazë apo vendosen disa kufizime. Në tabelën e mëposhtme parashtron nënkatgoritë e përdorimeve të tokës të cilat gjenden në territorin e Bashkisë sipas kategorive bazë:

Kategori	Nenkategori
A.Banim	A2-Banim dhe Sherbime
SHA.Aktivitete Shoqerore & Argetimi	AR1-Hapesira Publike
	AR2-Aktivitete Kulturore
	AR3-Aktivitete Sportive
AS.Arsim	AS1-Arsim Parashkollar
	AS2-Arsim i Ulet
	AS3-Arsim i Mesem
B.Toke Bujqesore	B1-Kultura te Perherëshme
	B2-Kultura Sezonale
BA.Bujqesi + Banim	BA1-Bujqesi - Banim
EB.Ekonomi Bujqesore	EB1-Struktura ne Funksion te Bujqesise
	EB2-Struktura ne Funksion te Blegtorese
IB.Infrastrukturë Bujqesore	IB3-Infrastrukturë Vadirje dhe Kullimi
IE.Industri Ekonomi	IE1-Industri e Lehte
	IE2-Industri e Rende
	IE3-Aktivitet Ekonomik Kompleks
IEN.Infrastrukturë Energetike	IEN1-Elektrike
	IEN2-Hidrike
IMB.Infrastrukturë Menaxhimi Mbetjesh	IMB1-Trajtim Mbetjesh
INT.Infrastrukturë Transporti	INT1-Infrastrukturë Rrugore
IS.Institucionë	IS2-Sherbim Publik
	IS6-Institucionë Fetare
IUK.Infrastrukturë Ujesjelles - Kanalizime	IUK2-Kanalizime
M.Monumente	M1-Monument Kulture
N.Toke Natyrore	N1-Pyje
	N2-Kullote
	N3-Livadha





Kategori	Nenkategorji
	N4-Shkurre
S.Sherbime	S1-Sherbime Akomodim dhe Argetimi S2-Sherbime Tregtare dhe Biznesi
SH.Shendetesi	SH1-Sherbim Ambulator
	U4-Liqen
U.Ujera	U5-Lume U6-Perrua
V.Varreza	V1-Varreze
ZU.Zona ushtarake	ZU1-Infrastruktura Ushtarake

Tabela 1.3.1: Shpjegimi i kodevetë përdorura për nënkatgoritë

Më konkretisht nënkatgoritë e lartpërmendura janë të shpërndara në territorin e Bashkisë si më poshtë:

- Njësitë me nënkatgori kryesore A2-Banim dhe Sherbime, S1-Sherbime Akomodim dhe Argetimi, S2-Sherbime Tregtare dhe Biznesi gjenden kyesisht brenda zonave urbane të bashkisë.
- Njësitë me nënkatgori kryesore AR1-Hapesira Publike gjenden në zonat e urbanizuara të Bashkisë.
- Njësitë me nënkatgori kryesore AR2-Aktivitete Kulturore gjenden në disa nga zonat e urbanizuara të Bashkisë.
- Njësitë me nënkatgori kryesore AR3-Aktivitete Sportive gjenden në disa nga zonat e urbanizuara të Bashkisë.
- Njësitë me nënkatgori kryesore AS1-Arsim Parashkollar gjenden kyesisht brenda zonave urbane të bashkisë.
- Njësitë me nënkatgori kryesore AS2-Arsim i Ulet gjenden në afërsi me vendbanimet e e Bashkisë.
- Njësitë me nënkatgori AS3-Arsim i Mesem gjenden në vendbanimet e Malikit, Pojanit, Lozhanit të Ri, Sheqerasit, të Pirgut etj.
- Njësitë me nënkatgoritë kryesore B1-Kultura te Perhershme gjenden dhe B2-Kultura Sezonale në tokat bujqësore në afërsi me vendbanimet në zonën malore të Bashkisë dhe në pjesën qendrore të Bashkisë ku shtrihen tokat bujqësore.
- Njësitë me nënkatgori kryesore BA1-Bujqesi - Banim gjenden në afërsi me vendbanimet e Bashkisë.
- Njësitë me nënkatgoritë kryesore EB1-Struktura ne Funksion te Bujqesise dhe EB2-Struktura ne Funksion te Blegtorise gjenden në tokat bujqësore afërsi me vendbanimet e Bashkisë.
- Njësitë me nënkatgori kryesore IS2-Sherbim Publik gjenden kyesisht në qzetitn e Malikit dhe disa në qendrat e njësive administrative si Pojani, Pirgu, Lozhani i Ri etj.
- Njësitë me nënkatgori kryesore SH1-Sherbim Ambulator gjenden në zonat e urbanizuara të Bashkisë.
- Njësitë me nënkatgoritë kryesore IE1-Industri e Lehte, IE2-Industri e Rende, IE3-Aktivitet Ekonomik Kompleks gjenden kyesisht në zonën e qytetit të Malikit, përgjatë rrugës nationale SH3 dhe në njësinë Administrative të Pojanit.





#### 1.4. Zonat e rëndësisë kombëtare

Sipas Ligjit nr. 107/2014 dhe nenit 30 të VKM nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit" e ndryshuar, sipas VKM nr. 232, dt. 17.04.2019, objektet dhe zonat me rëndësi kombëtare në Bashkinë Maliq përfshijnë:

- zonat e mbrojtura dhe monumentet e mjedisit natyror
  - zonat e mbrojtura dhe pasuritë kulturore
  - burimet ujore
  - tokën bujqësore
  - rezervat minerale
  - rrjetin bazë të transportit.
  - infrastrukturën e energjisë dhe telekomunikacionit
  - zonat me prioritet për zhvillimin e turizmit
- i. Në vijim listohen zonat e mbrojtura të mjedisit natyror në territorin e Bashkisë:
- Në territorin e Bashkisë gjendet Rezerva Natyrore e Menaxhuar e Krastafillakut (kategori IV) (Rreg. GB nr.1, datë 1977/07/27).
  - Parku Kombëtar i Prespës (kategori II) i shpallur me VKM nr. 80, datë 18.02.1999 "Për shpalljen Park Kombëtar të Prespës dhe peisazh i mbrojtur tokësor/ujor të Pogradecit". Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar Prespa u miratua me Urdhérin e Ministrisë së Mjedisit nr. 1792, datë 09.05.2014.
  - Pejsazhi i Mbrojtur Liqeni i Pogradecit (kategori V) shpallur më VKM nr. 80, datë 18.02.1999 "Për shpalljen Park Kombëtar të Prespës dhe peisazh i mbrojtur tokësor/ujor të Pogradecit". Plani i menaxhimit për peizazhin e mbrojtur u miratua me Urdhérin e Ministrisë së Mjedisit nr. 2026, datë 31.12.2014.
  - Zona e Mbrojtur e Burimeve Natyrore Guri i Nikës (kategori VI), shpallur më VKM nr.102, datë 15.01.1996.

Dy zonat e mbrojtura të lartpëmendura, Parku Kombëtar i Prespës dhe Peizazhi i Mbrojtur Pogradec, janë zona kandidat për në rrjetin Emerald (kodet AL0000003 dhe AL0000019 respektivisht).

Po ashtu, janë shpallur të mbrojtur një seri monumentesh natyrore të Bashkisë me VKM nr.303, dt. 10.05.2019 "Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar, të monumenteve të natyrës shqiptare":

Nr. rendor	Emërtimi	Shënime
1	Piramidat e Tokës së Xhombrit	
2	Bookerimat e Moglicës	
3	Liqenet e Lenies	Sipas Ligjit 81, datë 4.5.2017
4	Ahishtja e Protopapës Opar	"Për zonat e mbrojtura",
5	Pylli i përzjerë i Maliquit (Pylli i fazaneve)	monumentet natyrore i përkasin
6	Ahishtet e Bofjës	kategorisë III dhe kanë zonë
7	Guri i prere	buferike deri në 200m. (neni 17)
8	Sparthi i Osojes Bakullit	





9	Rrobulli i kuq	
10	Rrobulli i Lenies	

Tabela 1.4.1: Monumentet natyrore në Bashkinë Maliq (burimi: VKM nr.303, datë 15.05.2019)

ii. Monumentet e mbrojtura kulturore të Bashkisë së Maliqit (duke përfshirë pasuritë kulturore me vlera arkitekturore dhe arkeologjike) të cila i përkasin kategorisë së mbrojtjes I (Ligji nr. 27, datë 2018 "Për trashëgimin kulturore dhe muzetë"), paraqiten në tabelën e mëposhtme. Në vendbanimin prehistorik të palafiteve në Maliq ose pranë tij, si një nga zonat me rëndësi kombëtare, propozohet krijimi i Muzeut arkeologjik të palafitit të Maliqit, në të cilën do të vendosen objekte të riprodhuara në mënyrë që të tregojë në mënyrë sa më të përafert mënyrën e jetesës të vendbanimit prehistorik. Këtu duhet të theksohet se vendbanimi Prehistorik i Palafiteve është cilësuar pasuri kulturore kategori e parë dhe si i tillë mbrohet nga dispozitat e Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", sipas Neni 5, Pika 36, ku citohet: "*Monument kulture i kategorisë I* është ndërtimi me vlera të spikatura dhe me rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore, i cili ruhet në tërësinë përbërësve të tij arkitektonikë dhe teknikë. Kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme e të brendshme, si dhe zgjidhja planimetrike e funksionalë këtyre monumenteve nuk mund të ndryshohen. Për këtë arsy, çdo propozim/ndërhyrje e bërë në lidhje me këtë monument miratohen në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturorë Materiale (KKTKM), sipas Nenit 77 "Ndërhyrjet e lejuara" të Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë".

Nr.	Emërtimi	Kate-goria	Qyteti/ Fshati	Nj. Admini-strative	Institucioni / Nr. i Vendimit / Data
1	KALAJA E KLOCËS NË FSHATIN KLOCË	I	Klocë	Libonik	1. Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës/ Vendim nr. 6, dt. 15.01.1963 2. Ministria e Arsimit dhe Kulturës/ Vendim nr.1886, dt.10.06.1973
2	KALAJA E KAKAÇIT NË FSHATIN KAKAÇ	I	Kakaç	Pirg	1. Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës/ Vendim nr. 6, dt. 15.01.1963 2. Ministria e Arsimit dhe Kulturës/ Vendim nr.1886, dt.10.06.1973
3	KALAJA E SYMIZËS NË FSHATIN SYMIZË	I	Symizë	Libonik	1. Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës/ Vendim nr. 6, dt. 15.01.1963 2. Ministria e Arsimit dhe Kulturës/ Vendim nr.1886, dt.10.06.1973
4	KALAJA NË FSHATIN PODGORIE	I	Podgorie	Vreshtas	Ministria e Arsimit dhe Kulturës/ Vendim nr.1886, dt.10.06.1973
5	KALAJA NË FSHATIN ZVEZDË	I	Zvezdë	Pojan	Ministria e Arsimit dhe Kulturës/ Vendim nr.1886, dt.10.06.1973
6	KALAJA E GOPESHIT NË FSHATIN MOGLICË	I	Moglicë	Moglicë	Ministria e Arsimit dhe Kulturës/ Vendim nr.1886, dt.10.06.1973
7	KALAJA E GRADISHTËS NË FSHATIN ZEREC	I	Zerec	Moglicë	Ministria e Arsimit dhe Kulturës/ Vendim nr.1886, dt.10.06.1973
8	MURET NË QAFËN E ZVEZDËS NË FSHATIN ZVEZDË	I	Zvezdë	Pojan	Ministria e Arsimit dhe Kulturës/ Vendim nr.1886, dt.10.06.1973
9	VENDBANI MI PREHISTORIK GJATË RRUGËS AUTOMOBILISTIKE NË FSHATIN VASHTËMI	I	Vashtëmi	Libonik	Ministria e Arsimit dhe Kulturës/ Vendim nr.1886, dt.10.06.1973





10	VENDBANIMI PREHISTORIK NË QYQTIN E MALIQIT	I	Maliq	Maliq	Ministria e Arsimit dhe Kulturës/Vendim nr.1886, dt.10.06.1973
11	URA NË FSHATIN GOPESH	I	Gopesh	Moglicë	Ministria e Arsimit dhe Kulturës/Vendim nr.1886, dt.10.06.1973
12	URA NË FSHATIN MOGLICË	I	Moglicë	Moglicë	Ministria e Arsimit dhe Kulturës/Vendim nr.1886, dt.10.06.1973
13	BANESA E QAMIL BEQIRAJT NË FSHATIN	I	Gopesh	Moglicë	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës (Drejtoria e Kulturës)/ Vendim nr.266/1, dt.16.02.1979
14	BANESA E DAJLAN E RUSHAN BASHLLARIT (ISH E MALKË ZVARISHTIT) NË FSHATIN ZVARISHT	I	Zvarisht	Gorë	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës (Drejtoria e Kulturës)/ Vendim nr.266/1, dt.16.02.1979
15	BANESA E RAMADAN KAPLLAN QOSES NË FSHATIN QENCKË	I	Qenckë	Gorë	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës (Drejtoria e Kulturës)/ nr.266/1, dt.16.02.1979
16	BANESA E BEQIR IBRAHIMILLARIT E NAIM PETO NË FSHATIN STRELÇË	I	Strelcë	Gorë	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës (Drejtoria e Kulturës)/ nr.266/1, dt.16.02.1979
17	BANESA E IDAJET E FUAT MIRASHIT NË FSHATIN STRELÇË	I	Strelcë	Gorë	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës (Drejtoria e Kulturës)/ nr.266/1, dt.16.02.1979
18	BANESA E HALIM ISMAIL XHAFERASIT NË FSHATIN POPÇISHT	I	Popçishtë	Moglicë	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, Drejtoria e Kulturës, Vendim nr. 266/1, datë 16.02.1979
19	KULLA E VELI AGOLLIT NË FSHATIN DESMICË	I	Desmicë	Gorë	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, Drejtoria e Kulturës, Vendim nr. 266/1, datë 16.02.1979

Tabela 1.4.2: Pasuritë kulturore në Bashkinë Maliq (burimi: Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore)

- iii. Burimet ujore (mbi dhe nën sipërfaqen e tokës) janë të pasura dhe përgjithësisht në gjendje të mirë. Në këto burime përfshihen lumin Devoll, përrenj të shumtë, liqenj dhe rezervuarë. Zona e mbrojtjes së tyre do të përcaktohet nga PPV sipas Ligjit Nr. 111/2012 "Për administrimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar me Ligjin Nr. 6, datë 20.8.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 111/2012" për administrimin e integruar të burimeve ujore".
- iv. Bashkia përfshin sipërfaqe të mëdha toke bujqësore që i përkasin kategorive I-IV, të cilat ndodhen përgjatë luginës së lumit të Devollit. Ky është një burim me shumë rëndësi për ekonominë vendore dhe kombëtare dhe duhet të mbrohet, në përputhje me legjislatin e posaçëm në fuqi dhe përashtimet që ai parashikon. Pasi aktiviteti bujqësor është një nga pikat kyç për zhvillimin ekonomik të Bashkisë propozohet hartimi i një Plani Strategjik për sëktorin e bujqësisë me objektiv zhvilli i qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe agroushqimor.
- v. Fshati Zvirinë, i cili i u bashkua Programit të Integruar për Zhvillimin Rural (PIZHR - Programi i 100 fshatrave), miratuar me VKM nr.21, datë 12.1.2018 "Për disa shtesa në Vendimin nr. 709, datë 29.10.2014, të Këshillti të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020". Kësaj zone i jepet prioritet për zhvillimin agrokombëtar.
- vi. Bashkia ka rezerva të burimeve minerale dhe janë dhënë të përvetëzimi të cilat janë në fuqi për pjesën lindore të Bashkisë.





- vii. Nga Bashkia kalojnë aksi rrugor kryesor SH3 (Korridori VIII, E-86) dhe aksi rrugor terciar Maliq-Gramsh-Çerrik SH71, përmes të cilët lidhet zona e studimit, qendrat kryesore dhe rrjetet Trans-Europiane. Gjithashtu, ekziston edhe segmenti rrugor SH101 që shkurton aksesin në drejtim të Pustecit dhe Devollit.
- viii. Infrastrukturat me rëndësi kombëtare për prodhimin dhe transmetimin e energjisë përfshijnë nënstacionin e energjisë elektrike të Zemblakut, linjat e transmetimit të energjisë elektrike 110 KV dhe 400 KV, tubacionin e gazit natyror të TAP, si dhe një numër të madh HEC –esh, me fuqi prodhimi të vogël.

### 1.5. Zonat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe urban

Rol vendimtar në realizimin e vizionit dhe zbatimin e objektivave strategjike luajnë zonat e zhvillimit ekonomik dhe urban kryesor, që krijojnë mundësi të reja dhe përbëjnë bazën për rivitalizimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Bashkisë.

Propozohet që këto zona të janë të shumëllojshme, me karakter dhe intensitet të ndryshëm dhe të shpërndara në hapësirë, të orientuara sipas karakteristikave të çdo vendi, me qëllim që të sigurohet një formë më fleksibile dhe më e qëndrueshme e zhvillimit të përshtatur për sfidat e ardhshme dhe ndryshimet e mëdha të mundshme (p.sh. mjedisore, ekonomike).

Organizimi hapësinor i propozuar i Bashkisë parashikon zona më të gjera zhvillimore, nyje që përbëjnë pikat hyrëse dhe polet e tërheqjes së investimeve, si dhe ndërlidhjen e burimeve dhe infrastrukturave brenda dhe jashtë nyjave. Kësaj i shërben dhe pozicioni gjeografik dhe funksional i zones, pasi është pjesë e Politikës të Zhvillimit Rajonal Korçë – Pogradec dhe madje në mesin e aksit që lidh këto dy qendra.

Katër zonat e gjera që mbështesin dhe promovojnë zhvillimin ekonomik të Bashkisë janë:

- Zona ekonomike e qytetit Maliq
- Zonat ekonomike që krijohen në të dyja anët e aksit rrugor SH3
- Fusha e Maliqit
- Zonat me mundësi zhvillimi të formave alternative të turizmit.

Me rëndësi kyçë për zhvillimin e sektorit ekonomik është *zona e propozuar ekonomike* në *zonën e vjetër industriale* të Maliqit, e cila ka një histori të pasur dhe karakter emblematik për të gjithë Qarkun. Por do të ketë dhe një të ardhme po aq interesante. Ripërdorimi i ndërtesave, përforcimi i infrastrukturave ekzistuese dhe të krijuar i të reja, specializimi në sektorin e agroushqimit dhe përpunimit në bashkëpunim me fushën e pasur, ekzistenca e një kuadri të njësuar operativ (p.sh. rregullorja, stimulime, kushtet e zhvillimit) janë faktorët bazë për të krijuar një nyje të shëndetshme dhe inovative të sipërmarrjes që do të tërheqë investimet dhe do të rrisë mundësitë e punësimit. Njëkohësisht do të kontribuojë në rivitalizimin e zonës qendrore urbane, ristrukturimin e sektorit të bujqësisë dhe fitimin e një identiteti të ri dhe reputacionit për të gjithë Bashkinë.

Organizimi i veprimtarisë biznesit në *zona të papërcaktuara ekonomike* përgjatë aksit kryesor rrugor SH3, që do të kenë një karakter të quartë, sistemit të quartë ndërtimi dhe infrastruktura teknike mbështetëse të përmirësuara, do të rrisë konkurrencën e biznesit dhe do të kontribuojë në të reja. Do të kontribuojë në funksionimin e plotë të zonës ekonomike të





Iartpërmendorur në Maliq, në mbështetje të veprimtarisë bujqësore dhe do t'i shërbejë rrjetit të dendur urban që zhvillohet në periferi të fushës.

*Zona bujqësore* në luginën në të dyja anët e lumenit Devoll është pjesë e zonës më të gjërë prodhuese bujqësore të Korçës, një prej më të rëndësishmeve në vend. Menaxhimi i qëndrueshëm i këtij burimi është një prioritet i rëndësisë kombëtare. Promovohen: funksionet dhe aktivitetet përkatëse dhe në përputhje me bujqësinë, duke përfshirë impiantet e përpunimit-standardizimit të produkteve, vepra që do të plotësojnë nevojat përvaditje dhe do të kontribuojnë në përmirësimin e burimeve ujore, reformimi i kulturave-modernizimi i metodave dhe infrastrukturës ndihmëse, mbrojtja dhe promovimi i markave të produkteve lokale cilësore, mbështetja e grupeve të prodhuesve, organizimi i rrjeteve dhe promovimi e prodhimit lokal në tregjet kombëtare-ndërkombëtare.

Zhvillimi i aktiviteteve alternative dhe ekoturizmit në dy zona: rreth liqenit artificial të Moglicës dhe zonës së liqeneve të Malit të Lenies në Gore do të çojë në zhvillimin e qëndrueshëm të pjesës malore të Bashkisë. Orientimi i dy zonave është i përbashkët dhe i ndërlidhur, por kushtet e zhvillimit janë të ndryshme, duke iu përshtatur peizazhit të ndryshëm dhe karakteristikave individuale natyrore. Në zonën e parë aktivitetet do të janë të ndryshme dhe më intensive (p.sh., argëtim, sportet e ujit, hipizëm, surfing) dhe do të vendosen infrastrukturat e nevojshme në vendet e përshtatshme (p.sh. bare, restorante, bujtina, dyqane për shitjen e produkteve vendase dhe të marrjes me qira të pajisjeve, mol), ndërsa në të dytën aktivitetet e fundit do të janë të vogla dhe të kufizuara (p.sh. ecje, vëzhgim) dhe objektet të kthyeshëm dhe jo të përhershëm (p.sh. observatorë, kampe). Janë të drejtuara si ndaj vizitorëve të zakonshëm ashtu dhe ndaj turistëve dhe në ekipe të specializuara për trajnime, studime dhe kërkime shkencore.

Ndërhyrjet në zonat e mbrojtura dhe pasuritë kulturore, si Krastafillaku që është Rezervë Natyrore e Menaxhuar dhe vendbanimi prehistorik në Maliq, do të kenë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e zonës dhe do të funksionojnë si pika tërheqjeje shtesë përvizitorët së bashku me shërbimet e ofruara dhe mallrat në zonën urbane Maliq-Libonik. Ato përfshijnë përcaktimin dhe shënimin – prezantimin e historisë dhe vlerave të tyre, përforcimin e infrastrukturave bazë të shërbimit të vizitorëve, krijimin e kalimeve, funksionimin e një qendre informacioni - infopoint, kontrollin dhe monitorimin e mbrojtjes së tyre. Gjithashtu, Vendbanimi Zvirine që hyn në rrjetin e 100 fshatrave të PIZHR do të funksionojë si pikë promovimi e prodhimit lokal dhe vend i zhvillimit pilot të agroturizmit. Nevojitet përmirësimi i rrjetit rrugor dhe të infrastrukturave publike dhe teknike, si dhe krijimi i hapësirave gjelbra dhe argëtimit në natyrë.

Përveç kësaj, si zona të veçanta të burimeve të shfrytëzueshme konsiderohen:

- Zonat me leje të vlefshme përvizitorëve pasurive minerale në pjesën juglindore të Bashkisë dhe konkretisht në Zemblak - Plasë - Zvezdë.
- Zonat me potencial përvizitorëve prodhimin e energjisë elektrike, nëpërmjet shfrytëzimit ose të ujit, kryesisht atë të digës Moglicë dhe së dyti HEC-ët më të vogla, ose të diellit përmes zhvillimit të kufizuar të parqeve fotovoltaike në zonat fushore dhe gjysmëmalore.

Ndërlidhja e poleve të Iartpërmendura dhe e të gjitha burimeve të mundshme dhe infrastrukturave të veçanta arrihet përmes korridoreve të lëvizjes formale dhe alternative që vazhdojnë në Bashkije fqinje dhe jepin akses në rrjetet e tyre. Këto akset janë:

- Korçë- Libonik- Pirg- Pogradec (SH3)
- Gramsh- Moglicë- Lozhan i Ri- Maliq (SH71)
- Zemblak- Zvezdë- Pustec (lidhja SH3 me SH79)





- Moglicë – Çorovodë (rrugë e propozuar)

Për sa i përket zhvillimit urban, zona e gjerë urbane Maliq-Libonik që shtrihet në lindje deri në Drithas dhe në perëndimderi në Fshat Maliq, vazhdon të jetë poli kryesor për shkak të madhësisë së popullsisë dhe llojit dhe numrit të shërbimeve dhe funksioneve që mbledh dhe të vendeve të punës që ofron. Ndërhyrjet që propozohen për këtë zonë rrisin atraktivitetin e saj. Rivitalizimi urban nëpërmjet rigjenerimit, përmirësimit të kushteve të transportit, krijimi i hapësirave të argëtit të sportive (p.sh. aktivitete sportive ujore, Luna Park) dhe promovimi i pasurive natyrore dhe kulturore do të kontribuojë në masë të madhe për përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve dhe imazhit estetik, duke e bërë njëkohësisht zonën pikë tërheqëse për vizitorët.

Pole po aq të rëndësishme zhvillimi mund të konsiderohen qendrat e njësive administrative, veçanërisht në ato malore Gorë dhe Moglicë shkak të gjeorelievit të vështirë dhe aksosit të tyre të pafavorshëm. Përforcimi i shërbimeve të ofruara, përmirësimi i infrastrukturave ekzistuese dhe rivitalizimi i gjerë urban në qendrat kanë si qëllim krijimin e qendrave multifunksionale që ofrojnë mundësi punësimi më të mira dhe me të shumta dhe shërbim më efikas, madje edhe në zona të largëta, dhe do të mbajnë banorët në vendin e tyre.

#### 1.6. Shpërndarja e popullësisë në territor & Plani i strehimit

Megjithëse vitet e fundit, për Bashkinë Maliq, por edhe për Qarkun Korçë regjistrohet një rënje e popullsisë (me intesitet të ndryshëm në njësitë administrative), vlerësohet se zbatimi i Strategjisë territoriale të propozuar, nëpërmjet realizimit të veprave të programit të veprimit, do të çojë në përmirësimin e kushteve sociale dhe ekonomike, në tërheqjen e vizitorëve dhe të investorëve, në krijimin e vendeve më të mira dhe të reja të punës dhe si përfundim në forcimin e ekonomisë vendase. Për rrjedhojë pritet rritja e mirëqënies dhe zhvillimi i Bashkisë duke ulur tendencat e sotme të rënies, jo vetëm në lidhje me mbajtjen e popullsisë por edhe me zhvillimin e saj gradual. Për më tepër, pritet përmirësim i karakteristikave cilësore të popullsisë (psh. përqindja e popullsisë aktive, treguesi i varësisë) si edhe ndryshim në përbërjen familjare (familje me numër më të ulët anëtarësh).

Parashikimet e popullsisë që janë bërë gjatë fazës së mëparshme të studimit parashikonin një rritje mesatare vjetore të ndryshme për njësitë administrative të Bashkisë: 1% për njësitë administrative më dinamike (Maliq, Libonik, Pojan), 0.80% për njësitë e tjera administrative fushore (Pirg, Vreshtas) dhe 0.50% për njësitë administrative malore (Moglicë, Gorë).

Në bazë të këtyre që përmenden më sipër, hartimi i zonës do të realizohet në bazë të totalit të popullsisë – madhësisë së programuar të 52.000 banorëve. Më analistikisht, për çdo Njësi Administrative popullsia e ardhshme e Bashkisë vlerësohet se do të ndahet si më poshtë vijon:

Njësi Administrative	Parashikimi i popullsisë 2034
MALIQ	5,557
LIBONIK	11,556
POJAN	14,071
PIRG	9,414
VRESHTAS	8,553



GORË	1,782
MOGLICË	1,083
BASHKIA MALIQ	52,016

Tabela 1.6.1:Parashikimi i popullsise per vitin 2034

Popullsia e vlerësuar do të përqëndrohet në zonat e banuara (qytet dhe fshatra) të cilët përfshihen në sistemin territorial urban. Përdorimet kryesore të tokës do të janë ato të banimit dhe të shërbimeve që do t'u shërbejnë nevojave të popullsisë (psh. tregti, argëtim, administratë, arsimim, shëndet, kulturë, sport). Për më tepër, jepet mundësia të zhvillohen shërbime në shërbim të turistëve – vizitorëve (psh. mikëpritje, strehim).

Zonat e banuara ruhen siç janë (ërsa i përket numrit të tyre) përvèç dy fshatrave që janë të braktisura: Lumaj, pjesa më e madhe e të cilit përkon me zonën e përmbytjes së digës së HEC-it Moglicë<sup>1</sup> dhe pak banorë të saj janë shpërngulur tashmë në banesat e tyre të reja në Maliq, dhe Bubuqi, i cili tashmë është një fshat i braktisur. Për fshatrat e tjera malorë që priej të braktisen, vlerësohet se banorët e tyre nuk do të shpërngulen në një projekt afatgjatë dhe pritet të rigjallërohen e të shnderohen në komunitete aktive.

Nuk propozohet ndonjë vendbanim i ri, ndërsa shtrirja e tyre mjafton për mbulimin edhe të popullsisë së re. Ndërkohë, theksohet fakti se kufitjë e tyre ekzistuesë në bazë të Vendimit të KKT nr.5, datë 29.12.2014) korrigohen në vend (zona e gjelbër), duke marrë parasysh elementët ekzistuesë të mjedisit, ata natyrorë dhe artificialë (psh. rrugë, përrrenj, kanale, kufij truallesh). Në disa raste, në varësi të zhvillimit të hartuar dhe rolit të vendbanimeve, futen edhe zona të pastrukturuar në kufijtë e vendbanimeve. Më të mëdha janë sipërfaqet në zonën urbane Maliq-Libonik.

Përsa i përket rezervës së ndërtesave, edhe pse ajo ekzistuese është e mjaftueshme nga aspekti sasior, pritet të ekzistojë nevoja si për ndërtimin e ndërtesave të reja ashtu edhe për përmirësimin apo zëvendësimin e atyre ekzistuese, sipas gjendjes dhe vlerës së tyre. Do të kërkohen banesa të reja për shkak të: (a) vendosjes së familjeve të reja që do të vijnë të banojnë në Bashki për herë të parë (psh. për punë), (b) shpërnguljes së anëtarëve të familjeve ekzistuese (anëtarë të brezave të ndryshëm që deri më sot bashkëjetonin në të njëjtën banesë do të kërkojnë një të re, psh. për shkak të përmirësimit të gjendjes ekonomike) dhe (c) vendosjes së përdorimeve të veçanta (psh. banesë sociale). Gjithashtu, ndërtesa të reja do të ngrihen për përdorime sociale (p.sh. ambulancë, muze) dhe ekonomike (zyra, restorante, fabirka, etj.). Për përmirësimin dhe rehabilitimin e zonave të banuara propozohen strategji të përshtatshme dhe ndërhyrje të zhvillimit urban (shiko. Kapitulli 1.8).

Për më tepër, vlerësohet se një numër i vogël banorësh do të vendoset edhe në sistemin rural, në ato zona ku do të lejohet përdorimi "banesë dhe bujqësi" (BA). Bëhet fjalë për zona përreth vendbanimeve, ku tashmë janë ngritur ndërtesa brenda sipërfaqeve bujqësore, me qëllim përdorimin e tyre si banesë e përhershme apo sezionale.

Nevojat për stehim social në Bashkinë Maliq janë të rëndësishme, në bazë të të dhënave që janë identifikuar dhe vlerësuar gjatë Fazës së Parë. Kryesisht, bëhet fjalë për rastet e familjeve me nevojë për stehim emergjent ose nevojë për ndërhyrje në banesat e amortizuara. Bashkia ka siguruar financim për ndërtimin e ndërtesave sociale, që do të mbulojë një pjesë të rëndësishme të nevojave

<sup>1</sup> E njëjtë situatë vlen edhe për pjesën më të madhe të fshatit Nikolarë.





dhe ky fakt është në proces përzgjedhjeje të përshtatshme të pozicionit në qytet dhe hartimit të nevojave përkatëse. Me qëllim përbushjen e kërkesave të tjera, do të kërkohet krijimi i ndërtesës/ndërtesave së re/të reja ose marrja e apartamenteve në ndërtesa të reja. Në vija të përgjithshme, burimet e pamjaftueshme ekonomike të Bashkisë përbëjnë pengesë për zhvillimin e një programi të integruar strehimi. Zbatimi i mjetit të intensitetit të ndërtimit me kushte në zona konkrete të pronësisë private do të mund të përbënte një mjet alternativ për sigurimin e banesave sociale (shiko gjithashtu Kapitulli 1.9).

### 1.7. Njësitë që i nënshtrohen hartimit të PDV-së

Bazuar në Ligjit Nr. 107, datë 31.7.2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, dhe VKM Nr. 686, datë 22.11.2017, "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit te Territorit" e ndryshuar, sipas VKM nr. 232, dt. 17.04.2019, janë përcaktuar njësitë ose grupet e njësive, për të cilat duhet të hartohej Plani i Detajuar Vendor (PDV). Këto plane hartohen me nismë publike ose private në zona të cilat janë:

- a) një njësi strukturore;
- b) disa njësi strukturore bashkë;
- c) çdo zonë me prioritet për zhvillim, e përcaktuar si e tillë në planin e përgjithshëm vendor të territorit.

Plani i Detajuar Vendor hartohej me qëllim<sup>2</sup>:

- a) zhvillimin dhe/ose rizhvillimin e një njësie;
- b) rigjenerimin/ripërtëritjen urbane;
- c) ndërtimin e infrastrukturave publike;
- d) ndryshim të përdorimit të tokës dhe kushteve të zhvillimit;
- e) investime publike që ndikojnë në infrastrukturë apo shërbimet publike që ndikojnë në ndryshimin ose rishpërndarjen e treguesve të zhvillimit;
- f) programe të transferimit të së drejtës për zhvillim dhe të intensitetit me kushte.

Në përgjithësi, PDV propozohet në njësitë, ku presioni i zhvillimit pritet të rritet, përmes ndërhyrjeve hapësinore kryesisht në formën e rizhvillimit, rigjenerimit dhe urbanizimit. PDV konsiderohet si mjeti më i përshtatshëm për organizimin e hapësirave të qëndrueshme urbane dhe sigurimin e infrastrukturës së nevojshme dhe i integrimit normal në rrjetin urban dhe ndërlidhjen me funksionet e tjera urbane. Madhësia e zonës për PDV varet nga lloji dhe kushtet e zhvillimit të planifikuar: përdorimet, dendësia, intensiteti i ndërtimit, morfologjia urbane. Propozohet që njësitë për PDV të kenë madhësi të ndryshme, madje edhe të vogla, që të janë fleksibël dhe të lehtë për t'u menaxhuar. Për përcaktimin e kufijve të tyre duhet të ndiqen kufij sa më të qartë dhe të qëndrueshëm (ekzistues ose të propozuar), përgjithësisht elemente natyrore si rrugë, vija ujore, zona pyjore etj.

A. PDV do të përcaktojë kushtet e ndërtimit dhe të zhvillimit të njësisë në të cilën zbatohet. Në veçanti, aksi kryesor i zhvillimit të Bashkisë së Malit janë akset e rigjenerimit ekonomik dhe atij urban. Në këtë kontekst, përgjjidhet zhvillimi përmes PDV të disa nga zonat kryesore të zhvillimit ekonomik, promovimit të turizmit, si dhe në disa pjesë të zonës urbane ku propozohen projekte rehabilitimi dhe ndërhyrje. Më konkretisht, është propozuar që nëpërmjet PDV të zhvillohet zona

<sup>2</sup> Pika a, b, c: janë bazuar në nenin nr. 22 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.7.2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar / Pika ç, d, dh: janë bazuar në nenin nr. 68 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 686, datë 22.11.2017, "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit te Territorit"





ekonomike në qytetin e Maliqit, e cila do të vendoset në njësitë me kodet: MQ\_UB\_IE1\_14/1 & MQ\_UB\_IE1\_29/1.

Zona shtrihet në veriperëndim të bashkisë, në kufijtë e boshtit urban dhe pranë lumit Devoll. Këto njësi sipas situatës aktuale përbëjnë zonën e vjetër industriale të qendrës së bashkisë me përdorime toke ne vijim me Aktivitetin Ekonomik Kompleks. Ka të bëjë me një vendndodhje me pozicion kyç, i cili funksionon pjesërisht, pa u shfrytëzuar plotësisht përparësitet e tij. Konsiderohet rëndësishëm hartimi i studimit PDV në këtë zonë, me qëllim konsolidimin dhe promovimin e profilit ekonomik të qytetit, pasi në të do të përfshihen objekte biznesi, të cilat do të përmirësojnë karakterin e zonës, si edhe do të kenë impakt pozitiv dhe jashtëzakonisht të rëndësishëm ekonomik dhe social, si për bashkinë ashtu edhe për gjithë rajonin. Në mënyrë të veçantë, organizimi dhe zhvillimi i një zone ekonomike me theks të veçantë në sektorin e përpunimit të ushqimit ka për qëllim në:

- stimulimin e ekonomisë dhe aktivitetit të investimeve në bashki;
- forcimin e daljes përtëj rajonit dhe konkurrencës së baskisë;
- krijimin e vendeve të reja të punës;
- përmirësimin e promovimit të produkteve vendore dhe rritjen e eksporteve;
- përmirësimin e një zone urbane joaktive dhe të degraduar.

B. Propozohet zhvillimi përmes PDV në zgjerimin dhe urbanizimin e një zone të re në qytetin Maliq, Aktivitete sportive dhe aktivitete sportive ujore dhe zonë me shërbime akomodimi dhe argëtimi në ndihme të parkut përgjatë lumit të Devollit. Propozimi ka të bëjë me njësitë me kodet:

- MQ\_UB\_AR3\_110/1
- MQ\_UB\_A2\_108/1
- MQ\_UB\_A2\_108/2
- MQ\_UB\_A2\_108/3
- MQ\_UB\_A2\_110/2
- MQ\_UB\_S1\_110/1
- MQ\_UB\_S1\_115/1

Zona për zgjerimin urban në qytetin e Maliqit propozohet tek pjesa verilindore, pranë hyrjes së fshatit Libonik dhe lumbit Devoll, dhe perëndimore të qytetit të Maliqit, pranë zonës industriale. Zonat të cilat porpozoohen për urbanizim gjenden në aksin rrugor SH71. Zona e parë mbulohet nga sistem natyror dhe bujqësor, si edhe aktivitete sportive, me organizim jo adekuat. Zona e dytë përfshin kompleksin e banimit për banorët e prekur nga konstruksioni i HEC Moglicë dhe disa banesave të tjera, ndërsa pjesa tjetër nuk përdoret aktualisht për asnjë funksion.

Zhvillimi e zonave përmes PDV përfshihet në kuadrin e rivitalizimit urban të bashkisë me synim të sigurohet planifikim i integruar dhe i unifikuar, me pëprfshirjen e parimeve mjedisore. Kjo do të ndihmojë në përbushjen e nevojave të ardhshme të vendbanimeve dhe pritjen e aktiviteteve të reja ekonomike dhe sociale. Përfitimet që rrjedhin nga zhvillimi dhe zbatimi i PDV për zgjerimin urban në Maliq kanë lidhje me synimet si:

- Zhvillimi urban i balancuar i qytetit sipas parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm hapësinor
- Krijimi i standardeve të larta të banimit dhe qëndrueshmërisë për banorët
- Rritja e multifunksionalitetit dhe atraktivitetit të selisë për të tërhequr një rrymë të re vizitorësh.

C. Propozohet zhvillimi përmes PDV e zonës të parkut argëtimi - Luna Parkut në qytetin e Maliqit. Propozimi ka të bëjë me vendosjen e rigjenerimit në njësinë me kod: MQ\_UB\_AR1\_114/1.





Ka të bëjë me pjesë toke përgjatë aksit SH71, nga hyrja perëndimore e qytetit, me një sipërfaqe të pashfrytëzuar prej rreth 2.7 hektarësh. Situada ekzistuese në zonën e përgjedhur për rigjenerim urban është brenda kufijve urban, me mbulim të vendbanimeve të përgjithshme, por nuk përfshin një grup ndërtesash. Pozicioni është veçanërisht i rëndësishëm, favorizon veçanërisht zbatimin e propozimit, pasi një infrastrukturë e tillë plotësuese, nxit karakterin multifunksionale të qendrës. Zhvillimi i parkut përmes studimit të PDV do të ofrojë avantazhe të konsiderueshme në rajon, si përfizionominë dhe estetikën e peizazhit ashtu edhe në mirëqenien e banorëve. Në këtë mënyrë, mund të arrihen objektivat themelore për përmirësimin e vendit dhe forcimin dhe zhvillimin e ekonomisë lokale, duke përfshirë:

- Përmirësimin estetik të peizazhit urban
- Përmirësimin dhe promovimin e identitetit turistik të zonës
- Rritjen dhe shtimin e numrit të vizitorëve

#### 1.8. Mënyra e ndërhyrjes në territor

Menyrat e ndërhyrjes paraqesin rruggën që do të ndiqet për ruajtjen, përmirësimin apo ndryshimin e gjendjes ekyistuese të Bashkisë në fjalë (rigjenerimin, dendësimin, rizhvillimin, konsolidimin, konservimin dhe urbanizimin), duke u mbështetur në elemente sasiore dhe cilësore. menyren për ruajtjen, përmirësimin apo ndryshimin e gjendjes duke u mbështetur në elemente sasiore dhe cilësore. Plani i Zhvillimit përban terma të krijuara sipas përkufizimit ligjor dhe regullores të planifikimit. më konkretisht, përkufizimet për mënyrat e ndërhyrjeve paraqiten më poshtë:

**Rizhvillim:** është procesi i zhvillimit dhe i rindërtimit të një territori, i cili është i ndërtuar, por i degraduar dhe kryesisht me mungesa të funksioneve kryesore.

Dendësim është i rritjes së dendësisë së ndërtimit brenda një territori të caktuar, duke promovuar përdorimin më eficient të tokës, si dhe të rrjeteve të shërbimeve dhe infrastrukturave. Mbushje Urbane është një formë e dendësimit ku procesi kryesor është ai i mbushjes së parcelave bosh/të pandërtuara me ndërtim të reja dhe me tregues zhvillimi të ngjashëm me ato që ekzistojnë në zonë. Pra, treguesit në nivel zone do të rriten, por treguesit në nivel parcele mbeten të njëjtë me ata të parcelave që kanë ndërtimë në momentin e mbushjes. Përgjithësisht, ruhet karakteri apo tipologjia e ndërtimit dhe ajo urbane. Ndërhyrjet infrastrukturore janë përmirësuese, por jo thelbësore.

**Urbanizim** është procesi i ndërhyrjes në territor nëpërmjet zhvillimeve të reja, i cili sjell ndryshime të strukturës së popullsisë dhe territorit, në funksion të rritjes së sistemit urban.

**Konsolidim** është procesi i zhvillimit të territorit, i cili ka për qëllim përmirësimin dhe forcimin e infrastrukturës së zonës së urbanizuar ekzistuese dhe të propozuar, duke nxit ndërtimin brenda zonave të urbanizuara. Gjithashtu nënkategori të konsolidimit merren parashysh dhe mënyrat e ndërhyrjes si mëposhtë:

- Zhvillim është procesi i ndryshimit të territorit përmes ndërtimeve të reja, të shoqëruara edhe me infrastrukturat përkatëse. Në raste të veçanta, zhvillimi mund të përfshijë vetëm programin e pajisjes së zonës me infrastruktura, duke tërhequr kështu investitorë për ndërtime private. Zhvillimi ndikon në ndryshimin e vlerës të tokës dhe, përgjithësisht, e ngre atë.





- Një nënkategori e cila përfshihet në konsolidim është ristrukturimi. Ristrukturimi për infrastrukturat, ku janë të degraduara ose të dëmtuara dhe riparimi nuk është i mjaftueshëm. Veç ndërhyrjeve strukturore, mund të ndryshohen edhe parametrat e infrastrukturës në fjalë. Rruga, për shembull, mund të zgjerohet dhe të pajiset me elemente sigurie shtesë etj.
- Pastrim i zonave nga ndotës me metoda fizike e biologjike, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe kriesave të tjera. Pas pastrimit, zonat kthehen në gjendjen natyrore ose kriohen hapësira të gjelbra ose sportive në bazë të nevojave dhe karakteristikave të zonave përreth.

**Rigjenerim:** është procesi i përmirësimit të kushteve ekonomike, fizike, sociale dhe mjedisore të një territori apo ndërtimi. Në këtë kategori i nënshtrohen nënkatgoria si mëposhtë:

- **Trajtim peizazhistik** mund të realizohet në zona urbane, natyrore dhe bujqësore. Ky instrument përdoret jo vetëm për evidentimin por edhe përmirësimin e vlerave ekologjike e estetike të zonave peisazhistike. Në çdo rast, ky trajtim modifikon karakteristikat e dukshme të zonës, si: paraqitjen e bimësisë dhe elementeve ujore, formave të tokës dhe trupave ujorë, efektet e motit apo mikroklimës etj. Metodat që përdoren janë: krijim i korridoreve biologjike, ripillyëzime, mbjellje bimësh në një formacion të caktuar, rehabilitim dhe restaurim mjedisor, zbutje ose eleminim i fragmentimit të matricës natyrore ose komponentëve të ekosistemit, rikrijim ose restaurim i zonave ripariante dhe brigjeve ujore në tërësi, kombinime të elementeve bimore me ato ujore dhe historike për të krijuar një mesazh apo atmosferë të caktuar.

Konservim parashikon rregullorja e planifikimit, e miratuar me VKM nr. 686 , datë 22.11.2017, "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit te Territorit" e ndryshuar, sipas VKM nr. 232, dt. 17.04.2019, në këtë rregullore ky term thellohet edhe më tej si: Procesi i mbrojtjes/ruajtjes së burimeve natyrore, ekosistemeve dhe funksioneve e shërbimeve të tyre, si dhe zonave e objekteve historike/kulturore/arkeologjike nga zhvillimet e natyrave të ndryshme dhe/ose efektet e zhvillimit në to. Procesi i konservimit nuk nënkupton ngrirje, por shmangje nga aktivitetet dëmtuese/ndotëse. Zonat/objektet të cilat janë subjekt i konservimit mund të përdoren, por në mënyrë inteligente. Masat që merren mund të përfshijnë si vendosje të barrierave e brezave mbrojtëse, ashtu edhe disa nga mënyrat e mësipërme (së bashku ose jo), konkretisht: zbutje, rehabilitim, restaurim, reklamim dhe riparim. Në raste të tjera, ekosistemet lihen thjesht në gjendjen e tyre natyrore për t'i mbrojtur nga ndërhyrjet me karakter dëmtues/ndotës.

Në rastin e trashëgimisë kulturore (sipas legjislacionit përkatës) është vlerësimi i thelbët origjinal të pasurive kulturore nëpërmjet ndërhyrjeve për ndalimin e degradimeve te mëtejshme dhe nxjerrjes në pah të vlerave të tyre. Mund të përfshihen edhe procese restaurimi ose rigjenerimi pa ndryshuar karakterin dhe vlerat e zonës historike në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### 1.9. Instrumentet për drejtimin e zhvillimit

Ligi nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" formulon një kornizë gjithëpërfshirëse për menaxhimin e tokës, siguron instrumentat e planifikimit (p.sh. PDV, plane sektoriale, plane të zonave të rëndësisë kombëtare), mjetet rregullatore (p.sh. rregullat e zhvillimit, përcaktimi i përdorimit të tokës, intensitetet e ndërtimit etj.) dhe mjetet ekonomike për realizimin e tyre. Në veçanti, në nenet 30-36 të këtij Ligji pëershkuhen instrumentet për drejtimin e zhvillimit si:

- Intensiteti i ndërtimit me kushte





- Transferimi i së drejtës për zhvillim
- Zhvillimi i detyrueshëm i tokës
- Pezullimi i zhvillimit
- Servituti publik
- E drejta e transferimit
- E drejta e preferimit

Mënyra dhe procedura e zbatimit të dy pikave të para analizohet më tej në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", (Ndryshuar me VKM nr.672, datë 29.7.2015; nr.1043, datë 16.12.2015; nr.271, datë 6.4.2016; nr.231, datë 21.3.2017; nr.355, datë 19.4.2017); përkatësisht neni 41 flet për intensitetin e ndërtimit me kushte dhe neni 42-44 për Transferimin e të drejtës për zhvillim.

Të gjithë instrumentet e sipërpërmendura janë të ndryshëm midis tyre, por mund të funksionojnë së bashku.

I pari nga instrumentet e mësipërm lidhet drejtpërdrejt dhe me hartimin e PPV-së duke qenë se parashikojnë kushte të caktuara zhvillimi për njesi strukturore të veçanta.

Transferimi i të drejtës për zhvillim është një instrumenti i menaxhimit të tokës që përdoret kur bashkia dëshiron të ketë rritje më të butë në një zonë, duke transferuar të drejtat shtesë të zhvillimit në një zonë tjeter ku është e dëshirueshme për ta zhvilluar atë më tej. Synon ruajtjen e pasurive kulturore, tokës bujqësore dhe asaj natyrore si dhe hapësirave publike duke transferuar "të drejtën për zhvillim" të pronarit tek një vend apo zonë tjeter ku dëshirohet të realizohet zhvillimi (Neni 31 i Ligjit 107/2014 i ndryshuar). Instrumenti i transferimit të së drejtës për zhvillim mund të përdoret në njësitë: MQ\_B\_B2\_107/1, MQ\_N\_N4\_82/1, MQ\_N\_N4\_83/1, MQ\_UB\_A2\_110/2, MQ\_UB\_S1\_110/1, MQ\_UB\_S1\_115/1, MQ\_UB\_AR1\_114/1 dhe MQ\_UB\_AR3\_110/1.





## 2. PLANI I SHËRBIMEVE DHE INFRASTRUKTURAVE PUBLIKE

Integrimi hapësinor i Bashkisë dhe shpërndarja e balancuar e flukseve brenda territorit të saj dhe përmirësimi i eficiencës kohore, uljes të kostos dhe shkurtimit të distancave. Një nga komponentët kryesorë të kësaj faze është studimit programi i shërbimeve dhe infrastrukturës publike dhe ndikimi që ato kanë në territorin e Bashkisë. Planifikimi dhe menaxhimi i tyre është kompleks dhe për këtë arsy posicionimi i tyre është parashikuar që të shëmangj ndërveprimet ndikimet negative midis rrjetave të ndryshme infrastrukturore dhe mjedisit natyror. Qëllimi i studimit është të plotësojë nevojat aktuale dhe të ardhshme, në varësi të popullsisë së vlerësuar për vitin 2033.

Objektivat themelore për sigurimin e infrastrukturës adekuate dhe efikase publike janë:

- Shpërndarja hapësinore e balancuar e përdorimeve të tokës.
- Vendosja e duhur në mënyrë që të shëmangen ndërveprimet e pafavorshme midis rrjetave.
- Plotësimi i nevojave të tanishme dhe të ardhshme (bazuar në parashikimet e vlerësimit për zhvillimin e popullsisë dhe synimin e zhvillimit) me çdo zgjerim të nevojshëm.
- Përmirësimi i cilësisë dhe modernizimi i infrastrukturave ekzistuese.
- Sigurimi i mbrojtjes së mjedisit.
- Sigurimi i lidhjes dhe aksesueshmërisë.

Nevojitet një qasje e integruar që optimizon efikasitetin e rrjetit, mbulon në mënyrë adekuat nevojat, përmirëson standartet e jetesës dhe redukton ndikimet mjedisore.

Infrastruktura teknike publike përfshin të gjithë zonën e bashkisë së Maliqit, objektet ekzistuese dhe të propozuara dhe synon zbatimin e shërbimeve publike në fushat e mëposhtme:

### 2.1. Infrastruktura e transportit

Sistemi i infrastrukturave të transportit që ky plan propozon është synuar të jetë gjithëpërfshirës, miqësor ndaj mjedisit dhe i përshtatur për modelin e ri të propozuar të zhvillimit territorial. Objekti kryesor është të sigurohet aksesi dhe lidhja në të gjithë territorin e Bashkisë. Ndërhyrjet e propozuara bazohen në gjashtë akse:

1. Përmirësimi i rrugëve ekzistuese, me veprime të tilla si përmirësimin e karakteristikave gjeometrike (p.sh. zgjerim, ndërtim të anëve mbështetëse), mirëmbajtjen, shtrimin me asfalt, ndriçimin, sistemim etj. Për sa më sipër propozohet:
  - Në një periudhë afatshkurtër dhe afatmesme mirëmbajtja e rruget kombëtare SH3 dhe aranzhimi i nyjave në pikat e takimit të saj me 11 rruge që lidhin vendbanimet (Veliterne, Shqitas dhe Kakac, Pirg kaj Zvirine, Gurishte, Novosele, Sovjan, Symiz, Podeste, Vlocisht, Kloce dhe Vashtemi, Plase, Zemblak).
  - Përmirësimi i rruget kombëtare SH101 (sinjalistika, konfigurimi i nyjeve dhe akseseve, brrierave mbrojtëse, ndriçimi i rruget brenda vendbanimeve).
  - Aranzhimi i tre nyjave të rëndësishme (SH3-SH79, SH3-SH71-SH101, SH3-SH101).
  - Aranzhimi i nyjes SH79 – të rruget për në Burimas dhe Zvezde.
  - Vendosja e shinjalistikës horizontale dhe vertikale në segmentet e rruget kombëtare SH71 në segmentin deri në Moglicë.
  - Rehabilitimi i rruget kombëtare SH71 nga Moglicë drejt lindjes.
  - Aranzhimi i nyjave të rruget kombëtare SH71 në pikat e takimit të saj me 15 rruge që lidhin vendbanimet (Kodras, Lumaj dhe Peshtan, Nikollare dhe Kukake, Gjinikas dhe Osra).





Popcisht dhe Kucake, Strelce, Selca e Gores dhe Velcan Gore, Zvarrisht, Dolan dhe Lozhan, Mocan, Desmira dhe Qencke, Senisht, Babjen, Marjan dhe Mjaltas, Plovisht, Gjyras, Bicke, Zboq dhe Memel, Beras) dhe asfaltimi i rrugëve, rindërtimi urave-kalimeve të lumenit Devoll.

- Asfaltimi në disa segmente të rjetëve rrugore urbane (p.sh. Maliq, Podgorie, Vreshtas, Beras, Vloçisht, Kolanec).
- 2. Zgjerimi i rrjetit rrugor, me ndërtimin ose përfundimin e lidhjeve të reja rrugore dhe ndërtimin e veprave teknike të nevojshme.
- 3. Krijimi e rrugëve të përshtatshme për lëvizjen e bicikletave dhe këmbësorëve.  
Më specifisht për shtigjeve, propozohet:
  - Krijimi dhe mirëmbajtja e shtigjeve të kembësorëve dhe bicikletash në: njësitë administrative të Moglicës dhe Gorës
  - Sinjalizim dhe mirëmbajtje e shtigjeve ekzistuese
  - Krijim e shtigjeve për këmbësorë dhe bicikletave përgjatë lumenit Devoll në Qytetin e Maliqit.
- 4. Zhvillimi/forcimi e transportit publik bashkiak dhe nderbashkiak.  
Propozohet organizim më optimal i shërbimeve në bashkëpunim midis Bashkisë dhe kontraktuesit privat që ofron shërbime transporti publik. Gjithashtu, propozohet ndërtim i terminalit në qytetin i Maliqit dhe stacionet e përcaktuara gjatë itinerarit të linjës për hipjen apo zbritjen e udhëtarëve.
- 5. Organizimin e duhur të trafikut në qendrën e Bashkisë, si dhe në vendbanimet e tjera, me qëllim që ti shërbejë në mënyrë optimale përdorimeve të tokës/aktiviteteve dhe të përmirësojë kohën dhe cilësinë e lëvizjeve dhe të promovojë lëvizshmërinë e qëndrueshme. Organizimi i trafikut duhet të marrë parasysh të gjitha të dhënat, të tilla si madhësia dhe karakteri i seçilit vendbanim, karakteristikat gjeometrike të rrjetit rrugor ekzistues, përdorimi i tokës, polet ekzistuese e të propozuara të aktivitete sociale, elementet e shquara natyrore dhe kulturore etj. Është propozuar ndryshimi i disa segmenteve rrugore ekzistuese si mbledhës trafiku, të cilat do t'i shërbejnë trafikut me origjinë - destinacion rrugët lokale të vendbanimeve dhe qendrës së qytetit. Përveç kësaj, vëmendje i kushtohet promovimit të rregullave dhe planifikimit për të lehtesuar lëvizjen e këmbësorëve, çiklistëve, fëmijëve dhe grupeve vulnerabël duke përfshirë dhe personat me aftësi të kufizuara për shërbimin e nevojave të tyre të përditshme (p.sh. punë, shkollë, kohën e lirë). E dëshirueshme është organizimi i hapësirave të organizura të parkimit të hapura në kombinim me hapësirat ku janë akomoduar përdime toke të lidhura me shërbimet publike që tërheqin një numër të madh përdoruesish.
- 6. Kompletimi i rrjetit të transportit me infrastrukturë për mjetet e tjera të transportit (përveç atij rrugor). Konkretnisht, propozohet studimi për ndërtimin e linjës hekurudhore në aksin Pogradec - Korçë - Kapshticë, në bazë të Planit Kombëtar të Transportit dhe në koordinim me Greqinë, ku edhe atje është planifikuar ndërtimi i linjës Florina - Kristallopigi.

Bendësinë për investime në rigjenerimin dhe në ngritjen e një sistemi hekurudhor të qëndrueshëm e gjemjë tek objektivat kryesore të dokumenteve strategjike të BE-së në lidhje me transportin: mbi 50% e mallrave që transportohen në rrugë më të gjata se 300 km nëpërmjet transportit hekurudhor dhe detar (30% deri në 2030). PPK-ja propozon ristrukturimin e sistemit hekurudhor në bazë të direktivës 2012/34/CE, e amenduar, ndërtimin e linjave hekurudhore për të siguruar lëvizjen ndërqytetase, krijimin e sistemeve multimodale, lidhja e linjave hekurudhore me portet kryesore



dhe me pikat kufitaredhe me konktretisht për Bashkinë e Maliqit, lidhjen me pikën kufitare me Greqinë dhe Maqedoninë e Veriut nga bashkitë fqinjë. Mundësimi me lidhje hekurudhore i kufirit me Greqinë si një pikë hyrëse për korridorin hekurudhor ballkanik Jug-Veri. Prej këtej mundësohet transporti hekurudhor Selanik-Podgoricë dhe më tej.

Gjatë plotësimit - zgjerimit - përmirësimit të sistemit të transportit, duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për të minimizuar ndikimet mjedisore dhe për të ruajtur peizazhin.

## 2.2. Infrastruktura inxhinierike

Propozimet përimirësimin e infrastrukturës inxhinierike publike përfshijnë të gjithë zonën e bashkisë së Maliqit, objektet ekzistuese dhe të propozuara dhe synon zbatimin e shërbimeve publike në fushat e mëposhtme:

- Infrastruktura e ujësjellës- kanalizimeve
- Infrastruktura e trajtimit të ujërave të ndotura
- Infrastruktura e menaxhimit të mbetjeve
- Infrastruktura e telekomunikacionit

Infrastruktura e energjisë dhe komunikimit kanë rëndësi të veçantë pasi ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrrjetë në vendosjen, zgjerimin dhe lidhjen kohore të një zhvillimi të qëndrueshëm të Bashkisë. Infrastruktura e ujësjellësit dhe kanalizimeve, trajtimi i ujave të ndotura, depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve janë të nevojshmë të vendosen në përputhje me përqëndrimin e popullsisë dhe në plotësim të kërkesave për arritshmëri të përshtatshme.

### Infrastruktura e ujësjellësit

Aktualisht Bashkia e Maliqit siguron furnizimin me ujë për pjesën më të madhe të territorit të saj nëpërmjet rrjetit të ujësjellësit. Gjithësesi në të ardhmen konstatohet nevoja për përimirësimin e nivelit të matjes, rikuperimin e kostos të operimit dhe arritje e furnizimit të pandërprerë 24 orë. Për sa i përket zonave rurale të Bashkisë ka nevojë për investime në shërbimin e furnizimit të ujit në vendbanimet Burimas, Kreshpan, Rrëmbec, Orman, Plassë, Zvirinë, Gurishtë, Symiz. Sa i përket cilësisë së ujit të pijshëm, ato duhet të jenë në përputhje të plotë me kushtet që përcakton VKM nr. 379, datë 25.5.2016 "Për miratimin e rregullores cilësia e ujit të pijshëm".

Pajisja e zonave të banuara me sisteme të kanalizimeve, për largimin e ujërave të ndotura urbane, është një domosdoshmëri sanitare, sociale dhe mjedisore. Kjo ndikon direkt në shëndetin dhe cilësinë e jetës së qytarëve. Përveç largimit në mënyrë të organizuar, një kërkesë tjetër e Direktivës Kuadër të Ujit të BE-së, e cila është traspozuar edhe në legjislacionin shqiptar, është trajtimi i këtyre ujërave, përpara shkarkimit në trupat ujorë. Kjo ndikon, jo vetëm në afërsi të zonës ku bëhet shkarkimi, por krijon ndotje, e cila transferohet edhe në zonat e poshtme të basenit ujëmbledhës. Për trajtimin e ujërave të ndotur urbane ka tre kategori të trajtimit të cilat janë niveli primar, niveli sekondar dhe niveli terciar. Po sipas kësaj direktive kërkohet që për zona me popullsi ekuivalente më të madhe së 2000 banorë të ndërtohen impiante trajtimi, ndërsa për komunitete me popullsi ekuivalente më të vogël se 2000 banorë rekomandohet akomodimi i impjanteve alternative individuale, apo kolektive, kur është e pamundur të bëhet lidhja me impiantin e trajtimit më të afërt.





### **Infrastruktura e kanalizimeve**

Sistemet e kanalizimeve duhet të jenë të ndara, në mënyrë që të ndahen ujërat e ndotura urbane më vete dhe ujërat e shiut më vete. Ndërtimi i rrjetit KUB prpozohet në zonat që sfaqin probleme në njësitet administrative të Libonikut dhe Maliqit. Kjo do të lehtësonë trajtimin e ujërave të ndotura urbane në impiant dhe do të ulte kosotot e operimit të këtyre impianteve në të ardhmen. Duke qenë se sistemet e kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane dhe sistemet e ujërave të shiut shoqërojnë në të shumtën e rasteve infrastrukturën rrugore, është e rëndësishme që këto investime të jenë të integruara edhe me hartimin e projekteve për ndërtimin e apo rehabilitimin të rrugëve brenda zonave të banuara.

Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve dhe trajtimi i ujërave të ndotura urbane përparrë shkarkimit në trupat ujore është një domosdoshmëri për të gjithë territorin e Bashkisë Maliq. Për këtë është bërë planifikimi i zonave të banuara, ku duhet të ndërtohen rrjetet e kanalizimeve. Vendbanimet në të cilat propozohen ndërhyrje në rrjetin e kanalizimeve janë Vloçishti, Pirgu, Kopole dhe vendbanimet e njësive administrative të Maliqit dhe Libonikut që shfaqin probleme.

#### **Infrastruktura e trajtimit të ujërave të ndoturë**

Pozicionimi i impianteve të trajtimit duhet të planifikohet në zonat periferike të qendrave të banuara dhe pranë trupave ujorë, për të ulur kostot e largimit të ujit. Gjithashtu, një nga kriteret që kushtëzon pozicionimin është konfigurimi topografik i zonave të banuara, duke vendosur impiantet mundësishët në pikë më të ulta se ato të qendrave të banuara. Kjo do të mundësonte dërgimin e ujërave të ndotura me vetë rrjedhje deri në impiant. Në zonat ku është e mundur nga konfigurimi dhe kushtet mjedisore rekandomohet të përdoret trajtimi natyral me ligatina. Nje zonë mundet të jetë qyteti i Maliqit me mundësi të shërbejë vendbanimet fqinje si fshat Maliqi, Liboniku, Drithashtë dhe parkut ekonomik industrial.


#### **Infrastruktura e menaxhimit të mbetjeve**

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (Strategjia) është dokumenti kryesor planifikues në fushën e menaxhimit të mbetjeve bashkiake, jo-bashkiake dhe të rrezikshme në Shqipëri. Dokumenti aktual, përfaqëson Strategjinë e rishikuar dhe mbulon periudhën 2020-2034. Kjo Strategji ka si qëllim kryesor të përditësojë politikat dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, si dhe të përshtasë drejtimet strategjike për menaxhimin të integruar të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi, si në nivelin qendror ashtu edhe atë vendor.

Parimi kryesor për menaxhimin e mbetjeve është hierarkia e mbetjeve. Strategjia merr parasysh dhërendësinë e menaxhimit të mbetjeve sipas parimit të ekonomisë qarkulluese për të mundësuar mbrojtjen sa më të plotë të burimeve natyrore dhe rritjen e eficiencës së përdorimit të produkteve. Siç përcaktohet dhe në ligjin Nr.10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, menaxhimi ndjek radhën e mëposhtëme, në zbatim të hierarkisë për Parandalimin (e enerimit të mbetjeve), ripërdorimin, riciklimin, rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve. Bashkia e Malit duhet të përqendrohet kryesisht në ralizimin e objektivave dhe afateve ashtu si ato përcaktohen në VKM nr. 418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim" të nrymave të mbetjeve për të reduktuar sasinë e mbetjeve që do të depozitohen përmes:

~~Optimizmit tē grumbullimit tē mbetjeve~~

~~Sigurinut t  grumbullimit t  diferencuar t  mbetjeve n  burim~~





- promovimit të ripërdorimit të produkteve
- përgatitjes së veprimtarive të ripërdorimit
- pëmirësimit të cilësisë së riciklimit të mbetjeve.

Gjithashtu, sipas të njëjtët vendim, përcaktohet se Njësitë e qeverisjes vendore, brenda datës 31 dhjetor 2020, duhet që, për përgatitjen, ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve të ngurta (ku përfshihen letra, metali, plastika dhe qelqi) të arrijnë objektivin, minimumi në 50% të peshës së përgjithshme të mbetjeve të gjeneruara në vitin 2014.

Zhvillimi i qëndrueshëm i menaxhimit të integruar të mbetjeve nënkupton se burimet natyrore do të përdoren me eficiencë, duke nxitur zvogëlimin e gjenerimit të mbetjeve, ripërdorimin e materialeve të riciklueshme, përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, duke shkaktuar ndikimin më të vogël të mundshëm mbi mjedisin. Shkarkimet nga objektet e trajtimit të mbetjeve dhe landfill-et, duhet të zvogëlohen maksimalisht dhe në mënyrën me eficiente ne aspektin teknik dhe ekonomik.

Përsa i përket depozitimt të tyre, Bashkia Maliq ka në territor e saj administrativ landfillin sanitari i cili është i akomoduar në afërsi të qytetit Maliq dhe shërben të gjithë qarkun e Korçës. Fillimi, rekomandohet aplikimi i sistemit të grumbullimit të mbetjeve me 3 kosha, për mbetjet e riciklueshme të thata, mbetjet organike dhe mbetjet e tjera (të përziera). Fillimi në zonat urbane, qendrat e njësie administrative dhe zonat me zhvillim turistik, do të vijojë gradualisht shtrirja e këtij sistemi në të gjithë zonat e shërbimit sipas përcaktimeve në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve.

### Infrastruktura e telekomunikacionit

Bazuar tek Strategjija ndërsektoriale "Akhenda Dixhitale e Shqipërisë 2015-2020" teknologjitet e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) luajnë një rol të veçantë në zhvillimin e një ekonomie konkurruese të bazuar në njohuri dhe inovacion. Kjo teknologji mundëson sigurimin e një cilësie më të lartë të jetës për qytetarët, ndihmon në lehtësimin dhe efikasitetin e proceseve të biznesit si dhe në rritjen e efektivitetit dhe transformimin e qeverisjes. Zhvillimi i sektorit TIK konsiderohet si një politikë horizontale pasi efektet dhe ndikimet e zbatimit të tij shtrihen mbi të gjithë sektorët socialë dhe ekonomikë të vendit.

Gjithashtu Plani i Përgjithshëm Kombëtar shikon zhvillimin e infrastrukturës dixhitale dhe broadband-in si një prioritet madhor dhe propozon parashikimin e projekteve konkrete në nivel rajonal e vendor, që përfshijnë vendosjen e rrjetit me fibra optike në qytete, të cilat do t'i shërbejnë një zhvillimi afatgjatë të ekonomisë dixhitale. PPK mbështet investimet në rrjetin kombëtar të kërkimit, me qëllim të promovimit të komunikimit me shpejtësi të lartë, që lidh të gjitha institucionet e edukimit dhe institucionet kërkimore shtetërore me rrjetet më të mëdha të kërkimit ndërkombëtar.

Infrastruktura e zhvilluar e komunikimit do të ndihmojë në tjerheqjen e kapitaleve fizike dhe intelektuale në vend. Infrastruktura e komunikimeve elektronike është sot një infrastrukturë e rëndësishëm përgjithshme për të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë së vendit dhe i shërben zhvillimit të një ekonomie dixhitale. Parimi i shtrirjes së kësaj infrastrukturë shkon në linjën e përshkruar më lart: të integrimit të korridoreve infrastrukturore. Kjo nënkupton se në hapësirat e parashikuara për infrastrukturë rrugore apo elektrike duhet të merren parasysh edhe hapësirat e





nevojshme për akomodimin aktual apo në të ardhmen, të linjave të teknologjisë së inovacionit dhe komunikimit.

Konkretilisht në Bashkinë e Maliqit firbat optike janë të shtrira në nivel të pranueshëm në territorin e Bashkisë por nuk mbulojnë të gjithë zonat e urbanizuara. Ky material konsiston në zhvillimin e rrjetit informativ dhe te komunikimit në nivel lokal. Kështu janë përcaktuar akset kryesore rrugore, sheshet, parqet, qendrat urbane, zonat e banuara, etj., të cilët kanë nevojë për këtë shërbim. Për të gjitha akset kryesore rrugore të cilat do të rikonstuktohen në bazë të Planit të Veprimit dhe të parashikimeve të këtij Plani propozohet paralelisht me to të shtrihen dhe fibra optike. Me shtrirjen e infrastrukturës të komunikimit elektronik do shërbehen qendrat e urbanizuara si qyteti i Maliqit, qendrat e njësive administrative dhe zonat me dejtim zhvillimin ekonomik (zonat ekonomike dhe tregëtare) dhe turistik (zonat me përparësi zhvillimin turistik malor në jug dhe liqenor në veri të Bashkisë, në Zvirinë, që eshtë përfshirë në Programin e Intergruar të Zhvillimit Rural "100 fshatrat"). Në këtë mënyrë zonat kryesore dhe dytësore të bashkisë në vijim me zhvillimin ekonomik dhe demografik do të kërkohet infrastruktura e rrjetit të telekomunikacionit e veçantë dhe e përcaktuar vetëm për këto shërbime.

### 2.3. Shërbimet sociale

Çështjet në fushën e mbrojtjes sociale, shërbimet e kujdesit shoqëror ekzistuese dhe ato të propozuara dhe zbutja e varfërisë janë çështje shumë më të gjera se sa vetëm mbrojtja sociale, e cila nuk lidhet vetëm me pagesat dhe me shërbimet e kujdesit shoqëror, por edhe me një gamë të gjerë politikash të tjera, duke përfshirë, në veçanti ato të lidhura me kujdesin shëndetësor dhe me arsimin. PPV do të punojë ngushtë në zbatimin e strategjive ndërsektoriale, në mënyrë që të adresojë çështjet e varfërisë dhe përjashtimit social, siç është dokumenti për politikën e përfshirjes sociale.

Politikë kyçe e Mbrojtjes Sociale është përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara. Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë një reformë të procesit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, i cili synon të përqëndrojë pagesat e aftësisë së kufizuar tek personat me aftësi të kufizuar më të rëndë. Objektivi i përgjithshëm i reformës është krijimi i një sistemi të përgjegjshëm të pagesave të aftësisë së kufizuar, me qëllim vlerësimin e përshkallëzuar të aftësisë së kufizuar, në varësi të shkallës së sëmundjes dhe kushteve sociale. Reforma e shërbimeve të kujdesit social do të ofrojë mbështetje për personat me aftësi të kufizuar për të mbështetur nevojat shtesë që dalin dhe kostot e tyre të mundshme.

Shërbimet e përkujdesit shoqëror luajnë një rol kyç në përmirësimin e cilësisë së jetesës të individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë. Bazuar në analiziën e nevojave për infrastrukturën sociale e cila përmban strukturat arsimore, shëndetësore, strukturat për përkujdesin e femijëve dhe të të mosharve Plani i Përgjithshëm propozon ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës të lartpërmendor në mënyrë që ti shërbejë të gjithë banorëve në territorin e Bashkisë te Maliqit. Më specifiksht në kuadër të përforcimit të shërbimeve sociale propozohen projektet si poshtë:

- Infrastruktura arsimore

Në kontekst të forcimit të infrastrukturës arsimore, propozohen projekte për rikonstruksionin e objekteve shkollore ekzistuese në vendbanimet e Pojanit, Moglicës, Dusharit dhe Maliqit. Zona për





përmirësimin e infrastrukturës së lartpërmendur është 550 m<sup>2</sup> për shkollën Pojan dhe 350 m<sup>2</sup> për shkollën në Maliq. Shumë nga shkollat, sot i shërbejnë një numri të vogël nxënësish, si rrjedhojë rindërtimi dhe përmirësimi i ndërtesave ekzistuese do të sjellë që ato të jenë në gjendje të plotësojnë nevojat e ardhshme të popullsisë, duke pritur një numër më të madh nxënësish dhe në një nivel më efikas. Më konkretisht, një përmirësim i vazdueshëm në infrastrukturën sociale të Bashkisë është edhe rindërtimi dhe sigurimi i infrastrukturës dhe pajisjeve plotësuese në njësitë arsimore konkrete, me qëllim krijimin e strukturave arsimore të nivelit sa më të lartë.

Përveç kësaj, parashikohet ndërtimi i objekteve të reja shkollore në vendbanime ku ka nevojë për shkolla të reja bashkëkohore. Më konkretisht, propozohet të ndërtohet një shkollë e re 9-vjeçare në Zvirine dhe Velçan, një kopsht në Libonik dhe ndërtimi i kopshteve në vendbanimet Sovjan dhe Sheqeras. Të gjitha shkollat e reja do të ndërtohen sipas strukturave arsimore të përcaktuara dhe do të shoqërohen me objekte të përshtatshme si palestra, terrene sportive etj.

Së pari, në lidhje me infrastrukturën ndërtimore, objektet shkollore ekzistuese dhe jo, do të transformohen në mënyrë të përshtatshme për të përbushur dispozitat e nevojshme të sigurisë dhe higjenës, si të personelit arsimor ashtu edhe të nxënësve. Në këtë kontekst, rindërtimi i shkollave, lidhet me përmirësim e ndërtesave ekzistuese dhe modernizimin e pajisjeve shkollore dhe infrastrukturës logjistike të njësive shkollore. Më konkretisht, është e dëshirueshme të krijohet numri i nevojshëm i klasave në secilën njësi shkollore, si bibliotekë, klasë muzike dhe laboratorë teknologjje. Në të njëjtën kohë, është i dëshirueshëm përmirësimi i plotë i objekteve dhe aktiviteteve sportive, në të gjitha nivelet e arsimit, në përputhje me standarde ndërkombëtare të aktiviteteve fizike.

Po aq të rëndësishme janë disa ndërhyrje në shkallë më të vogël, të cilat kontribuojnë për sigurinë dhe cilësinë më të mirë të jetës. Disa nga projektet e propozuara janë riparimi i dyerve, dritareve dhe dyshemeve, heqjes së shkrimeve nga muret, vendosja dhe rehabilitimi i sistemit të ngrohjes. Ndërhyrjet e tjera kanë të bëjnë me mikro-ndërhyrje që plotësojnë infrastrukturën e ndërtimit, vendosja e kangjellave, lidhja e sistemit të kanalizimeve, ndërrimi i pllakave dhe dyshemeve të dëmtuara, mirëmbajtja, përmirësimi i mjedisit përreth, mbjelljet etj.

Përveç kësaj, theksi i veçantë është vënë në investimet në teknologji bashkëkohore. Ndër ndërhyrjet më të përgjithshme të rehabilitimit të shkollave, një pjesë e pajisjeve të reja ka të bëjë me teknologjinë bashkëkohore. Shkollat do të pajisen me kompjutera, aparatura për zyrat, pajisje audio dhe video, dërrasa interaktive dhe më shumë.

Së fundi, një parametër po aq shtrëngues për cilësinë e shërbimeve sociale në fushën e arsimit, përtej pasurimit të infrastrukturës, është shqetësimi për sigurinë. Ekzistonjë çështje të thksuara lidhur me sigurinë e nxënësve nga kriminaliteti i jashtëm, prandaj është e rëndësishme të merren masat e duhura për të kontrolluar dhe parandaluar hyrjen e njerëzve të rrezikshëm dhe tregtarëve të drogës.

- *Infrastruktura shëndetësore*

Përveç të tjerave, janë parashikuar ndërhyrje të rëndësishme në fushën e infrastrukturës shëndetësore, në kontekst të përmirësimit dhe integrimit të infrastrukturës sociale. Infrastruktura ekzistuese ka mangësi të mëdha dhe pamundësi për të plotësuar nevojat e banorëve. Për këtë arsy...



propozohet rindërtimi i ambulances në Bregas, si dhe ndërtimi i ambulancave në vendbanimet që kanë nevojë, midis të cilave edhe në Sovjan. Gjithashtu propozohet rindërtimi i qendrës shëndetësore të selisë me një sërë projektesh përmirësimi dhe nën-projektesh, si dhe mbështetja e saj me personelin e nevojshëm mjekësor.

Projektet sociale që lidhen me ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore kanë për qëllim krijimin e një sistemi shëndetësor efikas dhe ekonomikisht të qëndrueshëm, duke ofruar shërbime cilësore dhe të personalizuara për qytetarët dhe duke u fokusuar në përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve të parandalimit dhe të kujdesit. Në veçanti, përfshihet krijimi i njësive të specializuara shëndetësore dhe të kujdesit të hapur, i cili do të mbështetet nga pajisje të specializuara, si dhe modernizimi dhe përmirësimi operacional i ambulancave ekzistuese.

Projektet për përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore kanë të bëjnë me përmirësimin e stokut të ndërtesave ekzistuese, furnizimin me pajisje dhe mbështetjen me personel për të ofruar shërbimet e nevojshme shëndetësore. Më konkretisht, në kontekstin e përmirësimit të objekteve, parashikohen punime në brendësi të ndërtesave për amortizimet e shumta si dhe funksionimin e normal të mjeteve elektromekanike. Kategoritë kryesore të ndërhyrjeve janë shtrimi i dyshemeve, veshjet e mureve, ndërtimi i tavaneve të varura, rinnovimi i sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve dhe të tjera. Po aq i rëndësishëm është furnizimi i plotë i ambulancave me të gjitha pajisjet e nevojshme mjekësore, mekanike dhe jo-mekanike.

Zbatimi i projektit siguron funksionimin bashkëkohor dhe të sigurtë të ambulancave, ekzistuese dhe të reja, dhe qendrës shëndetësore në aks drejt përmirësimit të efikasitetit të sistemit shëndetësor.

- Banesat Sociale

Gjithashtu, një projekt i rëndësishëm në mbështetje të shërbimeve sociale për qytetarët e Bashkisë është edhe ndërtimi i banesave sociale brenda zonës urbane të Maliqit dhe Libonikut. Projekti është një shtyllë e rëndësishme në arritjen e kohezionit social duke siguruar strehim për grupet sociale në nevojë. Përveç kësaj, krijimi i infrastrukturës të strehimit social, synon të shërbejë si mbrojtje për familjet dhe individët, për rastet kur ata përballen me një problem të drejtpërdrejtë dhe akut të strehimit. Më në përgjithësi, politika e strehimit social është një rrjet i programeve për të plotësuar nevojat e ndryshme të popullsisë, me instrument kryesor stokun e banesave publike, subvencionimin e qirasë dhe kontrollin e tregut. Është një mekanizëm thelbësor i ndërhyrjes përrigjenerimin social ose përmirësimin e zonave veçanërisht problematike të banimit dhe ku mekanizmat e tregut nuk funsionojnë, është i nevojshëm organizimi i ndërhyrjes publike. Në këtë mënyrë, sigurohet për qytetarët e Bashkisës një standard dinjitoz jetese, duke eliminuar sa më shumë që të jetë e mundur çështje që lidhen me tjetërsimin dhe diversifikimin social.

- Kënde lojërash dhe parqe argëtimi

Përfundimisht, në drejtim të ofrimit të një rrjeti të integruar të infrastrukturave dhe objekteve sociale për Bashkinë, një aspekt veçanërisht i rëndësishëm është ndërtimi i mjediseve të hapura për argëtim dhe kënde lojërash në zona të ndryshme urbane në të gjithë territorin e Bashkisë. Konkrektisht, ndërhyrje të tillë propozohen në Libonik, në Moglicë, në Lozhan I, në Pojan, në Podgoricë, në Pirg, në Strelce, në Kolanec, dhe në Vashtëmi.



Ndërkohë që një komunitet zhvillohet, rivitalizohet dhe ndryshon, hapësirat publike urbane mund të sigurojnë një lidhje të përhershme midis identitetit të komunitetit dhe funksioneve evoluese të vendbanimeve. Është një faktor shtypës në kuadrin e rindërtimit dhe rigjallërimit të pëlhorës urbane, pasi parqet dhe këndet e lojrave forcojnë strukturën shoqërore. Në të njëjtën kohë, promovohen aktivitete alternative, lëvizja e këmbësorëve dhe një rrymë e re vizitorësh. Hapësirat që do të zhvillohen në Bashki janë planifikuar të përfshijnë elementin e gjelbër, duke përmirësuar cilësinë e mjedisit si estetikisht edhe ekologjikisht.

Parqet dhe këndet e lojrave që do të krijohen, do të karakterizohen nga shtigje për ecje, mjedise çlodhje dhe rekreacioni, ndërsa disa sugjerime përfshijnë objekte të aktiviteteve të tjera të kohës së lirë. Përveç kësaj, këndet e lojrave do të janë të pajisura me lodra të certifikuara (kolovajse, rrëshqitës, rrotullues, vegla të përbëra, etj), shtroje sigurije, gardhe të përshtatshme dhe të tjera. Gjithashtu, një nga nënprojektet e përfshira në përmirësimin e mjedisive të hapura publike ka të bëjë me vendllojen e elementeve si stola dhe bangove.

Parqet e çlodhjes dhe këndet e lojrave të Bashkisë do të janë të hapura dhe të arritshme nga të gjithë qytetarët, dhe qasja do të sigurohet nga të gjitha zonat. Ato pritet të presin veprime pilot, inovative dhe ciklike (ripërdorim, ndarje në burim, rimëkëmbje materiale, energji, autonomi energjetike, bashkëjetesë industriale) së bashku me promovimin e aktiviteteve të vizitorëve në natyrë (lojra, rekreacion i butë) dhe shtigjeve për shëtitje dhe bicikleta.

- *Qendra sportive ujore në lumin Devoll*

Përveç kësaj, në tërësinë e mjedisive të clodhjes të Bashkisë, bën pjesë edhe qendra sportive ujore e propozuar në lumin Devoll, pranë Malit. Kjo ndërhyrje është një element i rëndësishëm në zhvillimin e infrastrukturës sociale, pasi pritet t'i japë karakter rajonit dhe të jetë një markë tregtare. Projekti do të zbatohet sipas specifikimeve të duhura dhe do të përfshijë veprime për mbrojtjen nga përmbytjet dhe planifikimin e plotë dhe pajisjet për krijimin e parkut. Vendndodhja e kësaj hapësire publike është veçanërisht e rëndësishme, pasi është planifikuar të krijohen korsi për lidhje me qendrën e qytetit për të gjitha format e lëvizjes, ndërsa do të shoqërohet nga ndërtimi i një ure për këmbësorët për lidhjen e të dy anëve të lumit. Sa i përket dimensionit social të infrastrukturës, do të ketë gjithashtu karakter kulturor. Në këtë kontekst, parashikohet të organizohen ekipe dhe kurse të sporteve ujore, të cilat natyrisht do të mbështeten me infrastrukturë të përshtatshme, pajisje dhe instalime ndihmëse.



### PLANI I MBROJTJES SË MJEDISIT

Bazuar në strategjinë për zhvillimin e qëndrueshëm të Bashkisë, propozohet Plan i Mbrojtjes së Mjedisit (PMM). PMM do të jetë një mjet i dobishëm për qasjen e integruar të çështjeve kritike mjedisore, të analizuara dhe të vlerësuara gjatë fazave të mëparshme (peizazhi, mjedisi i ndjeshëm natyror dhe kulturor, zonat e gjelbra, ajri, burimet ujore, hotspot) dhe për arritjen e objektivave mjedisore siç përcaktohen nga kornizat dhe strategjitet gjithëpërfshirëse. Masat e propozuara përbëjnë një kornizë udhëzuese për menaxhimin e ndikimeve negative që do të lindin gjatë rrjedhës së zhvillimit të Bashkisë dhe jo një listë shteruese e masave për adresimin dhe zbutjen e ndikimeve mjedisore nga çdo ndërhyrjeje dhe projekt individual. Masat më të hollësishme do të përfshihen në studimet e VNM që do të përgatiten për çdo projekt të veçantë, gjatë fazës së licensimit.

#### 3.1. Trajtimi i ndikimeve në ajër

Burimet kryesore të ndotjes së ajrit pritet të janë:

- transporti, dhe kryesisht lëvizja e automjeteve në aksin rrugor parësor SH3, i cili pritet të rritet për shkak të rritjes së aktivitetit ekonomik (bujqësi, prodhim, tregti) dhe së dyti në aksin SH71 për shkak të rritjes së fluksit të vizitorëve, por edhe si një rrugë alternative drejt pjesës qendrore dhe perëndimore.
- djegia për ngrohje ose prodhimin e energjisë. Nevojat për ngrohje do të rriten minimalisht si rezultat i rritjes së numrit të banorëve dhe vizitorëve, por edhe për shkak të përmirësimit të pritur të standardit të jetesës. Gjithashtu, një nga objektivat e autonomisë energetike dhe promovimit të BRE-ve është eksplorimi i mundësisë së prodhimit të energjisë nga biomasa e mbetjeve bujqësore dhe / ose gazi natyror.
- emetimet nga industria, pasi zhvillimi i sektorit sekondar, është një synim kryesor i planifikimit.
- pluhuri nga zbatimi i veprave teknike dhe punimeve, për të cilat propozohet një program kompleks veprimi, që ka të bëjë me sektorë të ndryshëm dhe të gjithë zonën e Bashkisë, duke u fokusuar në pjesën qendrore (zonën urbane).
- emisionet dhe transportimi i ndotësve nga zjarret, pasi tashmë është konstatuar rreziku i madh nga shfaqja e zjarreve.

Sfidat dhe prioritetet kryesore për parandalimin e ndotjes së ajrit nga të gjitha burimet e mësipërme janë:

- përmbyllja e miratimit dhe zbatimit të standardeve evropiane për cilësinë e ajrit urban në nivel kombëtar. Krijimi dhe funksionimi i sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit në nivel lokal (ose edhe më efektiv, në nivel rajonal), duke u fokusuar kryesisht në zonën e ultësirës, e cila pritet të rëndohet më shumë.
- promovimi i mobilitetit të qëndrueshëm, duke përfshirë përdorimin e bicikletave sa të jetë e mundur më shumë dhe lëvizjes të sigurtë dhe tërheqëse të këmbësorëve, përmes një rrjeti shiqjesh për këmbësorët.
- përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe organizimi më i mirë i trafikut (shënjimi, nyjet etj) duke shkurtuar kohën e udhëtimit dhe përrrjetojë konsum më të paktë të karburantit dhe prodhim më të vogël të gazrave të shkarkuara në atmosferë.



- përmirësimi i transportit publik.
- ripërtëritja e flotës së automjeteve me automjete të reja që lëshojnë më pak ndotës.
- reduktimi i lëvizjeve të panevojshme të qytetarëve, duke përmirësuar dhe zhvilluar infrastrukturën elektronike për përbushjen në distancë të çeshtjeve burokratike.
- aplikimi i teknologjisë antismog në njësitë industriale (filtrimi i ajrit dhe mbajtja e ndotësve).
- pyllëzimi dhe krijimi i hapësirave të gjelbra urbane.
- kontrolli i materialeve të djegura për ngrohje dhe informimi përkatës i banorëve.
- krijimi i rrjeteve urbane të gazit natyror, për konsum shtëpiak dhe industrial.
- hartimi i një plani për mbrojtjen nga zjarri dhe zbatimi i projekteve dhe masave që do të propozohen.

### 3.2. Trajtimi i ndikimeve në ujëra

Burimet ujore pritet të ndikohen negativisht nga: (a) promovimi i agroturizmit dhe ekoturizmit, rekreacionit dhe shërbimeve në përgjithësi, (b) nxitja e industrisë, me rritjen e njësive të përpunimit primar të prodhimit, (c) zhvillimi prodhimit bujqësor dhe d) implementimi i digave të reja dhe HEC-eve.

Intensifikimi i konsumimit të ujitnga zhvillimi i aktiviteteve të turizmit dhe agroturizmit, rezulton nga vadirja në njësitë e agroturizmit, si dhe konsumi uji i pijshëm që do të përdoret nga turistët dhe shërbimet që do të ofrohen nga të gjitha njësitë turistike. Për ujiten, mund të zbatohen masat e renditura më poshtë për sektorin primar. Për ujin e pijshëm, efektiv është reduktimi i konsumit të tij nëpërmjet zbatimit të sistemeve të kursimit, p.sh. në mjediset sanitare, në kuzhinë etj. Gjithashtu është i dobishëm sensibilizimi i vizitorëve me informacion të kujdeshëm, me vendosjen e tabelave në dhoma etj., në mënyrë që të mos e shpërdorojnë ujin që përdorin.

Konsumi i ujit nga aktivitetet e përpunimit, mund të kontrollohet në mënyrë parandaluese: duke zbatuar një politikë të përshtatshme çmimesh për ujin që konsumohet duke dekuruar në këtë mënyrë shpërdorimin e tij; me organizimin territorial dhe përqëndrimin e njësive të përpunimit në zonat ekonomike, në mënyrë që të bëhet menaxhim kolektiv i ujit; duke kontrolluar shpimet individuale të njësive, në mënyrë që të bëhet efektiv zbatimi i një plani për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore të Bashkisë, si dhe me përdorimin e sistemeve bashkëkohore në aktivitetet artizanale; për të pasur kursim të ujit, adoptimi i Sistemeve të Menaxhimit të Mjedisit nga industritë p.sh. ISO 14000, EMAS etj, do të kontribuojë pozitivisht në kursimin e tij.

Sa i përket përdorimit të ujit sipërfaqësor për prodhimin e energjisë, duhet të paraprihet nga studime në nivel ujëmbledhësi, në të cilat do të përcaktohen përdorimet e ujit, si furnizimi me ujë të pijshëm, ujitja, prodhimi i energjisë etj. dhe sasitë që do të përdoren nga hidrocentralet, në mënyrë që të mos mungojë uji për përdorimete tjera, siç është ujitja e ekonomive bujqësore në drejtim të rrymës së hidrocentralit.

Intensifikimi i konsumit të sasive të mëdha të ujit përvaditje nga fuqizimi i prodhimit primar, mund të parandalohet kryesisht me anë të:

- Zbatimit të një plani për menaxhimin e qëndrueshëm të ujit përvaditje.
- Mbështetjes të fermerëve nga agronomë dhe punonjës të tjerë shkencorë, për të zgjedhur kulturat që nuk kërkojnë sasi të mëdha ujitje.





- Ndërtimit të rrjeteve moderne të ujitjes kolektive, për të minimizuar sasinë e ujit për ujitje, të humbur përmes avullimit dhe për të maksimizuar efikasitetin e sistemeve të ujitjes (p.sh. vadirja e bimëve direkt në rrënje).
- Mirëmbajtjes dhe përmirësimi i lagunave dhe digave, për të minimizuar abstraksionin e ujërave nëntokësore.
- Kontrollit të shpimeve të puseve nga fermerët, në mënyrë që të realizohet një plan realist i menaxhimit të ujit për vadirje.

### 3.3. Trajtimi i ndikimeve në peizazh

Peizazhi nuk pritet të ndikohet negativisht nga programi i propozuar i projekteve dhe ndërhyrjeve. Përjashtim përbëjnë projektet e mëdha të rrugëve dhe transportit si përmirësimi i akseve rrugor SH3 dhe SH71 si dhe ndërtimi i linjës hekurudhore. Sa i përket SH3 dhe rrjetit hekurudhor, këto do të kalojnë nëpër pjesën fushore, konkretisht në zonën në të dy anët e rrugës aktuale SH3, e cila është e ndryshuar dhe degraduar nga ndërtimi i paplanifikuar dhe i gjerë.

Peizazhi në pjesën malore, perëndimore të bashkisë është më i paprekur dhe "autentik", ruan tiparet "unike" dhe prandaj është më e ndjeshme ndaj ndryshimeve dhe degradimeve. Kjo është arsyaja pse ne duhet t'i kushtojmë vëmendje projektimit dhe zbatimit të projekteve, siç është përmirësimi i SH71 dhe ndërtimi i rrugës për në Skrapar. Peizazhi duhet të jetë parametër i veçantë dhe i rëndësishëm në licënsimin mjedisor të projekteve në këtë zonë. Ndryshimet e gjeorelievit duhet të janë të kufizuara, ndërkojë që duhet të restaurohen sa më shpejt që të jetë e mundur kantieret pas ndërprerjes së funksionimit të së tyre. Ndërhyrje të rëndësishme që do të përmirësojnë dhe mbrojnë peizazhin janë ripyllëzimi me lloje endemike që mund të zhvillohen në këto kushte, zgjerimi i zonave të mbrojtura dhe miratimi i planeve të menaxhimit. Gjithashtu një parametër kritik është ruajtja dhe krijimi, aty ku mungojnë, të zonave ripariante të lumenjve dhe të liqeneve. Kjo është një zonë kritike me rol shumëfunktional, sepse kontrollon fluksen (komponentët ushqyes dhe sedimentet) që përmirësojnë cilësinë e ujit, mbron nga erozioni i tokës dhe ndotja, kontribuon në mbrojtjen nga përmbytjet, ndihmon në përmirësimin e mikroklimës dhe cilësinë e ajrit dhe funksionon si një habitat përfundimtë aktiviteteve të tillë si nxjerrja e mineraleve, do të thotë ndryshim i përkohshëm negativ në peizazh.

Vëmendje e veçantë duhet t'i jepet ndërhyrjeve në zonat e mbrojtura të mjedisit natyrore (p.sh. Krastafillakun që është Rezervë Natyrore e Menaxhuar).

Peizazhi urban do të përmirësohet ndjeshëm përmes zbatimit të PPV dhe konkretisht nëpërmjet rindërtimit, krijimit të hapësirave të lira publike dhe hapësirave të gjelbra, mbjelljes përgjatë rrugëve, mbrojtjes dhe nxjerrjes në pah të lumenjve që përshkojnë vendbanimet, përmirësimi i ndërtesave të caktuara (p.sh. shkolla, ambulanca).

Aktivitetet prodhuese dhe objektet industriale nuk pritet të kenë ndikim në peizazh pasi vendosja e të rejave është drejtuar në përqëndrimet ekzistuese (p.sh. zona ekonomike brenda rrjetit urban Maliq dhe zonat ekonomike përgjatë aksit SH3) që reformohen dhe organizohen si ekonomike zonat, ashtu që zonat e organizuara, ku mund të zbatohen masat përbutjen e efekteve negative, p. sh. realizimi i një rripi të gjelbër perimetrik me pemë të gjata dhe vegjetacion, në mënyrë që të ketë izolim vizual nga rrugët më të afërtë.





### 3.4. Parashtimi i variantave për zgjidhje të problematikes të hotspot-eve

Pikat e nxeha (hot spots) më të rëndësishme për Bashkinë Maliq janë të lidhura me përmbytjet, zjarret, rrëshqitjet e tokës dhe shfaqjen e brejtësve. Këto fenomene kanë një ndikim të ndjeshëm në mjedis dhe tek njeriu, pasi e ulin cilësinë e jetës së banorëve, ndryshojnë cilësinë e tokës, çojnë në shkatërrimin e peizazhit dhe vënë në rrezik shëndetin e banorëve, duke çuar në braktisjen e zonave përkatëse.

Zjarret janë rezultat i faktorëve si përfaktoret natyrorë ashtu edhe ato të krijuara nga njeriu. Ato ndikohen nga parametrat që lidhen me kushtet klimatike (p.sh. shpejtësia e erës, thatësia) dhe morfologjia e tokës. Fushat që janë prekur shumë nga këto fenomene janë të vendosura në pjesën jugperëndimore të bashkisë, veçanërisht në zona të tilla si Lozhan i Ri, Dolani, Senishti, Plovishti, Gjyrasi, Bicka dhe Goca, njëkohësisht vendbanimeve me rrezikshmëri të lartë karakterizohen Grapshi dhe Bradvice.

Ky fenomen duhet të trajtohet nëpërmjet planifikimit kundër zjarrit dhe marrjen e masave dhe vendimeve. Masa të tilla që ndihmojnë në shmangjen dhe eliminimin e fenomenit janë sa më poshtë:

- Mbikëqyrja dhe kontrolli i aktiviteteve brenda zonave pyjore, në varësi të statusit të mbrojtjes.
- Zhvillimi i sistemeve paralajmëruese në rast të kushteve të rrezikshme të motit. Përditësimi mund të bëhet përmes spoteve televizive dhe radiofonike, tabelave paralajmëruese në anë të rrugëve dhe mesazheve paralajmëruese, nëpërmjet kompanive të telefonisë celulare.
- Vendosja e tabelave të përhershme paralajmëruese për rrezikun nga zjarret në shtigjet pyjore dhe në akset rrujore që përshkojnë pyjet, si dhe tabelave ndaluese për ndezje zjarri në pyje për qëllime të kohës së lirë.
- Pastrimi i zonave pyjore nga mbeturinat dhe degët e thata, kryesishët të pyjeve peri-urbane dhe atyre të përfshira në zonat e mbrojtura.
- Krijimi i një pike vrojtimi, funksionimi i të cilës mund të bazohet në punën vullnetare.
- Sensibilizimi i qytetarëve dhe vizitorëve dhe inkurajimi i banorëve përfshirë marrë pjesë në strukturat dhe veprimtaritë përmes mbrojtjen nga zjarri (p.sh. përmes spoteve televizive dhe radiofonike, broshurave, integrimit në procesin arsimor, organizimit të ditëve të informimit).
- Krijimi i zonave të mbrojtura nga zjarri.
- Zhvillimi i një rrjeti të hidranave zjarrfikës në zonat pyjore dhe rezidenciale dhe rezervuarëve përmes mbledhjen e ujit përdorim në rast zjarri.
- Krijimi i hartave të rrezikut nga zjarri, përditësuar dhe njoftuar gjatë periudhave kritike.
- Bashkëpunimi në çështjet e mbrojtjes nga zjarrime bashkitë e afërtë të Korçës (që bashkë-menaxhojnë Vargmalin e Moraves) dhe Pustecit (që bashkë-menaxhojnë Parkun Kombëtar të Prespës) dhe subjekte të tjera përkatëse (p.sh AdZM Korçë, shërbimi zjarrfikës).

Ndërhyrja njerëzore në kombinim me shkaqet natyrore përbëjnë shkakun e rrëshqitjes së dheut. Shembuj karakteristikë që çojnë në fenomenet e rrëshqitjes së dheut janë erozioni i tokës përfshak të veprimit të lumenjve, rritja e nivelit të ujërave nëntokësore, geomorfologjia e zonës, reshjet e mëdha dhe shkatërrimi i pyjeve.

Më poshtë përmenden masat e parandalimit dhe trajtimit të rrëshqitjeve të dheut:

- Kryerja e studimeve gjeologjike dhe gjeoteknikë në nivel Bashkie.





- Krijimi i hartave të rrezikut për zonat e kërcënua nga rrëshqitjet e tokës. Projektet që ndodhen ose do të zbatohen në zonat me rrezik të lartë duhet të shoqërohen me studime gjeoteknikë dhe të jenë në përputhje me rregulloret dhe dispozitat e legjislativës ekzistues.
- Vendosja e tabelave të përhershme të paralajmërimit të rrezikut të rrëshqitjeve të dheut në shtigje dhe përgjatë akseve rrugore të prekura nga fenomenet përkatëse.
- Informim dhe edukim i qytetarëve për menaxhimin dhe trajtimin e rrëshqitjeve të tokës.
- Mbështetja e projekteve dhe masave për parandalimin dhe trajtimin e rrëshqitjeve të dheut në lidhje me heqjen dhe kapjen e volumeve të rrezikshme për rënien, siç janë rrjetet mbrojtëse, si dhe projektet e stabilizimit siç janë muret mbështetëse dhe masat e përgjithshme që kontribuojnë në mbrojtjen dhe menaxhimin e mjedisit dhe shëndetin e njeriut.

Përmbytjet regjistrohen në pjesën veriore të njësisë administrative Libonik dhe kryesisht përgjatë lumit Devoll, duke pasur ndikim të drejtpërdrejtë në njësitë e tjera bashkiakë, si ato të Pirg dhe Vreshtas. Shfaqen pas reshjeve intensive, me sasi të madhe shiu në një kohë të shkurtër. Fenomeni ka ndikim të drejtpërdrejtë në sipërfaqet bujqësore dhe produktivitetin e tyre, pasi shkakton shkatërrime të mëdha dhe dëme materiale. Gjithashtu ulin vlerën e tokës dhe çojnë në ndotjen e burimeve të ujit të pijshëm. Faktorët që kontribuojnë në shfaqjen e fenomenit janë morfologjia e zonës, kushtet e tokës dhe mungesa e bimësisë në zonë. Në përputhje me sa më sipër, ekziston nevoja e trajtimit të përmbytjeve, që mund të arrihet përmes vendimeve dhe ndërhyrjeve. Ndërhyrjet që do të kontribuojnë në eliminimin e fenomenit janë ndërtimi i veprave të infrastrukturës siç janë digat dhe vepra kundër përmbytjeve, informimi dhe edukimi i banorëve në menaxhimin dhe trajtimin e përmbytjeve, supervizimi dhe kontrollit për menaxhimin e duhur dhe parandalimin në zonat që janë të pritura ndaj fenomeneve të përmbytjeve.

*Shfaqja e brejtësve* në Bashkinë e Maliq është me rëndësi të madhe për mbrojtjen e shëndetit të njeriut. Brejtësit gjenden kryesisht në zonat Fshat Maliq deri në Lozhan i Ri, në zonën përgjatë lumit Devoll. Shfaqja e tyre kërkon kushte specifike që kontribuojnë në mbijetesën dhe shumimin e tyre. Kërkohet me ngulm të bëhet monitorimi i zakoneve të tyre me qëllim parandalimin e rrezikun në kohën e duhur. Veprime të tillë arrihen nëpërmjet:

- regjistrimit të popullsisë.
- monitorimit të zakoneve të tyre dhe kontrollit të vazhdueshëm të pikave të jetesës dhe shumimit të tyre.
- marrjes së mostrave për të zbuluar patogenët në kohën e duhur dhe për të eliminuar popullsinë infektive.
- Informimit të banorëve dhe marrjes së masave për mbrojtjen e shëndetit publik.

Një parametër i rëndësishëm për suksesin e masave të lartpërmendura janë rolet dhe përgjegjësitetë për çdo veprim të kerkuar të jenë të shpërndara në mënyrë të qartë, pa mbivendosje dhe konflikte.

### 3.5. Parashikimet për shtimin dhe/ose zgjerimin e hapësirave të gjelbra

Masat dhe ndërhyrjet për shtimin dhe / ose zgjerimin e hapësirave të gjelbra në zonën urbane përfshijnë:

- Mbrojtjen e pemëve të përshtatshme në zonat publike në qytet dhe në fshatra të mëdhenj në njësitë administrative.





- Përmirësimi i hapësirave të gjelbra-shesheve ekzistuese.
- Krijimi i parqeve urbane dhe hapësirave të gjelbra në rrjetin urban Maliq-Libonik si dhe i zonave të gjelbra peri-urbane përgjatë aksit të gjelbër që lidh Krastafillak – qytetin – Pyllin e Fazanëve: park afër rezervuarit të vjetër industrial dhe park përgjatë lumenit Devoll. Ndërhyrjet do të janë të kufizuara: shëtitore dhe pajisjet bazë për shërbimin e vizitorëve (p.sh. stola, tabela informuese, rrugë biçikletash).

Qëllimi i mësipërm është përmirësimi i ndjeshëm i peizazhit urban, krijimi i hapësirave të reja të argëtimit dhe zhvillimi i aktiviteteve të kohës së lirë, përmirësimi i kushteve të mikroklimatike dhe mjedisore, rritja e shëndetit mendor dhe fizik të banorëve dhe përforcimi i biodiversitetit.

Përveç kësaj, edhe në sistemin natyror dhe bujqësor propozohen masa që do të kenë si rezultat shtimin e gjelbërimit:

- Ripyllëzimi në zona të veçanta të degraduara /të shpyllëzuara, kryesisht në Vergmalin e Moravës, me lloje të ndryshme pemësh dhe bimësh endemike, karakteristike të vendit.
- Rehabilitimi i guroreve joaktive, duke mbjellë llojeve bimësh të përshtatshme, në mënyrë që hapësira të jetë në harmoni me peisazhin e saj rrethues dhe në përputhje me vlerat e tij estetike.
- Fuqizimi i zonave ripariane të lumenjve dhe të liqenit të Prespës të Vogël

### **3.6. Konkluzion për trajtimin e ndikimeve mjedisore të propozimeve të Planit**

Zbatimi i masave të përmendura më lart do të kontribuojë në menaxhimin e integruar të problemeve mjedisore të identikuara në Bashki dhe në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme të mjedisit dhe cilësinë e jetës. PMM rekomandon që ajo kornizë, së bashku me rekomandimet e VSM, të cilat Bashkia duhet t'i marrë në konsideratë në përgjithësi dhe Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis, në veçanti, që do të përgatiten në të ardhmen për projekte të ndryshme të propozuara të infrastrukturës teknike dhe sociale, ose për projekte zhvillimore në Bashki, të janë më efektive në identifikimin, parashikimin dhe vlerësimin e ndikimit mjedisor të projekteve si dhe në formulimin e masave për adresimin e tyre.





## 4. PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E PPV-SË

### 4.1. Plani i Veprimit

#### 4.1.1. Zhvillim e njësive strukturore sipas prioritetit

Prioritetet të zhvillimit të njësive strukturore ndahen në tre kategori: i lartë, i mesëm dhe i ulët dhe kanë të bëjnë me:

- (a) zonat dhe elementët me rëndësi kombëtare, siç për shkruhet në kapitullin 1.4 më lart. Si rrjedhim, nëse i përkasin këtyre zonave ose përbajnjë elementë të tillë, prioriteti është i lartë.
- (b) zonat e zhvillimit kryesor ekonomik dhe urban, siç përshkruhet në kapitullin 1.4 më lart. Nëse ato përfshihen tërësisht ose pjesërisht e tyre, përparësia e tyre e zhvillimit është e lartë.
- (c) mënyrën e zhvillimit të tyre. Nëse propozohet të bëhet përmes PDV, prioriteti është i lartë.
- (d) projektet që kryhen bazuar në Planin e Veprimeve. Njësitë strukturore që nuk janë klasifikuar bazuar në kriteret e mëparshme si të prioritetit të lartë: kanë prioritet zhvillimi të lartë kur projektet i përkasin fazës së parë dhe të dytë, prioritet të mesëm kur projektet i përkasin fazës së tretë dhe prioritet të ulët, kur projektet i përkasin fazës së katërt.

Vërehet se lloji i zhvillimit përcaktohet nga mënyra e ndërhyrjes.

#### 4.1.2. Infrastruktura publike

Pjesa më e madhe e Planit të Veprimeve përbëhet nga ndërhyrjet në infrastrukturat publike, të cilat kanë të bëjnë me të gjitha rrjetet kryesore, si infrastrukturën teknike edhe atë sociale. Në vijim paraqitet lloji i ndërhyrjes së propozuar.

##### 1. Rrjeti i transportit

- Përmirësimi i rrugëve ekzistuese, me veprime të tillë si përmirësimin e karakteristikave gjeometrike (p.sh. zgjerim, ndërtim të anëve mbështetëse), mirëmbajtjen, shtrimin me asfalt, ndriçimin, sistemim etj. Për sa më sipër propozohet:
  - Rikonstrukioni dhe përmirësimi i 11 sektioneve rrugore.
  - Shndërrimi i SH3 në një autostradë të myllur duke ndërtuar nyje në kryqëzime.
- Ndërtim i linjës hekurudhore dhe stacionet hekurudhore në Maliq.
- Përforcimi i sigurisë rrugore, me anë të sinjalistikës horizontale dhe vertikale, ndriçimit, kryesisht tek njyjet përgjatë aksit rrugor SH3 me trafik të ngarkuar.
- Krijimin e rrugëve të përshtatshme për lëvizjen e bicikletave dhe këmbësorëve dhe zhvillimin/forcimin e transportit brenda vendbanimeve. Më specifiksht, propozohet:
  - Krijimi dhe mirëmbajtja e shtigjeve të këmbësorëve dhe bicikletash në njësitë administrative të Moglicës dhe Gorës.
  - Sinjalizimi dhe mirëmbajta e shtigjeve ekzistuese.
  - Krijimi i shtigjeve për këmbësorë dhe bicikletave përgjatë lumbit Devoll në Qytetin e Maliqit.
  - Krijimi i rrjetit të transportit publik që do shërbejë të gjitha zonat e urbanizuara.
  - Ndërtimi i terminalit të Maliqit.
- Organizimin të trafikut në zona urban Maliq-Libonik me qëllim që ti shërbejë në mënyrë optimale përdorimeve të tokës/aktiviteteve dhe të përmirësojë kohën dhe cilësinë e lëvizjeve dhe të promovojë lëvizshmërinë e qëndrueshme. Përveç kësaj, vëmendje i kushtohet promovimit rregullave dhe planifikimit për të lehtësuar lëvizjen e këmbësorëve, çiklistëve, fëmijëve dhe





grupeve vulnerabël duke përfshirë dhe personat me aftësi të kufizuar për shërbimin e nevojave të tyre të përditshme.

## 2. Rrjeti i ujësjellësit

- **Ndërtimirrjeteve të ujesjellësit në një së rë nevdbanimesh**
- 3. Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza
- **Ndërtimi i rrjeteve të kanalizimit të ujërave të zeza në fshatra të ndryshme**
- **Rikonstruktion i rrjeteve të kanalizimit të ujërave të zeza në zonën urbane Maliq-Libonik**
- **Ndërtimi i impjantit të trajtimit të ujërave të zeza në vendbanime të përzgjedhura**

## 4. Rrjeti i ujitjes

- **Rehabilitim kanaleve të ujitjes**
- **Ndërtim i veprave kulluese për bonifikimi ne fushës së Maliqit**

## 5. Rrjeti i energjisë elektrike

- **Ndërtimi i tubacionit Të gazit natyror si pjesë e rrjetit kombëtar**
- **Ndërtimi rrjetit urban të gazit natyror**

## 6. Rrjeti i menaxhimit të mbetjeve dhe mbeturinave

- **Zbatimi i programit të riciklimit**
- **Rehabilitimi e vend depozitimeve të mbetjeve**

## 7. Rrjeti i arsimit

- **Rikonstrukioni shkollave të niveleve të ndryshme**
- **Ndertimi i shkollave të niveleve të ndryshme**

## 8. Rrjeti i shëndetësisë

- **Rindërtimi i ambulancës në Bregas**
- **Ndërtimi i ambulancës në Sovjan**
- **Përmirësimi i qendrës shëndetësore në Maliq**

## 9. Rrjeti i kulturës

- **Rikonstruktion i Qendrës Komunitare Kulturore "Dhimetër Orgocka" në Maliq**
- **Rikonstruksioni i kinemave të vjetra dhe konvertimi i tyre në qender komunitare**
- **Rikonstruktion i ishMuzeut së Luftës në Rëmbec**  
Çdo ndërhyrje të kryhen duke u bazuar tek Ligjet Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë".

## 10. Rrjeti sportiv

- **Ndërtimi i Palestrave në shkolla**
- **Ndërtimi i një qendre sportive ujore në lumen Devoll**
- **Krijimi i hapësirave sportive në Maliq dhe Pirg**

## 11. Rrjeti i hapësirave të gjelbëruara

- **Ndërtim i parkut përgjatë lumit Devoll në zonën urbane Maliq-Libonik**
- **Ndërtim i rrjetit të hapësirave për parqe fëmijësh, sheshe dhe hapësira të gjelbëruara në zonën urbane Maliq-Libonik**
- **Ndërtim i shesheve në një sërë fshatrash**





#### 4.1.3. Projekte prioritare / Pilote të zhvillimit

Nr. rendor	Titulli	1. Sistemim urban në Zvirinë
Tipologja	Zhvillim Urban	
Vendndodhja e projektit	Zvirinë në njësi administrative të Pirgut	
Përshkrim i shkurtër	Përfshin: Sistemimin e hapësirave të lira dhe përmirësimin e pajisjeve në to, përmirësimi dhe krijimi i hapësirave publike (p. sh. shesh, kënd lojërash), rritja e hapësirave gjelbëra, organizimi, asfaltimi dhe ndriçimi i rrugëve kryesore dhe të brendshme, përmirësimi i hyrjes në fshat. Krijim i hapësirave sportive.	
Qëllimi kryesor dhe rëndësinë	Përmirësimi i cilësisë së jetës. Rritja e vizitueshmërisë dhe e aktiteteve ne zonë.	
Në përputhje me:	Objktivi Strategjik	OS1: Zhvillim gjithpërfshirës i sektorit të bujqësisë OS3: Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave të urbanizuara
	Programi Strategjik	PS1.5. Zhvillim i agroturizmit PS3.3. Forcimi i rjetësimit dhe rigjenerimit të zonave urbane
Kodi i Programit (sipas kategorizimit të COFOG-ut)	062 - Zhvillimi i komunitetit	
Sistemi territorial që ndikohet	Preken sistemet territoriale.	
Koston e përafërt	100,000,000 ALL	
Burime e mundshme të financimit	Bashkia/ FZHR/ Donatorë të ndryshëm	
Treguesi i vlërsimit/ ndjekjes	Përfundimi i projektit/ Rritja e vizitueshmërisë	
Palët e interesuara (partnerët)	Bashkia	
Gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekt Ide	
Veprimet për implementimin e tyre	Hartimi i studimit	
Kohëzgjatja	6 Muaj	
Fazat e Zbatimit	I: 2021	X
	II: 2022-2023	
	III: 2024-2030	
	IV: 2031-2035	
Avantazhet/ rezultatet e pritshme	Përmirësimi i nivelit të jetesës së banorëve. Përmirësim i infrastrukturës sociale dhe teknike (arsimore, fetare dhe rekreative). Përmirësim i mjedisit të zonave urbane dhe funksionimit të vendbanimit. Rritja e vizitueshmërisë. Mundësi për të zhvilluar vende të reja pune	
Rreziqe të mundshme	Pamundësi për përfundimin e projektit. Degradim për shkak të vizitueshmërisë së lartë. Funksionim konkurruesh ndaj hapësirave të reja të lira të qytetit	
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore	Nuk ka nevojë për ndryshime.	





Nr. rendor	Titulli		2.	Krijimi i rrjetit të hapësirave të gjelbëra në Libonik
Tipologja	Zhvillim Urban			
Vendndodhja e projektit	Libonik			
Përshkrim i shkurtër	Përfshtin: Sistemim e hapësirave të lira dhe përmiresin e pajisjeve të tyre, përmirësimi dhe krijimi i hapësirave publike (p. sh. shesh, kënd lojërash), rritja e hapësirave të gjelbëra, organizimi, mbjellje pemësh përgjatë akseve rrugore lokale.			
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Përmirësimi i cilësisë së jetës. Krijimi i një poli të ri rekreativ. Përmirësim i imazhit të banimit në Libonik.			
Në përputhje me:	Objektivi Strategjik	OS3: Zhvillimi i qëndueshëm i zonave të urbanizuara		
	Programi Strategjik	PS4. Forcimi i ritetësimit dhe rigjenerimit të zonave urbane		
Kodi i Programit (sipas kategorizimit të COFOG-ut)	081 - Shërbimet rekreative dhe sportive			
Sistemi territorial që ndikohet	Nuk preken sistemet territoriale.			
Koston e përafërt	30,000,000 ALL			
Burime e mundshme të financimit	Bashkia/ FZHR/ Donatore të ndryshëm			
Treguesi i vlerësimit/ ndjekjes	Përfundimi i projektit/ Rritja e vizitueshmërisë dhe e aktiviteteve në zonë			
Palët e interesuara (partnerët)	Bashkia			
Gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekt Ide			
Veprimet për implementimin e ty	Hartimi i Studimit, Ndërtimi i projektit			
Kohëzgjatja	3 Muaj			
Fazat e Zbatimit	I: 2021	X		
	II: 2022-2023			
	III: 2024-2030			
	IV: 2031-2035			
Avantazhet/ rezultatet e pritshme	Përmirësimi i mjedisit jetësor të banorëve. Përmirësim i imazhit dhe funksionimit të vendbanimeit. Rritja e vizitueshmërisë.			
Rreziqe të mundshme	Pamundësi për përfundimin e projektit. Funksionim konkurrues ndaj hapësirave të reja të lira të qytetit			
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore	Nuk ka nevojë për ndryshime.			



Nr. rendor	Titulli	3.	Promovimi i liqenit artificial në Moglicë- hapësira argëtimi dhe shoqërore buzë liqenit		
Tipologja	Ekoturizëm				
Vendndodhja e projektit	Nj. Administrative Moglice				
Përshkrim i shkurtër	<p>Përfshin: Krijimin e zonës së gjelbër dhe sinjalistikën e atraksioneve të zonave përreth. Ndërtimin e molit dhe përdorimin e varkave, me qëllim shëtitjen e turistëve në liqen. Krijimin e shtigjeve të këmbësorëve dhe hapësirave të parkimit. Zhvillimin e aktiviteteve sportive në natyrë.</p> <p>Informimin dhe sensibilizimin e shoqërisë vendase. Mbrojtjen e zonave natyrore dhe minimizimin e ndikimeve negative që ushtron në të nëpërmjet aktiviteteve si kontrolli, ruajtja dhe vështrimin e zonës.</p>				
Qëllimi kryesor dhe rëndësinë	<p>Promovimi i turizmit alternativ. Përmirësimi i mbrojtjes dhe vetëdijes mjedisore. Rritja e punësimit. Organizimi më i mirë dhe më i plotë turistik për tërheqjen e vizitoreve dhe zhvillimin ekonomik të të gjithë zonës së Bashkisë. Vepreme të interesit mjedisor dhe ekoturistik.</p>				
Në përputhje me:	Objktivi Strategjik	OS2: Përmirësim i klimës të biznesit dhe nxitjes të investimeve OS5: Mbrojtja dhe promovimi e burimeve natyrore dhe kulturore			
	Programi Strategjik	PS2.3. Partneritetet rajonale dhe ndërkombëtare PS 5.2. Interpretim mjedisor - sensibilizim banorët dhe vizitorët PSS.3. Krijimi i aktiviteteve shoqërore dhe argëtimi.			
Kodi i Programit (sipas kategorizimit të COFOG-ut)	081 - Shërbimet rekreative dhe sportive				
Sistemi territorial që ndikohet	Nuk preken sistemet territoriale.				
Koston e përafërt	150,000,000 ALL				
Burime e mundshme të financimit	Bashkia/ FZHR/ Donatore të ndryshëm				
Treguesi i vlërsimit/ ndjekjes	Përfundimi i projektit/ Rritja e vizitueshmërisë dhe e aktiviteteve në zonë				
Palët e interesuara (partnerët)	Bashkia				
Gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekt Ide				
Veprimet për implementimin e ty	Hartimi i Studimit, Ndërtimi i projektit				
Kohëzgjatja	1 Vit				
Fazat e Zbatimit	I: 2021	X			
	II: 2022-2023				
	III: 2024-2030				
	IV: 2031-2035				
Avantazhet/ rezultatet e pritshme	Përmirësimi i mjedosit jetësor të banorëve. Përmirësim i imazhit dhe funksionimit të vendbanimit. Rritja e vizitueshmërisë. Rritja e punësimit dhe e të ardhurave të banorëve. Krijimi i mundësive përvende të reja pune. Përmirësimi i zonës në aspektn e banimit.				

<b>Rreziqe të mundshme</b>	Pamundësi për përfundimin e projektit. Degradim për shkak të vizitueshmërisë së lartë. Reklamim i pamjaftueshëm. Nënvlérësimi i burimeve natyrore. Promovim dhe reklamim i pamjaftueshëm i zonës.
<b>Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore</b>	Nuk ka nevojë për ndryshime.





Nr. rendor	Titulli	4.	Dyqan për promovimin e produkteve bujqësore lokale në Zvirinë
<b>Tipologja</b>		Zhvillim rural	
<b>Vendndodhja e projektit</b>		Nj. Administrative Pирg / Zvirinë	
<b>Përshkrim i shkurtër</b>		Përfshin: Shfrytëzimin e hapësirës ekzistuese, me qëllim përqëndrimin e prodhimit vendas dhe krijimin e hapësirës unike të shitjes së produkteve. Produktet do të ndahen sipas llojit të tyre nëpër rafte. Krijimin e një mjedisi miqësor për konsumatorin.	
<b>Qëllimi kryesor dhe rëndësia</b>		Konsolidimi i tregut vendas. Promovimi i produkteve vendase.	
<b>Në përputhje me:</b>	<b>Objektivi Strategjik</b>	OS1: Zhvillim gjithpërfshirës i sektorit të bujqësisë	
	<b>Programi Strategjik</b>	PS1.1 Mbështetje e prodhimit, produkteve dhe anëtarëve prodhues të grupeve. PS1.3 Promovim i bashkëpunimit. PS1.4 Modernizim i infrastrukturës mbështetëse.	
<b>Kodi i Programit (sipas kategorizimit të COFOG-ut)</b>		041 - Çështjet e përgithshme ekonomike, tregtare dhe të punës	
<b>Sistemi territorial që ndikohet</b>		Nuk preken sistemet territoriale.	
<b>Koston e përafërt</b>		8,000,000 ALL	
<b>Burime e mundshme të financimit</b>		Bashkia / FZHR / FSHZH / Donatorë të ndryshëm	
<b>Treguesi i vlërsimit/ ndjekjes</b>		Përfundimi i projektit/ Vizitueshmeri me të madhë/ Rritja e punësimit dhe të ardhurave	
<b>Palët e interesuara (partnerët)</b>		Bashkia	
<b>Gatishmërinë e projektit për zbatim</b>		Projekt Ide	
<b>Veprimet për implementimin e ty</b>		Hartimi i Studimit, Ndërtimi i projektit	
<b>Kohëzgjatja</b>		5 Muaj	
<b>Fazat e Zbatimit</b>	I: 2021	X	
	II: 2022-2023		
	III: 2024-2030		
	IV: 2031-2035		
<b>Avantazhet/ rezultatet e pritshme</b>		Rritje e të ardhurave të fermerëve. Marrëdhënie bashkëpunimi e prodhuesve vendas, me qëllim përmirësimin e tij. Kërkesë për produkte bujqësore. Komunikim i drejtëpërdrejtë i prodhuesit me konsumatorin.	
<b>Rreziqe të mundshme</b>		Pamundësi për përfundimin e projektit. Mungesë organizimi dhe koordinimi. Pamundësi për kontrollin e çmimeve dhe për përshtatjen me konkurrencën.	
<b>Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore</b>		Nuk ka nevojë për ndryshime.	





Nr. rendor	Titulli	5.	Krijimi i zonës së argëtimit buzë lumit të Devollit- lidhje me Pyllin e Fazaneve		
Tipologja	Mjedis natyror- Argëtim				
Vendndodhja e projektit	Nj. Administrative Maliq & Libonik				
Përshkrim i shkurtër	<p>Përfshin: Krijimin e zonës së gjelbër përgjatë bregut të lumit. Krijimin e shtigjeve për këmbësorë dhe rrugës për bicikleta, që do të lidhë të dyja anët. Ndërtimin e urës që do të përshkojë lumin Devoll, me qëllim lidhjen e Libonikut me parkun. Vendosjen e ndriçimit, e koshave të mbeturinave dhe stolave përgjatë shtigjeve.</p>				
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	<p>Përmirësimi i cilësisë së jetës. Promovimi i trashëgimisë natyrore. Konsolidimi i atraksionit dhe ekonomisë së zonës. Atraksiuni i turistëve.</p>				
Në përputhje me:	Objektivi Strategjik	<p>OS3: Zhvillimi i qëndueshëm i zonave të urbanizuara OS5: Mbrotja dhe promovimi e burimeve natyrore dhe kulturore</p>			
	Programi Strategjik	<p>PS3.1 Përkrahja e lidhjeve pozitive ekonomike, sociale dhe mjedisore ndërmjet zonave urbane dhe rurale duke përforcuar planifikimin e zhvillimit vendor dhe rajonal PS3.4 Parandalimi dhe menaxhimi i rreziqeve natyrore dhe fatkeqësive. PS5.2 Interpretim mjedor - sensibilizim banorët dhe vizitorët PS5.3 Krijimi i aktiviteteve shoqërore dhe argëtimi.</p>			
Kodi i Programit (sipas kategorizimit të COFOG-ut)	081 - Shërbimet rekreative dhe sportive				
Sistemi territorial që ndikohet	Nuk preken sistemet territoriale.				
Koston e përafërt	250,000,000 ALL				
Burime e mundshme të financimit	Bashkia/ FZHR/ Donatore të ndryshëm				
Treguesi i vlerësimit/ ndjekjes	Përfundimi i projektit/ Rritja e vizitueshmërisë dhe e aktiviteteve në zonë				
Palët e interesuara (partnerët)	Bashkia				
Gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekt Ide				
Veprimet për implementimin e ty	Hartimi i Studimit, Ndërtimi i projektit				
Kohëzgjatja	9 Muaj				
Fazat e Zbatimit	I: 2021	X			
	II: 2022-2023				
	III: 2024-2030				
	IV: 2031-2035				
Avantazhet/ rezultatet e pritshme	<p>Rritje e vizitorëve në zonë. Përmirësim i mjedisit urban. Konsolidim i ekonomisë. Konsolidim i aktiviteteve sportive. Vende të reja pune. Përmirësim i estetikës së banimit në zonë.</p>				
Rreziqe të mundshme	Pamundësi për përfundimin e projektit. Degradim për shkak të vizitueshmërisë së lartë. Reklamim i pamjaftueshëm. Mirëmbajtje dhe ruajtje e pamjaftueshme e zonës.				





Ndryshimet e nevojshme  
institucionale dhe ligjore

Nuk ka nevojë për ndryshime.





Nr. rendor	Titulli	6.	Përmirësimi i Pyllit të Fazaneve
<b>Tipologja</b>		Mjedis natyror- Argëtim	
<b>Vendndodhja e projektit</b>		Nj. Administrative Libonik	
<b>Përshkrim i shkurtër</b>		<p>Përfshin: mbrotjen e paisazhit natyror dhe biodiversitetit, kufizimin dhe ndjekjen e vazhdueshme. Sinjalistika (tabela sinjalistike çdo 50 m.). Krijimin e hapësirave sportive të argëtit, kulturës në zonën përreth pyllit. Përmirësimin e rezervës së ndërtesave. Shfrytëzimin e ndërtesës qëndrore, duke theksuar dhe promovuar zhvillimin e saj diakronik (spotive, fotofragike). Kufizimin e zonës me rryjete. Ndërtim metalik të portës së hyrjes.</p>	
<b>Qëllimi kryesor dhe rëndësia</b>		Promovimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Tërheqja e turistëve. Konsolidimi i ekonomisë vendase. Promovimi i biodiversitetit të pasur.	
<b>Në përputhje me:</b>	Objektivi Strategjik	OS5: Mbrojtja dhe promovimi e burimeve natyrore dhe kulturore	
	Programi Strategjik	<p>PS5.1 Menaxhimi i qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave.            PS5.2 Interpretim mjedisor - sensibilizim banorët dhe vizitorët            PS5.3 Krijimi i aktiviteteve shoqërore dhe argëtimi.</p>	
<b>Kodi i Programit (sipas kategorizimit të COFOG-ut)</b>		056 - Mbrojtja mjedisore	
<b>Sistemi territorial që ndikohet</b>		Nuk preken sistemet territoriale.	
<b>Koston e përafërt</b>		40,000,000 ALL	
<b>Burime e mundshme të financimit</b>		Bashkia/ FZHR/ Donatorë të ndryshëm	
<b>Treguesi i vlërsimit/ ndjekjes</b>		Përfundimi i projektit/ Rritja e vizitueshmërisë dhe e aktiviteteve në zonë	
<b>Palët e interesuara (partnerët)</b>		Bashkia	
<b>Gatishmërinë e projektit për zbatim</b>		Projekt Ide	
<b>Veprimet për implementimin e ty</b>		Hartimi i Studimit	
<b>Kohëzgjatja</b>		2 Muaj	
<b>Fazat e Zbatimit</b>	I: 2021	X	
	II: 2022-2023		
	III: 2024-2030		
	IV: 2031-2035		
<b>Avantazhet/ rezultatet e pritshme</b>		Përmirësimi i cilësisë së jetës. Përmirësimi i imazhit urban.	
<b>Rreziqe të mundshme</b>		Aktiviteti i prerjes së drurëve. Kushtet klimaterike. Përblytja e sipërfaqes në rast reshiesh intensive. Mirëmbajtje dhe ruajtje e pamjaftueshme e zonës.	
<b>Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore</b>		Nuk ka nevojë për ndryshime.	





Nr. rendor	Titulli	7.	Krijimi i qendrës së sporteve ujore në lumin e Devollit		
Tipologja	Argëtim				
Vendndodhja e projektit	Nj. Administrative Maliq & Libonik				
Përshkrim i shkurtër	<p>Përfshin: Zona sportive me infrastruktura për krijimin e moleve dhe hapësave për ruajtjen e varkave. Ndërtimin e ndërtesës ku do të strehohen zyrat, sallat e mësimit, dhomat e zhveshjes, hapësirat e higjenës dhe hapësirat e argëtit të vizitorët. Gjithashtu, do të përfshihen edhe rrjeti i ndriçimit, mbjelljes me pemë përreth hapësirës dhe rezervuarit të ujërave të ndotur.</p>				
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Promovimi i aktivitetave sportive, atrakzioni i vizitorëve të rinj.				
Në përputhje me:	Objektivi Strategjik	OS3: Zhvillimi i qëndrueshëm e zonave të urbanizuara			
	Programi Strategjik	OS5: Mbrojtja dhe promovimi e burimeve natyrore dhe kulturore PS3.3 Forcimi i rijetësimit dhe rigjenerimit të zonave urbane. PS5.3 Krijimi i aktivitetave shoqërore dhe argëtimi.			
Kodi i Programit (sipas kategorizimit të COFOG-ut)	081 - Shërbimet rekreative dhe sportive				
Sistemi territorial që ndikohet	Nuk preken sistemet territoriale.				
Koston e përafërt	45,000,000 ALL				
Burime e mundshme të financimit	Bashkia/ FZHR/ Donatore të ndryshëm				
Treguesi i vlerësimit/ ndjekjes	Përfundimi i projektit/ Rritja e vizitueshmërisë dhe e aktivitetave në zonë				
Palët e interesuara (partnerët)	Bashkia				
Gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekt Ide				
Veprimet për implementimin e ty	Hartimi i Studimit, Ndërtimi i projektit				
Kohëzgjatja	3 Muaj				
Fazat e Zbatimit	I: 2021	X			
	II: 2022-2023				
	III: 2024-2030				
	IV: 2031-2035				
Avantazhet/ rezultatet e pritshme	Konsolidimi i aktivitetave sportive. Vende të reja pune. Përmirësimi i imazhit të banimit në zonë.				
Rreziqe të mundshme	Reklamim dhe promovim i pamjaftueshëm i zonës. Pamundësi për përfundimin e projektit. Degradim për shkak të vizitueshmërisë së lartë.				
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore	Nuk ka nevojë për ndryshime.				





Nr. rendor	Titulli	8.	Promovimi i vendbanimit prehistorik
<b>Tipologja</b>		Kulturë- Turizëm	
<b>Vendndodhja e projektit</b>		Nj. Administrative Maliq, Maliq	
<b>Përshkrim i shkurtër</b>		<p>Përfshin: Krijimin e ekspozitës brenda qendrës kulturore, tabelave shpjeguese dhe sinjalistikës në afërsi me hapësirën prehistorike. Lidhjen me zonën e argëtimit buzë lumi. Veprimet e vazhdueshme të kontrollit për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e hapësirës dhe të gjetjeve.</p>	
<b>Qëllimi kryesor dhe rëndësia</b>		Promovimi i trashëgimisë kulturore, rritja e vizitueshmërisë dhe konsolidimi i turizmit.	
<b>Në përputhje me:</b>	Objektivi Strategjik	OSS: Mbrojtja dhe promovimi e burimeve natyrore dhe kulturore	
	Programi Strategjik	PS5.2 Interpretim mjedisor - sensibilizim banorët dhe vizitorët PS5.4 Promovimi i trashëgimisë kulturore.	
<b>Kodi i Programit (sipas kategorizimit të COFOG-ut)</b>		082 - Shërbimet kulturore	
<b>Sistemi territorial që ndikohet</b>		Preken sistemet territoriale.	
<b>Koston e përafërt</b>		180,000,000 ALL	
<b>Burime e mundshme të financimit</b>		Bashkia/ FZHR/ Donatorë të ndryshëm	
<b>Treguesi i vlërsimit/ ndjekjes</b>		Bashkia / DRTK / Donatorë të ndryshëm / Universitetet të ndryshme në vend dhe jashtë vendit	
<b>Palët e interesuara (partnerët)</b>		DRTK / Departamenti i Arkeologjisë së Universitetet	
<b>Gatishmërinë e projektit për zbatim</b>		Projekt Ide	
<b>Veprimet për implementimin e ty</b>		Hartimi i Studimit / Përfundim i veprave	
<b>Kohëzgjatja</b>		1 Vit	
<b>Fazat e Zbatimit</b>	I: 2021	<input checked="" type="checkbox"/>	
	II: 2022-2023		
	III: 2024-2030		
	IV: 2031-2035		
<b>Avantazhet/ rezultatet e pritshme</b>		Atraksion i turistëve, cilësi më e mirë e jetesës, promovim i trashëgimisë kulturore, arsimet dhe historisë së vendit.	
<b>Rreziqe të mundshme</b>		Organizim i pamjaftueshëm për promovimin e trashëgimisë kulturore, përdorim jo aktiv i teknologjisë, promovim dhe reklamim i mangët.	
<b>Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore</b>		Nuk ka nevojë për ndryshime.	





Nr. rendor	Titulli	9.	Promovimi i kompleksit ekonomik- agro-ushqimor me drejtëm ekologjik (aktivizimi i zonës së vjetër industriale)		
Tipologja	Industri				
Vendndodhja e projektit	Maliq				
Përshkrim i shkurtër	Përfshin: Përmirësimin e ish zonës industriale të kombinatit, PDV, pajisjen me infrastruktura bashkëkohore, ndërtimin e rrugëve të brendshme, shërbime stimuluese dhe këshilluese.				
Në përputhje me:	Objktivi Strategjik	OS1: Zhvillim gjithpërfshirës i sektorit të bujqësisë OS2: Përmirësim i klimës të biznesit dhe nxitjes të investimeve			
	Programi Strategjik	PS1.2 Promovim i agropërpunimit PS2.1 Arritja e niveleve të produktivitetit në shërbime dhe industri. PS2.2 Forcimi i teknologjive bujqësore dhe inovacionit.			
Kodi i Programit (sipas kategorizimit të COFOG-ut)	041 - Çështjet e përgithshme ekonomike, tregtare dhe të punës				
Sistemi territorial që ndikohet	Nuk preken sistemet territoriale.				
Koston e përafërt	50,000,000 ALL				
Burime e mundshme të financimit	Bashkia / FZHR / FSHZH / Donatorë të ndryshëm				
Treguesi i vlërsimit/ ndjekjes	Përfundimi i projektit /rritja e bizneseve të themeluara/ rritja e të ardhurave të Bashkisë				
Palët e interesuara (partnerët)	Bashkia				
Gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekt Ide				
Veprimet për implementimin e ty	Hartimi i studimit. Ndërtimi i projektit.				
Kohëzgjatja	2 Vjet				
Fazat e Zbatimit	I: 2021	X			
	II: 2022-2023	X			
	III: 2024-2030				
	IV: 2031-2035				
Avantazhet/ rezultatet e pritshme	Mundësi bashkëpunimi me sipërmarrjet e tjera të lokalizuara në vend. Trajnim i vazhdueshëm dhe shërbime konsulente. Atraksion i sipërmarrjeve. Konsolidim i aktiviteteve investuese. Vende të reja pune, adoptim i një identiteti të ri prodhues (Agrobiznes) dhe konsolidim i produkteve për eksport.				
Rreziqe të mundshme	Pamundësi për atraksionin e sipërmarrjeve, konflikt ndërmjet mjedisit antropogen dhe sipërmarrjes ekzistuese, dhe për këtë arsyen nevojitet sigurimi i një rëndese minimalistë të mjedisit.				
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore	Nuk ka nevojë për ndryshime.				





Nr. rendor	Titulli	10.	Përmirësimi i aksesit në Maliq dhe Libonik		
Tipologja	Zhvillim Urban				
Vendndodhja e projektit	Maliq- Libonik				
Përshkrim i shkurtër	Përfshin: Krijimin e nyjeve dhe konsolidimin e ndriçimit.				
Qëllimi kryesor dhe rëndësia	Përmirësimi i aksesueshmërisë. Reduktimi i aksidenteve. Reduktimi i niveleve të ndotjes akustike.				
Në përputhje me:	Objektivi Strategjik Programi Strategjik	OS3: Zhvillimi i qëndrueshëm e zonave të urbanizuara PS3.2 Forcimi i rjetësimit dhe rigjenerimit të zonave urbane. PS3.3 Modernizim i infrastrukturës inxhenierike			
Kodi i Programit (sipas kategorizimit të COFOG-ut)	045 - Transporti				
Sistemi territorial që ndikohet	Nuk preken sistemet territoriale.				
Koston e përafërt	70,000,000 ALL				
Burime e mundshme të financimit	Bashkia/ FZHR/ Donatorë të ndryshëm				
Treguesi i vlërsimit/ ndjekjes	Përfundimi i projektit/				
Palët e interesuara (partnerët)	Bashkia				
Gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekt Ide				
Veprimet për implementimin e ty	Hartimi i Studimit. Konstruksion i projektit.				
Kohëzgjatja	4 Muaj				
Fazat e Zbatimit	I: 2021 II: 2022-2023 III: 2024-2030 IV: 2031-2035	X			
Avantazhet/ rezultatet e pritshme	Lehtësim i lëvizjes së banorëve. Përmirësim i lidhshmërisë dhe funksionim më i mirë i transportit. Konsolidim i marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet vendbanimeve. Konsolidim i rrjetit të transportit.				
Rreziqe të mundshme	Pamundësi për përfundimin e projektit. Mirëmbajtje e mangët e rrugës.				
Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore	Nuk ka nevojë për ndryshime.				





<b>Nr. rendor</b>	<b>Titulli</b>	<b>11.</b>	<b>Përimirësimi i bonifikimit të fushës të Malqit</b>
<b>Tipologja</b>		Zhvillim rural	
<b>Vendndodhja e projektit</b>		Nj. Administrative Pирg, Vreshtas, Pojan, Libonik	
<b>Përshkrim i shkurtër</b>		Përfshin: Krijimin e infrastrukturës kulluese ose krijimin e digave rregulluese për përbushjen e nevojave të tokave të punueshme.	
<b>Qëllimi kryesor dhe rëndësia</b>		Përmirësim i administrimit të ujit dhe përdorimi racional i tij. Rritje e sipërafares se tokës bujqësore.	
<b>Në përputhje me:</b>	<b>Objektivi Strategjik</b>	OS1: Zhvillim gjithpërleshirës i sektorit të bujqësisë	
	<b>Programi Strategjik</b>	PS1.4 Modernizim i infrastrukturës mbështetëse	
<b>Kodi i Programit (sipas kategorizimit të COFOG-ut)</b>		042 - Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia	
<b>Sistemi territorial që ndikohet</b>		Nuk preken sistemet territoriale.	
<b>Koston e përafërt</b>		150,000,000 ALL	
<b>Burime e mundshme të financimit</b>		Bashkia/ Donatore të ndryshëm	
<b>Treguesi i vlerësimit/ ndjekjes</b>		Përfundimi i projektit/ Miratimi dhe monitorimi i projektit të menaxhimit	
<b>Palët e interesuara (partnerët)</b>		Bashkia	
<b>Gatishmërinë e projektit për zbatim</b>		Projekt Ide	
<b>Veprimet për implementimin e ty</b>		Hartimi i Studimit	
<b>Kohëzgjatja</b>		1 vit	
<b>Fazat e Zbatimit</b>	I: 2021	X	
	II: 2022-2023		
	III: 2024-2030		
	IV: 2031-2035		
<b>Avantazhet/ rezultatet e pritshme</b>		Konsolidim i sektorit bujqësor dhe shfrytëzim i tokës së punueshme. Efikasitet i sistemit të ujitjes.	
<b>Rreziqe të mundshme</b>		Kushte klimaterike dhe mirëmbajtje e mangët e infrastrukturave.	
<b>Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore</b>		Nuk ka nevojë për ndryshime.	



Nr. rendor	Projekt	Kodi i Programit (spas Strategjikë)	Njësität administrative që i preket	Burimet e mundshme të financimit (000 ALL)	Përgjegjës për zhbatimin	Prioritet	Fazat e zhbatimit I: '21 II: '22/23 III: '24/30 IV: '31-35	Treguesi përmjet monitorimin e zhbitimit	Ndryshimet e nevojshme Institucionale dhe ligjore	Shënim
<b>Rigjenerimi dhe sistemi i urbane</b>										
1	Sistemin Urban i zonës urbane Maliq-Libonik	P53.3	062	Maliq	109.399	Bashkia / FZHR / Donatorë të ndryshëm	Bashkia Maliq	x	Përfundimi i veprës / Rritja e vizitueshmërisë dhe e aktiviteteve në zonë	Nuk ka nevojë për ndryshime.
2	Sistemin Urban Dritas	P53.3	062	Libonik	99.091	Bashkia / FZHR / Donatorë të ndryshëm	Bashkia Maliq	x	Përfundimi i veprës	Ka të bëjë me përmirësimin e hapësirave të përbashkëta (pajisje, gjelbërim, ndriçim, etj.) si dhe shtrirja e shtegut të faza satat e palateve.
3	Sistemin Urban Moglë	P53.3	062	Mogliç	50.000	Bashkia / FZHR / Donatorë të ndryshëm	Bashkia Maliq	x	Përfundimi i veprës / Rritja e vizitueshmërisë dhe e aktiviteteve në zonë	Nuk ka nevojë për ndryshime.
4	Sistemin Urban Pirg	P53.3	062	Pirg	80.000	Bashkia / FZHR / Donatorë të ndryshëm	Bashkia Maliq	x	Përfundimi i veprës / Rritja e vizitueshmërisë dhe e aktiviteteve në zonë	Nuk ka nevojë për ndryshime.
5	Sistemin Urban Podgorie	P53.3	062	Vreshnas	80.000	Bashkia / FZHR / Donatorë të ndryshëm	Bashkia Maliq	x	Përfundimi i veprës / Rritja e vizitueshmërisë dhe e aktiviteteve në zonë	Nuk ka nevojë për ndryshime.
6	Sistemin Urban Pojan	P53.3	062	Pojan	80.000	Bashkia / FZHR / Donatorë të ndryshëm	Bashkia Maliq	x	Përfundimi i veprës / Rritja e vizitueshmërisë dhe e aktiviteteve në zonë	Nuk ka nevojë për ndryshime.
7	Sistemin Urban Zvërnec	P53.3 P51.5	062	Pirg	50.000	Bashkia / FZHR / Donatorë të ndryshëm	Bashkia Maliq	x	Përfundimi i veprës / Rritja e vizitueshmërisë dhe e aktiviteteve në zonë	Nuk ka nevojë për ndryshime.
<b>Infrastruktura e transportit</b>										
8	Sistemin - Asfaltim rruga Maliq - Loshan (Rruja Nataionale)	P53.2	045	Maliq, Gorë	70.000	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë / Donatore të ndryshëm	ARRSH	x	Përfundim i projektit	Nuk ka nevojë për ndryshime.
9	Sistemin - Asfaltim rruga në Zvirnë	P53.2	045	Pirg	169.426	Bashkia / FSHZH / Donatore të ndryshëm	Bashkia Maliq	x	Përfundim i projektit	Nuk ka nevojë për ndryshime.
	Sistemin - Asfaltim rruga Shqiptas - Kakac	P53.2	045	Pirg	107.839	Bashkia / FZHR / Donatore të ndryshëm	Bashkia Maliq	x	Përfundim i projektit	Nuk ka nevojë për ndryshime.



nr. rendor	Projekti	Kodi i programit (sipas kategorizimit të CDFDG-ut)	Njësë administrative që i preket	Buxheti i nevojshtëm (000 ALL)	Burimet e mundëshme të finansimit	Përvelegjës për zbatimin	Prioritet			Treguesi përmes monitorimin e zbatimit	Ndryshimet e nevojshtme institucionale dhe ligjore	Shënimë
							I:	II:	III:			
11	Sistemim - Asfaltim rruga Vlaciشت - Drithas Pashët	PS3.2	045	Liberik	30.000	Bashkia Maliq	x			Përfundim i projektit	Nuk ka nevoje për ndryshime.	Gjatësia e përgjithshme rrëth 2.6 km.
12	Sistemim - Asfaltim rruga Sovjan - Novosele	PS3.2	045	Ping	40.000	Bashkia Maliq	x			Përfundim i projektit	Nuk ka nevoje për ndryshime.	Gjatësia e përgjithshme rrëth 2.9 km.
13	Sistemim - Asfaltim rruga Maliq - Kolanec	PS3.2	045	Maliq	85.000	Bashkia Maliq	x			Përfundim i projektit	Nuk ka nevoje për ndryshime.	Gjatësia e përgjithshme rrëth 3.2 km.
14	Sistemim - Asfaltim rruga Shqeras - Vreshtas	PS3.2	045	Vreshtas	70.000	Bashkia Maliq	x			Përfundim i projektit	Nuk ka nevoje për ndryshime.	Gjatësia e përgjithshme rrëth 7.1 km.
15	Sistemim - Asfaltim rruga Padgorë - Rezervuarit (korri e fshatit)	PS3.2	045	Vreshtas	50.000	Bashkia Maliq	x			Përfundim i projektit	Nuk ka nevoje për ndryshime.	Eshë trijeti i brendshem rrugor i fshatit.
Organizim i aktiviteteve - eventeve bazuar në një kalendar vjetor të temave të ndryshme.	Bashkia / Donatore të ndryshëm	1.500.000	500.000	500.000	500.000
Krijimi i itinerarit për lidhjen Maliq - Pylli i Fazaneve	Bashkia / FZHR / FSHZH / Donatore të ndryshëm	10.000.000	10.000.000		
Hartim i Planeve Sektoriale në nivel Bashkisë (PSNB)	Bashkia / FZHR / FSHZH / Donatore të ndryshëm	1.500.000			1.500.000
Qendra e përpunimit dhe shitjes për produktet blegtoriale dhe artizanale	Bashkia Maliq	20.000.000		10.000.000	10.000.000
Krijimi i një dyqani për promovimin e produkteve bujqësore lokale	Bashkia / FZHR / FSHZH / Donatore të ndryshëm	10.000.000	10.000.000		
Rilevim topografik i fushës të Maliqit	Bashkia / FZHR / FSHZH / Donatore të ndryshëm	2.000.000	2.000.000		
Regjistrimi i karakteristikave të tokës bujqësore, i pasurive dhe prodhimeve	Bashkia / FZHR / FSHZH / Donatore të ndryshëm	2.000.000	1.000.000	1.000.000	
Ngritja e Qendrës së informacionit dhe Tranqimit i femerëve	Bashkia / FZHR / FSHZH / Donatore të ndryshëm	0			
Shndërimi i qendrës tregtare në Pirg në pikë grumbullimi	Bashkia / FZHR / FSHZH / Donatore të ndryshëm	0			
Krijimi i pikave të grumbullimit në Rëmbec	Bashkia / FZHR / FSHZH / Donatore të ndryshëm	0			





Arsyetimi	Buçimet e mundëshme të financimit	Buxheti	I	II	
			2021	2022	2023
Krijimi i tregut në Maliq dhe Pojan	Bashkia / FZHR / FSHZH / Donatore të ndryshëm	20.000.000		10.000.000	10.000.000
Përmiresimi i kullotave	Bashkia / FZHR / FSHZH / Donatore të ndryshëm	0			
Krijimi - promovimi i kompleksit ekonomik- agro- ushqimor me drejtim ekologjik	Bashkia / FZHR / FSHZH / Donatore të ndryshëm	80.000.000	27.000.000	27.000.000	26.000.000
Plani i menaxhimit të emergjencave civile ndaj rreziqeve natyrore dhe teknologjike	Bashkia	3.000.000		1.500.000	1.500.000
Masat mbrojtëse (pasive dhe aktive) gjatë tij vjetore (antimetawisë fairomenon i rrëshqitjes në fshatrat Dolan (lagjia Musollari) dhe Kolanec	Bashkia	5.000.000		2.500.000	2.500.000
<b>Total</b>		<b>2.489.588.000</b>	<b>1.300.653.000</b>	<b>589.467.500</b>	<b>599.467.500</b>

Tabela 4.2.2: Plani i investimeve sipas prioriteteve brenda tre vjeçarit i Bashkisë Maliq

Sic duket edhe nga tabela, arkëtimet vjetore, do të janë në vlerën prej 1.300.653.000 Lekë për vitin e parë, 589.467.500 Lekë për vitin e dytë dhe 599.674.500 Lekë për vitin e tretë. Më poshtë, paraqitet diagrama në lidhje me ndarjen e arkëtimeve të investimeve sipas prioriteteve brenda tre vjeçarit.






Diagrama 4.2.1: Arkëtimet e investimeve sipas prioriteteve brenda tre vjeçarit për Bashkinë Maliq

Sic u përmend më lart, buxheti total i tre viteve sipas prioritetit të investimeve është në vlerën prej 2.282.834.000 Lekë. Në veçanti, nga totali i buxhetit të tre viteve, 955,533,000 Lekë ose në përqindje 41.86% i përket investimeve për infrastrukturat e transporteve, 748,343,000 Lekë ose 32.78% i përket investimeve për infrastrukturat sociale, 253,736,000 Lekë ose 11.11% i përket investimeve për rigjenerimet urbane, 126,500,000 Lekë ose 5.54% i përket investimeve për zhvillimin ekonomik, 60,000,000 Lekë ose 2.63% i përket investimeve në lidhje me infrastrukturat e administrimit të mbetjeve, 10,340,000 Lekë ose 0.45% i përket investimeve për mjedisin natyror dhe kulturor, 8,000,000 Lekë ose 0.35 % i përket investimeve në lidhje me mbrojtjen civile dhe të rendit publik dhe 1,000,000 Lekë ose 0.04% i përket investimeve në lidhje me infrastrukturat e energjisë, dhe së fundmi investimet për përmirësimin e administratës së Bashkisë dhe Infrastruktura e ujësjellësit & kanalizimeve dhe trajtimit te ujërave të ndotura dhe të shërbimit të qytetarëve në bazë trevjeçare dhe nuk do të shfaqin rezultate pasi nuk do të ketë investime përkatëse.





Arsyetim	Buxheti	I: 2021		II: 2022-2023	
		2021	2022	2022	2023
Sistemim urbane	418.490.000	309.091.000	54.699.500	54.699.500	54.699.500
Infrastruktura Rrugore	930.533.000	247.000.000	341.766.500	341.766.500	341.766.500
Infrastruktura e ujësjellësit & kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura	0	0	0	0	0
Infrastrukturë Vadtëse dhe Kulluese	119.382.000	105.189.000	7.096.500	7.096.500	7.096.500
Infrastrukturë energetike	1.000.000	0	500.000	500.000	500.000
Infrastruktura e menaxhimit të mbeturinave	60.000.000	10.000.000	25.000.000	25.000.000	25.000.000
Infrastrukturë Sociale	702.343.000	488.873.000	104.235.000	109.235.000	109.235.000
Përmirësim i administratës në Bashki	0	0	0	0	0
Mjedisi natyror dhe kulturor	9.340.000	0	170.000	9.170.000	9.170.000
Zhvillimi ekonomik	240.500.000	140.500.000	52.000.000	48.000.000	48.000.000
Mbrojtjen civile & Rendi publik	8.000.000	0	4.000.000	4.000.000	4.000.000
<b>Total</b>	<b>2.489.588.000</b>	<b>1.300.653.000</b>	<b>589.467.500</b>	<b>589.467.500</b>	<b>589.467.500</b>

Tabela 4.2.3: Plani i investimeve sipas prioriteteve, sipas llojut të investimit, brenda tre vjetarit, i Bashkisë Maliiq






Diagrama 4.2.2: Ndaria në përqindje e burimeve sipas llojit të investimeve, në investimet sipas prioriteteve të Bashkisë Maliq





Më poshtë paraqiten investimet që përbëjnë projekte - veprat me rëndësi kombëtare që kanë të bëjnë me Bashkinë e Maliqit brenda tre vjeçarit. Burimet e financimit ndryshojnë nga investimet e mësipërme.

Arsyetimi	Burimet e Financimit	Buxheti	I: 2021	II: 2022-2023	
			2021	2022	2023
Përmirësimi i rrugës SH71	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/ B.E. / FSHZH/ Donatore të ndryshëm	0			
Përmirësimi i pikave të zeba të rrjetit rrugor	Bashkia / IT / FSHZH / Donatore të ndryshëm	25.000.000	8.500.000	8.500.000	8.000.000
Ndërtim i linjës hekurudhore dhe stacionet hekurudhore në Maliq	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë / B.E. / Donatore të ndryshëm	0			
Studimi mbi vlerësimin mjedisor në zonat kyçe të biodiversitetit (KBA)	Bashkia / Ministria e Turizmit dhe Mjedisit / PPNEA / Donatore të ndryshëm	3.000.000		1.500.000	1.500.000
Promovimi i vendbanimeve prehistorike të Maliqit	Bashkia / DRTK / Donatore të ndryshëm / universiteteve të ndryshme në vend dhe jashtë vendit	7.500.000	2.500.000	2.500.000	2.500.000
Restaurimi dhe promovimi i Kalasë të Klocës dhe zonës më të gjerë Hija e Korbit	Bashkia / FZHR / DRTK / Donatore të ndryshëm / Universitete të ndryshme në vend dhe jashtë vendit	0			
Restaurim - mbrojtje dhe promovim i pasurive kulturore të tjera	Bashkia / FZHR / DRTK / Donatore të ndryshëm / universitetë të ndryshme në vend dhe jashtë vendit	0			
Krijimi i një itinerari të interesit historik dhe natyror	Bashkia / FZHR / DRTK / Donatore të ndryshëm / universitetë të ndryshme në vend dhe jashtë vendit	0			
<b>Total</b>		<b>35.500.000</b>	<b>11.000.000</b>	<b>12.500.000</b>	<b>12.000.000</b>

Tabela 4.2.4: Plani i investimeve, veprave të rëndësishëm kombëtare, brenda trevjeçarit në Bashkinë e Maliqit





Bashkia e Maliqit përmes programit PBA paraqet objektivat e mëposhtme që duhet të arrihen:

- Objktivi kryesor i PBA është përmirësimi i menaxhimit të shpenzimeve publike dhe përdorimi i fondeve.
- Prioriteti kryesor i PBA është zhvillimi ekonomik dhe bujqësor i zonës nëpërmjet përmirësimit të të gjithë infrastrukturës. Këto objektiva do të realizohen nëpërmjet investimeve në bujqësi, rrugë, mbrojtjen e mjedisit, forcimin e grupeve të reja dhe të cenueshme dhe përmirësimin e institucioneve kulturore, artistike dhe sportive dhe në promovimin e biznesit..
- Objektiva për të arritur janë shpërndarja dhe përdorimi më efikas i fondeve : forcimi i lidhjes midis programeve të bashkisë dhe alokimin e burimeve si dhe të ketë një kornizë të qëndrueshme për programin afatmesëm brenda të cilit planifikohen buxhetet vjetore..
- Disiplina taksave buxhetore

Shtyllat kryesore dhe synimet do të janë si më poshtë:

- Zhvillimi ekonomik i Bashkisë Maliq
- Inkurajimi i punësimit dhe sipërmarrjes
- Sigurimi i shërbimeve cilësore
- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore
- Garantimi i pastërtisë dhe zvogëlimi i ndotjes
- Rivitalizimi i jetës kulturore dhe sportive
- Rehabilitimi i objekteve arsimore, administrative, sociale

PBA e viteve 2018-2021 përfshin një numër projektesh që ose janë vënë ose pritet të vihen në zbatim. Përfshirë ndër të tjera:

- Sistemim –Asfaltim rrugë të brendshme,Rrj,Ujesjellsit+KUZ Fshati Zvirine (272 milion lekë)
- Sistemim -Asfaltim rrugë të brendshme+KUZ fshati Vloçisht (288 milion lekë)
- Qëndra Komunitare-Kulturore "Dhimitër Orgocka" Maliq (188 milion lekë)
- Ndërtim rrjeti i jashtëm dhe i brendshëm i ujesjellesit Symiz (15 milion lekë)
- Rregullator i Ri i Maliqit (78 milion leke)
- Thellim i Lumit Devoll (65 milion leke)
- Ndërtimi i Palestrës dhe rikonstrukcion i shkollës së mesme e Maliqit (60 milion leke)
- Ndërtim i Palestër në Shkollën e Mesme të fshatit Pirg (37 milion lekë)
- Ndërtimi i kopshteve të femijeve në Sovjan, Sheqeras, Libonik (60 milion lekë)

Qëllimi i investimeve të mësipërme është përmirësimi i cilësisë së infrastrukturës rrugore si dhe përmirësimi i cilësisë së jetës si arsimi dhe furnizimi me ujë dhe kanalizimet. Këto projekte sipas Tabelës 4.2.2, duhet të përfundojnë deri në vitin 2023.

Bashkia e Maliqit për të përfunduar planet e investimeve varet nga rritja e burimeve buxhetore nga të gjitha burimet,transfertat e pakushtëzuara, transfertat specifike, pranimet e planikuara si dhe fondet e deleguara që marrin nga buxheti i shtetit për investime, të cilat për vitin 2012 tregojnë rezultate më pozitive krahasuar me vitet e kaluara.





Sipas PBA, Bashkia e Maliqit për periudhën 2019-2021 parashikon një ristrukturim të të ardhurave në lidhje me mënyrën e blerjes. Shumat do të vijnë në Bashki nga nga tarifat, qiratë, taksat dhe burime të tjera të të ardhurave siç janë të ardhurat e trashëguara. Kjo do të ndihmojë Bashkinë ne alokimin dhe shpërndarjen e të ardhurave për vitet në vijim sa i përket shpenzimeve të parashikuara në kuadër të programeve komunale dhe të zhvillimit.

Nga analiza e mëparshme për Qarkun e Korçës dhe në veçanti për Bashkinë e Maliqit ka disa probleme të mëdha që duhet të adresohen në mënyrë që Bashkia të paraqesë tregues ekonomikë pozitivë. Së pari, Bashkia duhet t'i japë prioritet investimeve në infrastrukturën e transportit që do të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të zonës, pasi që rrjetet më të mira rrugore do të çojnë në rritje në industri, bujqësi dhe turizëm dhe në zhvillimin e standardeve të jetesës. Përveç kësaj, bashkia duhet të synojë në investime për infrastrukturën sociale dhe rigjenerimin urban. Kjo do të kontribuojë në ngritjen e standardit të jetesës të zonës, rritjen e nivelit arsimor, si dhe rritjen e turizmit, një sektor që bashkia kërkon të fitojë. Së fundi, si një zonë thjesht bujqësore, bashkia duhet gjithashtu t'i japë përparësi investimeve në infrastrukturën e ujitjes, pasi ajo do të ndihmojë në rritjen e prodhimit dhe përfitimeve të ndërmarrjeve bujqësore dhe të gjithë njerëzve në përgjithësi pasi është sektori më i rëndësishëm i ekonomisë së rajonit dhe banoreve në përgjithësi pasi është sektori më i rëndësishëm i ekonomisë së zones.

#### 4.3. Ndryshimet në kuadrin ligjor dhe administrative në nivel vendor

Propozohen ndryshime administrative në organizimin dhe funksionimin e Bashkisë, të cilat janë paraqitur më hollësisht në kapitullin "Kapaciteti institucional". Qëllimi është që përmes strukturës së re të Bashkisë të arrihet funksionimi më efikas dhe më racional i departamentit të Bashkisë i cili është përgjegjës për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, ofrimin e shërbimeve bashkëkohore që korrespondonjë me nevojat aktuale dhe monitorimin më të mirë të projekteve dhe veprimeve, për të cilat bashkia ka përgjegjësinë për ti zbatuar.

Për sa i përket legjislacionit të zbatueshëm të përgjithshëm dhe specifik propozohen përshtatje me çështjet e mëposhtme:

- shfrytëzimin e parkut industrial. Në veçanti, është propozuar lehtësimi i procedurave për përdorimin dhe dhënien me qira e pasurive të patundshme të bashkisë.
- krijimin, organizimin dhe mbështetjen e zonave të biznesit/ekonomike/industriale (p.sh. funksionimi i një organi menaxhues, sigurimi i stimujve financiarë dhe tatimorë, subvencione për ndërtimin e infrastrukturës teknike).
- krijimin dhe funksionimin e shoqatave të fermerëve.
- licencimin dhe kategorizimin e shërbimeve të akomodimit të agroturizmit
- promovimin e bujqësisë dhe blegtorisë organike (p.sh. stimujt financiarë, përjashtime nga taksat, koncesione për shfrytëzimin e tokës, etj.).
- lehtësimin dhe promovimin e telemjekësisë për të ofruar shërbime elektronike cilësore organet kompetente (p.sh. spitalet).





- Arsimi dhe aftësimi profesional i një fuqie punëtore të kualifikuar.

Propozohet krijimii kurrikulavetë rejanë shkollat profesionale me orientim bashkë kohor që do të fokusohet në sektorë specifikë, të tilla si restaurimiin dërtesave tradicionale, përdorimi i teknologjive të reja dhe të menaxhimi i integruar në bujqësi, përgatitjene specialistëvetë kualifikuar për turizmin lokal.

Nga aplikimi i PPV-së rezulton hartimi i studimeve, miratimi i të cilëve do të ketë pasoja juridike. Të tilla janë studimet e planifikimit urbanistik, si PDV dhe PSNB, si edhe studimet e mjedisit, të tilla si Plani i Menaxhimit për Pylli i Fazanëve.

Për më tepër, pas përgatitjes dhe miratimit të studimeve të propozuara për zonat që janë kandidate për t'u përcaktuar si zona kyçë të biodiversitetit (KBA) ka të ngjarë të kërkohet përfshirja e tyre në statusin e mbrojtjes sipas ligjit në fuqi për zonat e mbrojtura apo marrja e masave të menaxhimit dhe veprimit.

Për zbatimin e shumë projekteve, veçanërisht atyre teknike (të tilla si ato të përmirësimit të rrugëve, konfigurimi i nyjeve, trajtimi i ujërave të zeza, ndërtimi i veprave të kullimit), do të kërkohet shpronësimi i tokës në një masë më të vogël ose më e madhe, fakt i cili do të kërkojë iniciativa dhe procese administrative dhe legjislative.

Gjithashtu, ndoshta do të kërkohet krijimi i entitete të reja juridike për zbatimin dhe menaxhimin e projekteve të caktuara të veçanta me rëndësi kombëtare, të tilla si zgjerimi i linjës hekurudhore në bashki dhe ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes së gazit natyror nëpër shtëpitë, bizneset dhe njësitë industriale.

Së fundi, me interes është niveli i përfshirjes së Bashkisë gjatë procesit të licencimit të HEC-eve, guroreve, minierave. Sygjerohet që të merret pëlqimi i bashkisë në lidhje me nevojshmërinë e këtyre aktiviteteve (p.sh. vendodhjen, kapacitetin dhe vlerësimin e ndikimevenë mjedis), si dhe përfitime të mundshme nga këto aktivitete (qoftë në formë ne parave ose në formë ne përfitimeve reciproke, p.sh. infrastruktura sociale).

#### 4.4. Indikatorët e monitorimit për zbatimit të PPV-së

Ky kapitull lidhet me monitorimin dhe vlerësimin e PPV-së, në lidhje me arritjen dhe progresin e zbatimit të objektivave të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara për zbulimin e vonesave ose dështimeve dhe sugjerimin e zgjidhjeve për vendimmarrje dhe zbatimin e veprimeve për të siguruar ecurinë e suksesshme të PPV-së për një hark kohor pesëmbëdhjetëvjeçar.

Monitorimi vlerëson procesin e zbatimit të planit, me qëllim planifikimin e veprimeve të nevojshme për të siguruar monitorimin e suksesshëm të PPV-së i cili kryhet në bazë të të dhënave relevante që çdo institucion përkatës i ofron Sektorit për Planifikim dhe Zhvillim te Bashkisë.

Treguesit për monitorimin e zbatimit të PPV janë të listuara si më poshtë:





Treguesit për monitorimin e zbatimit të PPV	
<b>1. Rigjenerim dhe sistemim urbane</b>	
1.1.	Numri i rigjenerimeve urbane të zbatuara
1.2.	Sipërfaqja e rigjenerimeve urbane të zbatuara ( $\text{km}^2$ )/ Sipërfaqe totale urbane ( $\text{km}^2$ )
1.3.	Metra trotuarësh të krijuaraose te sistemuara/ gjatësia e rrugëve lokale (m)
1.4.	Sipërfaqet e gjelbra të sistemuara ( $\text{km}^2$ )
1.5.	Sipërfaqe me mbjellje pemësh në trotuarët ( $\text{km}^2$ )
1.6.	Numri i apartamenteve / banesave të reja për çdo pesë vjet
1.7.	Numri i lejeve të reja të ndërtimit për banesa në përpunje me regulloren e PPV, për çdo pesë vjet në vendbanimet e Bashkisë
1.8.	Ndërtime informale ne terren për çdo pesë vjet
<b>2. Infrastruktura Rrugore</b>	
2.1.	Numri i km të rrugëve të rreja/ rrjeti rrugor ekzistues (km)
2.2.	Numri i hapësirave për parkim/ Numri i banërove
2.3.	Numri i hapësirave për parkim te organizuara (parking bashkiak)/ Numri i banërove
<b>3. Infrastruktura e ujësjellësit &amp; kanalizimeve dhe trajtimit te ujërave të ndotura</b>	
3.1.	Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit të ri (km)
3.2.	Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit të ri/ Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit ekzistues
3.3.	Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit të ri/ Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit të propozuar
3.4.	Numri i rikonstrukioneve ose përmirësimeve për çdo kategori të rrjetit ekzistues të ujësjellësit
3.5.	Numri i rikonstrukioneve ose përmirësimeve për çdo kategori të rrjetit ekzistues të kanalizimeve
3.6.	Nr i banorëvë që shërbehen nga rrjeti i kanalizimeve/ Total i popullsisë të bashkisë
3.7.	Gjatësia e rrjetit të kanalizimeve të ri/ Gjatësia e rrjetit të kanalizimeve të propozuar
<b>4. Infrastrukturë Vaditëse</b>	
4.1.	Gjatësia e rrjetit vaditës të ri (km)
4.2.	Gjatësia e rrjetit vaditës të ri/ Gjatësia e rrjetit vaditës ekzistues
4.3.	Gjatësia e rrjetit vaditës të ri/ Gjatësia e rrjetit vaditës të propozuar
4.4.	Numri i rikonstrukioneve ose përmirësimeve për çdo kategori të rrjetit vaditës ekzistues
4.5.	Gjatësia e rrjetit vaditës të ri/ Gjatësia e rrjetit vaditës të propozuar
<b>5. Infrastrukturë e menaxhimit të mbetjeve</b>	
5.1.	Numri i koshave/Territori gjeografik
5.2.	Numri i koshave të riçiklimit/Territori gjeografik





Treguesit për monitorimin e zbatimit të PPV	
5.3.	Volumi ditor i mbetjeve urbane ( $m^3$ )
5.4.	Evente për ndërgjegjësimin e e banoreve për çeshtjet e riçiklimit/ vit
5.5.	Volumi total i mbetjeve të ricikluara
6. Infrastruktura Rrugore	
6.1.	Numri i km rrugore të rreja/ rrjeti rruge ekzistues (km)
6.2.	Numri i hapësirave për parkim/ Numri i banërove
6.3.	Numri i hapësirave për parkim të organizuara (parkim bashkiak)/ Numri i banërove
7. Infrastrukturë Sociale	
7.1.	Numri i njësive të shërbimit ambulator që krijohen/ rikonstruktohet/ përmirësohet
7.2.	Numri i njësive arsimore që përmirësohen / vit
7.3.	Sipërfaqe e terreneve shkolllore qe janë sistemuar, përmirësuar ( $km^2$ )
7.4.	Numri i programeve qe u organizuan për arsim të të rriturve-të mësuarit të përjetëshëm/ vit
7.5.	Numri i njësive dhe infrastrukturës sportive të sistemuar ose përmirësuar ose zgjeruar / vit
7.6.	Numri i njësive dhe infrastrukturës kulturore të sistemuar ose përmirësuar ose zgjeruar / vit
7.7.	Numri i programeve vullnetare të organizuara / vit
7.8.	Numri i programmeve për promovimin e kohezionit social / vit
8. Zhvillimi ekonomik	
8.1.	Numri i punonjësve të punësuar për zbatimin e Planit.
8.2.	Numri i përfituesve nga zbatimi i projekteve të planit
8.3.	Numri i subjekteve që pëfitojnë nga rigjenerimet urbane
8.4.	Numri i subjekteve që pëfitojnë nga projektet për zhvillimin rural
8.5.	Numri i subjekteve të reja në sektorin bujqësor / vit
8.6.	Numri i subjekteve të reja në sektorin blegtoral / vit
8.7.	Numri i subjekteve të reja në sektorin agropërpunues/ vit
8.8.	Numri i subjekteve të reja në sektorin e turizmit-shërbimeve/ vit
8.9.	Numri i subjekteve të reja në sektorin industrial/ vit
8.10.	Numri i programeve të zbatuara për zhvillimin e biznesit lokal
8.11.	Numri i programeve të zbatuara për zhvillimin e punësimit lokal
8.12.	Numri i produkteve të certifikuara të markës vendase





<b>Treguesit për monitorimin e zbatimit të PPV</b>	
<b>8.13.</b>	Numri i produkteve të çertifikuara të markës vendase / vit
<b>8.14.</b>	Përqindja e shtimit të akomodimit për çdo natë në hotele
<b>8.15.</b>	Përqindja e shtimit të vizitorëve në zonat rekreative të bashkisë
<b>8.16.</b>	Përqindja e shtimit të vizitorëve në faqen elektronike në lidhje me reklamimin turistik të Bashkisë
<b>8.17.</b>	Evolucioni i sasisë së produkteve bujqësore të prodhua (sasia për produkt të prodhuar)
<b>8.18.</b>	Numri i vendeve të reja të punës për çdo pesë vjet në aktivitetet ekonomike
<b>8.19.</b>	Numri i strukturave akomoduese turistike sipas llojit
<b>8.20.</b>	Numri i turistëve të kënaqur nga eksperiencia e tyre në territor
<b>8.21.</b>	Numri i turistëve vizitorëve / ekskursionistëve/ turistëve në muaj
<b>8.22.</b>	Qëndrimi mesatar i vizitorëve në territor
<b>8.23.</b>	Lloji i transportit të përdorur nga vizitorët
<b>9. Mjedisi natyror dhe kulturor</b>	
<b>9.1.</b>	Numri i rikonstrukioneve në ndërtesave historike/ Totali i ndërtesave historike
<b>9.2.</b>	Gjatësia (km) e shtigjeve të pastruar dhe me sinjalistikë/ gjatësinë e shtigjeve totale
<b>9.3.</b>	Numri i programeve të zbatuara për sensibilizimin dhe mbrojtjen e mjedisit.
<b>9.4.</b>	Numri i eveneve kulturore të organizuara
<b>9.5.</b>	Numri i monumenteve të regjistruara
<b>10. Përmirësim i administratës në Bashki</b>	
<b>10.1.</b>	Numri i vizitorëve në faqen e internetit/ 6 mujor
<b>10.2.</b>	Numri i shërbimeve elektronike ndaj qytetarëve/ Numër i shërbimeve që mundet të disponohen në mënyrë elektronike
<b>10.3.</b>	Numrat e aplikacioneve të cilat u aktivizuan për shërbimin e qytetarëve.
<b>10.4.</b>	Numri i njësive "one stop shop"
<b>10.5.</b>	Numri i kërkesave qe u shërbyen në mënyrë elektronike/ vit
<b>10.6.</b>	Koha mesatare e shërbimit të qytetarit
<b>10.7.</b>	Numri i kompjuterave/ punonjësve
<b>10.8.</b>	Numri i punonjësve që marrin pjesë ne seminare/ vit
<b>10.9.</b>	Shpenzime për Investime/ Shpenzime totale
<b>10.10.</b>	Numri i indikatorëve që përdoren për monitorimin e cilësisë që përdoren
<b>10.11.</b>	Numri i bashkëpunimeve që u nënshkruan (nderbashkiake, ndërkombetare)





Treguesit për monitorimin e zbatimit të PPV	
10.12.	Numri i veprimeve për promovimin e shërbimeve ndaj qytetarit
10.13.	Numri dhe kategori i njoftimeve ndaj qytetarit, institucioneve

Tabela 4.3.1 Treguesit për monitorimin e zbatimit të PPV

#### 4.5. Evidentimi i faktorëve që mund të çojnë në nevojën e rishikimit të PPV-së

Në nenin 26 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 "Përplanifikimindhezvillimin e territorit" referohen kushtet dhe faktorët që mund të kontribuojnë në rishikimin e PPV. Në mënyrë specifike PPV ndryshohen edhe kur kanë ndarje administrative dhe territoriale, ndryshime të paparashikuara demografike, sociale dhe ekonomike, ndryshimet ëshkaktuara nga kriza sektoriale apo nga forca madhore, si dhe në rastet kur lind nevoja e harmonizimit me dokument e të një niveli më të lartë planifikimi (p.sh. Planet sektoriale në nivel Qarku - PSNQ, Planet e detajuara për zonatë rëndësisë kombëtare - PDZRK) apo të përafrimët me legjislatin e Bashkimit European.





## 5. KAPACITETI INSTITUCIONAL

### 5.1. Vlerësimi i shpejtë i kapaciteteve institucionale të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) të Bashkisë

Veprimet e Drejtorisë së planifikimit dhe zhvillimit të zonës dhe strehimit së Bashkisë Maliq kanë si marrës kryesorë (të drejtëpërdrejtë ose indirektë) qytetarët / banorët e Bashkisë Maliq. Së dyti, në grupin e përdoruesve të shërbimeve teknike të Bashkisë përfshihen edhe kontraktuesit dhe furnizuesit që "ekzekutojnë" punime për llogari të Shërbimit, si edhe shërbime të ndryshme të Bashkisë ose Ente të sektorit publik për llogari të të cilëve Shërbimi në fjalë ekzekuton aktivitetet.

Aktivitetet e Drejtorisë së planifikimit dhe zhvillimit të zonës dhe strehimit, të Bashkisë Maliq zhvillohen në përputhje me rregullat ligjore siç specifikohen në legjisacionin në fuqi. Aktivitetet më të rëndësishme të Shërbimit përfshijnë programatizimin e veprave teknike, hartimin e studimeve dhe mbikqyrjen e ekzekutimit të veprave, çështje të planifikimit hapësinor / urban, zbatime urbane - kadastër, formimin – programatizimin dhe ndjekjen e punimeve të Sektorit, ndërsa paralelisht në kuadrin e kompetencave të Drejtorisë në fjalë, inkuadrohen edhe çështje të mbrojtjes së mjedisit, të shëndetit publik dhe administrimit të Cilësisë së Përgjithshme, hartimi i studimeve të qarkullimit dhe planifikimi i veprave dhe rregullave të qarkullimit dhe zbatimet e energjisë.

Theksohet fakti se aktivitetet që realizon Shërbimi në fjalë, në kuadrin e objektit që duhet të përbushë nga aspekti ligjor, në shumicën e tyre përbëjnë ndërhyrje në hapësirë (vepra ndërtimi të infrastrukturave, vepra zëvendësimi, etj.) që financohen nga burime të ndryshme (Programe Financimi nga të tretët, pjesëmarrje kombëtare, burimet e vetë organizmave të administratës vendore, kapitale rezervë të vitit të kaluar) dhe i përkasin zhvillimit lokal dhe përmirësimit të infrastrukturave brenda dhe jashtë rrjetit urban. Përveç këtyre, ekzekuton edhe punime zbatimi (punë zyre), si për shembull nxjerrjen e lejeve, certifikatave të përdorimit, etj.

Në veçanti, aktivitetet e Drejtorisë dhe output-et e produhuara nga ajo formulohen analitisht në tabelën e mëposhtme.

AKTIVITETI	OUTPUT-I VJETOR
Drejtoria e planifikimit dhe e zhvillimit të zonës dhe e strehimit:	<ul style="list-style-type: none"><li>Kontroll i veprave të ndërtuara</li><li>Kontroll i arkitekturës dhe i planifikimit urban të veprave</li><li>Digjitalizim i hartave</li><li>Kontroll i rrjetit të veprave</li><li>Programatizim i zhvillimit të veprave dhe detyrate përsa i përket planifikimit të investimeve publike</li><li>Mbajtje e arkivës teknike</li><li>Kontroll i realizimit të veprave</li><li>Lëshim Certifikatash –Vërtetimesh të llojeve të ndryshme</li><li>Hartim dhe mbikqyrje studimesh, me objekt mbrojtjen e mjedisit</li><li>Transporte dhe leje banimi</li><li>Përballje e nevojave urgjente</li></ul>

Tabela 5.1.1: Output-et e produhuara të Drejtorisë së Shërbimeve Teknike





Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të zonës dhe strehimit, me veprat - veprimet që janë në zhvillim, të cilat i ka vendosur prioritet gjatë pesëmbëdhjetë vjeçarit të ardhshëm, (2020 dhe 2034), synon të realizojë vepra – veprime me buxhet total në vlerën prej 6.653.735.000,00 Lekë, duke shfrytëzuar burimet e forta të financimit (Programe Ndërkontinentale, Europiane dhe Amerikane, pjesëmarrja kombëtare, vetë burimet e Organizmave të Vjetëadministrimit Vendor (Fondi Rajonal, Fondi i Komunitetit) dhe kapitale rezervë të vitit të kaluar). Thesohet fakti se për realizimin e veprave të ndërtimit, rindërtimit dhe atyre që kanë objekt të përafërt, hartimin e studimeve, ofrimin e shërbimeve si edhe për mblerjen e furnizimeve, për tre vjeçarin e ardhshëm, buxheti është në vlerën prej 2.796.978.000,00 Lekë.

Më poshtë paraqiten investimet e prioritetit të parë përvitet 2021-2022-2023.

Arsyetim	Buxheti	I: 2021		II: 2022-2023	2023
		2021	2022		
Sistemim urbane	418.490.000	309.091.000		54.699.500	54.699.500
Infrastuktura Rrugore	930.533.000	247.000.000		341.766.500	341.766.500
Infrastruktura e ujësjellësit & kanalizimeve dhe trajtimit te ujërave të ndotura	0	0		0	0
Infrastrukturë Vaditëse dhe Kulluese	119.382.000	105.189.000		7.096.500	7.096.500
Infrastrukturë energjetike	1.000.000	0		500.000	500.000
Infrastruktura e menaxhimit të mbeturinave	60.000.000	10.000.000		25.000.000	25.000.000
Infrastrukturë Sociale	702.343.000	488.873.000		104.235.000	109.235.000
Përmirësim i administratës në Bashki	0	0		0	0
Mjedisi natyror dhe kulturor	9.340.000	0		170.000	9.170.000
Zhvillimi ekonomik	240.500.000	140.500.000		52.000.000	48.000.000
Mbrojtjen civile & Rendi publik	8.000.000	0		4.000.000	4.000.000
<b>Totali</b>	<b>2.489.588.000</b>	<b>1.300.653.000</b>		<b>589.467.500</b>	<b>599.467.500</b>

Tabela 5.1.2 : Plani i investimeve sipas prioriteteve, sipas llojit të investimit, brenda tre vjeçarit për Bashkinë Mali





Për realizimin e veprave – veprimeve të sipërpërmendura, arritjen e qëllimeve, por, kryesisht për mbulimin e nevojave, kërkohen burime të cilat nuk janë gjithmonë të disponueshme. Për këtë arsy, çdo vit hartohet Programi i veprave sipas prioriteteve për çdo periudhë administrimi (Programi Teknik Vjetor). Ndërkohë, përvèç zbatimit të këtij Programi, Shërbimi vazhdon të ketë probleme, pasi si problemin më kryesor ka realizimin e veprave – veprimeve, vonesën në pagesa të udhër-pagesave, fakt i cili përfshin vonesa të mëdha kohore për përfundimin e veprimeve. Vonesa në pagesa i detyrohet, mbi të gjitha, fluksit jo të rregullt financiar të programeve, por edhe problemeve të kreditimeve të disponueshme të Bashkisë Maliq.

Gjithashtu, lind një problem i rëndësishëm gjatë fazës së realizimit, në rastet kur vlera e financimit të veprave zhvillimore është më e vogël se ajo e parashikuar paraprakisht, duke patur si rezultat nevojën për mbështetje financiare nga burime bashkiake. Duke patur parasysh mënyrën e funksionit të problemeve tashmë ekzistuese, nuk ekzistojnë hapësira përmirësimi të efikasitetit dhe efektivitetit të aktiviteteve të Shërbimit pa rritjen e domosdoshme të burimeve.

Nga ana e qytetarëve, aktivitetet dhe shërbimet e ofruara të Drejtorisë në fjalë të Bashkisë Maliq nga aspekti sasior mbulojnë mjaftueshëm madhësinë e kérkesës. Ndërkohë, ekzistojnë mjaft ankesa nga qytetarët, që lidhen qoftë me problemet (dëme, mungesa në infrastruktura, rrjet rrugor, etj.) në qytet dhe ndikojnë në përditshmërinë e tyre, qoftë në cilësinë e shërbimeve dhe ofrimin e tyre, për mbulimin e të cilave Shërbimi bën përpjekje të vazdueshme. Shumica e ankesave nga ana e qytetarëve, që lidhen me shërbimin e tyre, fokusohet në vonesat kohore të përgjigjes ndaj kérkesave të tyre, që lidhen veçanërisht me zëvendësimet e dëmeve teknike.

Në shërbimin në fjalë, regjistrohen mungesa të rëndësishme parësore përsa i përket zbatimit të procedurave të programatizimit, ndjekjes dhe vlerësimit të veprimeve të tij. Këto mungesa rezultojnë, por njëkohësisht forcohen, edhe nga problemet që shketësojnë, jo vetëm Drejtorenë në fjalë, por të gjithë Organizmin e administratës Vendore të Bashkisë Maliq dhe u përkasin çështjeve të organizimit dhe administrimit, programatizimit, hierarkisë, prodhueshmërisë, koordinimit, madje edhe komunikimit të brendshëm ndërmjet Sektorëve dhe përgjithësisht, të strukturës organizative.

Zgjidhja e problemeve të sipërpërmendura, zbatimi i sistemeve dhe metodave të përmirësimit të efikasitetit të procedurave funksionale të Shërbimit, si edhe administrimi/përballja e faktorëve ekzogenë (psh. vonesa në pagesa të urdhër-pagesave) që shkaktojnë probleme në realizimin dhe përfundimin e veprave, gjykohen si pikë kyçe të përmirësimit të cilësisë dhe të efikasitetit të aktiviteteve të Drejtorisë së Shërbimeve Teknike të Bashkisë Maliq, me aks kryesor shërbimin më të mirë dhe më të shpejtë të qytetarit.

Përsa i përket komunikimit të Drejtorisë me marrësit e saj, theksohet fakti se ekzistojnë pjesërisht mungesa. Përdoruesit e shërbimeve teknike (kontraktori të Punëve Publike, furnitorë, etj.) informohen me të gjitha mënyrat e parashikuara nga ligji në lidhje me shërbimet e ofruara dhe veprimet e parashikuara të Drejtorisë në fjalë. Për informimin e grupeve të marrësve në lidhje me çështje të përgjithshme, Drejtoria e Shërbimeve Teknike e Bashkisë boton Njoftime për Shtyp ose edhe botohen çështjet e Këshillit Bashkiak. Ndërkohë, mungesa regjistrohen edhe në lidhje me informimin e të gjithë qytetarëve për llojet dhe numrin e shërbimeve të ofruara ose për veprat që ndodhen në fazë realizimi dhe, për pasojë, shkaktojnë probleme/pavolitshmëri në lëvizjen e tyre të përditshme (psh. rrjetet e rrëfimeve).





rrugore, ndërtesa të reja, etj.). Për rrjedhojë, informimi i Veprës së prodhuar të Drejtorisë së Shërbimeve Teknike përbën përparësi për Bashkinë, kryesish për informimin e qytetarëve për mosfunkcionime emergjente brenda rrjetit urban.

### **Kuadri ligjor**

Duke shqyrtuar dispozitat sipas të cilave rekomandohen dhe funksionojnë drejtoritë e planifikimit urban dhe zhvillimit, ato përcaktohen nga Ligji 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar.

Ky ligj synon sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të zonës nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe burimeve natyrore. Ai vlerëson mundësitë reale dhe të ardhshme të zhvillimit të tokës në nivel lokal dhe kombëtar, duke balancuar burimet natyrore me kërkësen ekonomike dhe interesin publik dhe privat. Gjithashtu, synon të koordinojë përpjekjen për:

- i. Ruajtjen e burimeve natyrore, si toka, ajri, uji, pyjet, flora dhe fauna.
- ii. Krijimin e tokave të përzgjedhura për ndërtimin funksional.
- iii. Promovimin e ekonomisë, jetës sociale dhe kulturore në nivel lokal dhe kombëtar.
- iv. Ruajtjen e burimeve që ofrojnë një furnizim të mjaftueshëm.
- v. Ofrimin për sigurinë e jetës, sigurinë kombëtare, rendin publik dhe shëndetin publik.
- vi. Promovimin e zhvillimit të barabartë rajonal për sigurimin e ndarjes së qendrueshme të popullsisë.

Në nenin 14 të Ligjit 107/2014, përcaktohen kërkesat minimale për numrin dhe specializimin e nëpunësve, përsa i përket planifikimit urban dhe kontrollit të zhvillimit. Më konkretisht, përmendet se:

1. Çdo bashki duhet të institucionalizojë organe, kompetenca e të cilave do të jetë ekzekutimi i aktiviteteve që kryhen, përsa i përket planifikimit hapësinor dhe kontrollit të zhvillimit, ashtu siç ato përcaktohen nga legjislacioni në fuqi dhe dispozitat e ligjit në fjalë.
2. Duhet të tregohet vëmendje për parimet e vetëadministrimit lokal, me qëllim që profesionistët të kenë kualifikimet përkatëse dhe eksperiencën e punës në sektorët përkatës për ekzekutimin e detyrave që parashikohen në ligjin në fjalë. Numri minimal i profesionistëve që duhet të ketë çdo njësi vendore vetëadministrimi duhet të përcaktohet nga Këshilli Ministror në bazë të madhësisë së popullsisë të njësive të vetëadministratës vendore, por në asnjë rast ky numër nuk duhet të jetë më i vogël se gjashtë profesionistë.
3. Formimi akademik i profesionistëve për çdonjërin prej katër sektorëve që përcaktohen në paragrafin 2 të nenit në fjalë përcaktohet këtu:
  - a. Për planifikimin territorial: planifikimi urban, hapësinor dhe territorial dhe administrimin, urbanistikë apo planifikim urban dhe specialitetë të tjera të përaferta, në përputhje me legjislacionin për arsimimin.
  - b. Për kontrollin e zhvillimit: specialitetet që përcaktohen në hapësirën (a) të paragrafit në fjalë, juridik, arkitekturë, inxhinieri ndërtimi, topogeodezi.

Për mbrojtjen mjedisore: administrim i mjedisit urban, inxhinieri mjedisore dhe agromjedisor, arkitekturë dhe planifikim fushe, gjeologji, inxhinieri pyjore.





- d. Për administrimin e amzës: GIS dhe topogeodezi, ose në rast mungese, planifikim urban territorial, urbanistikë, planifikim urban, inxhinieri ndërtimi, ose arkitekturë me arsim dhe eksperiencë në GIS dhe topogeodezi.
4. Në rastet kur nuk është e mundur të përmbushen kërkesat e paragrafeve 2 dhe 3 të nenit në fjalë, vetëadministratat vendore do të duhet të ushtrojnë planifikimin e tyre territorial dhe zhvillimin nëpërmjet ngarkimit të punës te ndërqeverisja vendore, në zbatim të legjislacionit.

Autoritetet vendore urbanistike ushtrojnë kompetencat e tyre në të gjithë sipërfaqen e tyre administrative.

#### ***Organizimi – Struktura – Potenciali Njerëzor & Infrastruktura e Logistikës***

Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të zonës dhe strehimit, ka një strukturë unique dhe nuk formohet nga Sektorë/Zyra të mëvetësishme.

Në vija të përgjithshme, megjithë mungesën e sektorëve të rëndësishëm në strukturën e drejtorisë në fjalë, mungesën e procedurave të standartuara dhe të dokumentuara të programatizimit, ndjekjes dhe vlerësimit të aktiviteteve dhe zbatimin e një plan veprimi vjetor dhe jo afatmesëm, nuk duket se ekzistojnë probleme serioze të organizimit dhe administrimit në mjeshterin e brendshëm të drejtorisë në fjalë.

Ndërkohë, drejtoria në fjalë, si një prej sektorëve jetikë të Organizmit të vetëadministratës Vendore, ndikohet logjikisht nga problemet organizative të gjera që shqetësojnë Bashkinë. Për shembull, mungesa e personelit shkencor të specializuar në pozicionet kyçë të Organizmit, mungesa e komunikimit të brendshëm dhe informimit, ose edhe zbatimi i programatizimit afatgjatë, e bëjnë joefikas mekanizmin e prodhimit të Veprës së Bashkisë, duke penguar njëkohësisht edhe veprimet e Drejtorisë.

Nga personeli total i Bashkisë, gjashtë (9) nëpunës janë pjesë e personelit të drejtorisë në fjalë. Më konkretisht, në Drejtoren e Bashkisë, 8 nëpunës kanë arsim të lartë dhe 1 nëpunës është me arsim të mesëm dhe ka njohuri të gjuhëve të huaja (anglisht), ndërsa dy flasin edhe italisht dhe njëri prej tyre rusisht. Gjithashtu, të gjithë nëpunësit kanë, të paktën njohuritë bazë të përdorimit të kompjuterit dhe të programeve të tij.

Tabela në vijim formulon analitisht numrin e nëpunësve të Drejtorisë së Bashkisë sipas nivelit të Arsimit.

Struktura Administrative e Bashkisë	Numri i Nëpunësve	Të diplomuar me arsim të lartë	Të diplomuar me arsim të mesëm
Bashkia Maliq	9	8	1
Totali	9	8	1

**Tabela 5.1.3: Potenciali Njerëzor sipas Sektorit dhe Nivelit Akademik i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të zonës dhe strehimit për Bashkinë Maliq (Burimi: Bashkia Maliq)**





Përsa i përket personelit ekzistues të Drejtorisë, gjykohet se është pjesërisht i mjaftueshëm për funksionimin e saj, nga aspekti i formimit shkencor, sipas sektorit të aktiviteteve, pasi të punësuarit, disponojnë eksperiencën dhe njohuritë për realizimin dhe rregullimin e të gjithë aktiviteteve të drejtorisë.

Përsa pajisjeve mekanike, Drejtoria e planifikimit të zonës dhe strehimit nuk është mjaftueshëm e pajisur përsa i përket mjeteve përkatëse. Theksohet se përsa i përket pajisjeve mekanike brenda ndërtesës (sisteme ngrohjeje, ajër i kondicionuar, mbrojtjeje nga zjarri, etj.), nuk janë depozituar të dhëna.

Në lidhje me pajisjet teknike, Bashkia disponon sistemet thelbësore të domosdoshme të kompjuterizimit, meqënëse ekzistojnë njëzet (20) kompjutera tavoline të shoqërisë HP, nëntë (9) kompjutera të shoqërisë DELL, katërmbëdhjetë (14) kompjutera të shoqërisë Fujitsu Siemens, gjashtëmbëdhjetë (16) kompjutera të shoqërisë Lenovo dhe tre (3) kompjutera të shoqërisë Asus, por që nuk janë të teknologjisë së fundit. Gjithashtu, sistemi funksional i kompjuterave është Windows 7 dhe Windows 10, ndërsa nuk janë dorëzuar të dhëna për programe (software) të tjera të disponueshme.

Përsa i përket pajisjeve të tjera, të cilat u referohen kryesisht kompjuterave, ekzistojnë gjashtëdhjetë (60) ekrane të markave të ndryshme.

Bashkia disponon dy programe prodhimi në gjuhën shqipe, njëri prej tyre për çështjet ekonomike dhe tjetri për taksat.

Përsa i përket telekomunikacioneve, në shërbimin e Bashkisë Maliq ekziston akses në internet për të gjithë kompjuterat me shpejtësi 50Mbps, por edhe lidhje me rrjetin publik. Nuk ekziston rrjet lokal ndërmjet kompjuterave të Bashkisë. Përsa i përket pajisjeve përkatëse, nuk janë depozituar të dhëna. Në përgjithësi, theksohet fakti se nevoja e optimizimit të kompjuterizimit të Drejtorisë së planifikimit dhe zhvillimit të zonës dhe e strehimit si edhe e të gjithë Bashkisë.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhëna në lidhje me vendosjet e ndërtesave, pajisjet mekanike dhe teknike si edhe programet kompjuterike të Bashkisë Maliq.

Pajisje Kompjuterike		
Lloji i pajisjes (Hardware, Periferike)	Numri	
Kompjutera	62 Deskop	
Ekrane	60	
Tastiera	N/A	
Maus kompjuteri	N/A	
Printerë	N/A	
UPS	N/A	
Lloji i pajisjes (Rrjet - Komunikacion)		
Modem	N/A	
Hub	N/A	





Pajisje Kompjuterike		
Akses në Internet	Po	N/A
Rrjet lokal	Po	
Lloji i pajisjes (Software)	Disponon	Numri i përdoruesve
WINDOWS 7	Po	7
WINDOWS 10	Po	2

Tabela 5.1.4: Vendosjet e ndërtesave – Pajisje mekanike – Informatizimi i Bashkisë Maliq (Burimi: Bashkia Maliq)

#### Të dhëna ekonomike

Shërbimi nuk ka buxhetin e vet. Financat e saj përshtihen në njësinë e mëposhtme të Kapitullit në fjalë, ku edhe formulohen Të Ardhurat dhe Shpenzimet e Bashkisë Maliq, në total. Theksohet se të dhënat përkoston e realizimit të aktiviteteve të Shërbimit Teknik nuk mund të përjashtohen për shkak se në Bilanc – Situacionet e rezultateve të përdorimit, kosto e realizimit shfaqet në total për të gjithë Bashkinë. Ndërkohë, nga të dhënat e mëposhtme duket se një pjesë e madhe e të ardhurave të Bashkisë përdoret për mbulimin e shërbimeve urbane dhe investimeve.

Në tabelat e mëposhtme paraqiten të dhëna në lidhje me gjendjen ekonomike (të ardhurat - shpenzimet) të Bashkisë së re të zgjeruar Maliq.

#### Të ardhurat

Në vitin 2016, Bashkia Maliq ka të ardhura/buxhet në vlerën prej 819.762.000 lekë. Respektivisht, në vitin 2017, të ardhurat/buxheti i Bashkisë ishte në vlerën prej 1.136.093,00 lekë, ndërsa paraqitet ndryshim vjetor i klasës prej 38,59% në lidhje me vitin e kaluar. Të ardhurat e Bashkisë për vitet 2016-2017 në total janë në vlerën prej 1.955.855.000 lekë.

Për 1000 leke

Bashkia Maliq	2016	2017	Totali 2016-2017	Totali 2016-2018
Të ardhura	819.762	1.136.093	1.955.855	38,59%

Tabela 5.1.5: Të ardhurat/ Buxheti i Bashkisë Maliq gjatë viteve 2016-2017 (Burimi: Bashkia Maliq)

Përsa i përket çështjeve ekonomike të Bashkisë, dhe në veçanti të të ardhurave, këto vijnë kryesisht nga të ardhurat nga taksat, të ardhurat nga shpërblimet, transfertat ndërqeveritare, si edhe të ardhurat nga burime të tjera.





Llojet e të ardhurave	Viti 2016	Përqindja % 2016	Viti 2017	Përqindja % 2017
Të ardhura nga taksat	42.928,00	5,24%	41.972,00	3,69%
Të ardhura nga shpërblimet	38.888,00	4,74%	47.307,00	4,16%
Transferta ndërqeveritare	643.917,00	78,55%	848.936,00	74,72%
Të ardhura nga burime të tjera	94.029,00	11,47%	197.878,00	17,42%
Total	819.762,00	100,00%	1.136.093,00	100,00%

Tabela 5.1.6: Të ardhurat e Bashkisë sipas llojit të të ardhurave gjatë viteve 2016-2017 (për 1000 leke)

Sic konstatojmë, të ardhurat nga 819.762.000,00 lekë në vitin 2016 ishin në vlerën prej 1.136.093.000,00 lekë në vitin 2017. Kjo rritje e madhe i detyrohet mos përthihjes së transfertave ndërqeveritare të vitit 2016, që sollën si rezultat transferimin e tyre në vitin 2017. Më analistikisht dhe përsa i përket llojit të të ardhurave dhe kontributit të tyre në të ardhurat totale, për vitin 2016, 78,55% e totalit të të ardhurave vjen nga transfertat ndërqeveritare, 5,24% nga të ardhurat nga taksat, 4,74% nga të ardhurat nga shpërblimet dhe 11,47% nga të ardhurat nga burime të tjera, si të ardhurat e trashëguara. Në vitin 2017, 74,72% e totalit të të ardhurave vjen nga transfertat ndërqeveritare, 3,69% nga të ardhurat nga taksat, 4,16% nga të ardhurat nga shpërblimet dhe 17,42% nga të ardhura nga burime të tjera, si të ardhurat e trashëguara. Të dhënat e sipërpermendura paraqiten edhe në diagramët që vijojnë, ku paraqitet gjithashtu ecuria e të ardhurave, si edhe përqindja e tyre e kontributit në totalin e të ardhurave për vitet respektive.




Diagrama 5.1.1: Të ardhurat e Bashkisë gjatë viteve 2016-2017






Diagrama 5.1.2: Të ardhurat e Bashkisë sipas llojit të të ardhurave gjatë viteve 2016-2017

Më poshtë paraqiten shpenzimet e Bashkisë gjatë viteve 2016 dhe 2017. Kategoritë kryesore të shpenzimeve i përkasin investimeve, pagave, shpenzimeve funksionale, sigurisë sociale, mbrojtjes sociale dhe transporteve.

Kategoritë e shpenzimeve	Për 1000 Leke			
	Viti 2016	Përqindja % 2016	Viti 2017	Përqindja % 2017
Shërbime të përgjithshme	132.498,00	16,16%	174.368,00	15,35%
Sektori parësor – transporte	182.124,00	22,22%	332.450,00	29,26%
Shërbime ndaj të tretëve	83.128,00	10,14%	189.908,00	16,72%
Shpenzime për shfaqje kulturore	7.855,00	0,96%	14.274,00	1,26%
Arsim	130.948,00	15,97%	137.013,00	12,06%
Shpenzime për politikën sociale	283.208,00	34,55%	288.079,00	25,36%
Total	819.761,00	100,00%	1.136.092,00	100,00%

Tabela 5.1.7: Shpenzimet e Bashkisë gjatë viteve 2016-2017

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se për vitin 2016 shpenzimet totale të vitit ishin në vlerën prej 819.761.000,00 lekë, ndërsa për vitin 2017 pati një rritje të madhe të shpenzimeve, për shkak të rritjes së buxhetit të investimeve, që pati si rezultat vlerën prej 1.136.092.000,00 lekë. Më analistikisht, përsa i përket vitit 2016 vëllimi kryesor i shpenzimeve i përket shpenzimeve të politikës sociale me përqindje totale prej 34,55%, vijon sektori parësor – transportet me përqindje 22,22%, arsimi





me përqindje totale 15,97% dhe vijojnë shërbimet e përgjithshme dhe investime të tjera. Përsa i përket viti 2017, vëllimi kryesor i shpenzimeve i përket sektorit parësor me 29,26%, vijojnë shpenzimet e politikës sociale me përqindje 25,36%, shërbimet ndaj të tretëve (strehim, zhvillim komunal, shërbimi i ujit) me përqindje totale 16,72%, dhe vijojnë shërbimet e përgjithshme, arsimi dhe investime të tjera. Rritje e rëndësishme e shpenzimeve vërehet në investimet për strehim dhe zhvillim bashkiak.




Diagrama 5.1.3: Shpenzimet e Bashkisë gjatë viteve 2016 - 2017

Duke krahasuar totalin e të ardhurave me totalin e shpenzimeve konstatohet se Bashkia Maliq bën balancim të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe kjo do të thotë se nuk mban rezerva.

Bashkia Maliq	2016	2017	Totali 2016-2017
Të ardhura	819.762,00	1.136.093,00	1.955.855,00
Shpenzime	819.761,00	1.136.092,00	1.955.853,00
Rezultati neto pozitiv	1,00	1,00	2,00

Tabela 5.1.8: Të ardhurat – shpenzimet e Bashkisë Maliq gjatë viteve 2016-2017 (për 1000 Lekë)






Diagrama 5.1.4: Rezultati neto pozitiv gjatë viteve 2016-2017

Duke marrë parasysh recessionin e përgjithshëm ekonomik të Organizmit të administratës Vendore të Bashkisë Maliq, në veçanti gjendja ekonomike e Shërbimit gjykohet si relativisht jo e kënaqshme.

Një prej faktorëve shkaktarë kryesore konsiderohet mungesa e input-eve që rrjedhin nga rëndesa ekonomike (detyrimet) e marrësve për ndërtimin dhe riparimin e trotuareve, mungesë e cila i detyrohet dobësisë ose mungesës së iniciativës për arkëtimin e tyre nga vetë Autoriteti Bashkiak. Përvec të tjerave, Drejtoria e Shërbimeve Teknike bën përpjekje për të shfrytëzuar sistematikisht thuajse të gjithë burimet e mundshme të të ardhurave, që lidhen me futjen në skema financiare dhe Programe të Qarkut, të vendit si edhe në programe të huaja (B.E., SHBA).

Drejtoria në fjalë nuk disponon metodë / mekanizëm sistematik për vlerësimin e efikasitetit të shërbimeve dhe aktiviteteve të saj. Përkundrazi, për madhësinë e efikasitetit duket se ekzistojnë vetëm vlerësime embriike, të cilat bazohen ekskluzivisht në kritere cilësore. E njëjtë gjë vlen edhe për përcaktimin dhe vlerësimin e përzierjes civile.

## 5.2. Zhvillimi i kapaciteve dhe marrëveshjet e zbatimit

### Përfundime – Propozime

Përsa i përket gamës së shërbimeve, shfaqen mungesa të pjesshme, edhe pse bëhen përpjekje të koordinuara për ofrimin e barabartë të shërbimeve për të gjithë qytetarët, pa dallime dhe kufizime. Këto mungesa bëhen më shumë të ndjeshme për individët me nevoja të veçanta (njëzet me aftësi të kufizuara), të cilët edhe pse përdorin shërbimet teknike në shkallë të mjaftueshme, për shkak të kushteve ekzistuese të qarkullimit, kalueshmërinë e kanë të vështirë ose të kufizuar në shumë pikë qëndrore të qytetit, ndërmjet të cilave edhe në Bashki, ku ndodhet edhe drejtoria në fjalë. Gjithashtu





regjistrohet shkallë relative e nën-sherbimit të të gjithë qytetarëve dhe të marrësve të tjerë të Sherbimit, për shkak të mos decentralizimit të sherbimeve të ofruara të Drejtorisë, që bën të pashmangshme nevojnë e pjesëmarrjes së prëdoruesve në hapësirat e Bashkisë.

Përveç mungesave të sipërpërmendura që konstatohen, në lidhje me sherbimin e mjaftueshëm të grupeve të marrësve nga Drejtoria në fjalë e Bashkisë Maliq, vërehen mungesa edhe në mbulimin e nevojave të qytetarëve.

Nga sa përmendet më sipër, është e dukshme mungesa e përcaktimit të qartë dhe të fokusuar – nga ana e Drejtorisë – e nevojave të veçanta të qytetarëve. Investigimi dhe regjistrimi i nevojave të marrësve dhe formulimi i imazhit të qartë për kërkesën e përgjithshme të sherbimeve të ndryshme teknike ndihmon në planifikimin racional të Sherbimit dhe në kryerjen sa më efikase të aktiviteteve të saj, me bosht kryesor përmirësimin e cilësisë së sherbimeve të ofruara.

Njëkohësisht, për sherbimin më të mirë të qytetarëve dhe të grupeve të tjera të përdoruesve të sherbimeve të Drejtorisë në fjalë, gjykohet e domosdoshme kryerja e drejtëpërdrejtë e një sërë ndërhyrjeve përmirësuese. Për shembull, duhet të gjenden hapësirat e përshtatshme urbane për sigurimin e vendeve të parkimit, të rehabilitohen problemet e qarkullimit, duke rishqyrtauar edhe një herë planifikimin e qarkullimit të qytetit, dhe të përmirësohen sipërfaqet e rrugëve brenda kufijve të Bashkisë. Njëkohësisht, duhet të bëhet mirëmbajtje në rrjetet publike rrugore, riparime të dëmeve në rrugë, përmirësimë në trotuare, që në disa raste thuajse nuk ekzistojnë fare, duke vështirësuar në këtë mënyrë lëvizjen e qytetarëve dhe të grupeve të sémura të qytetarëve. Duhet të ndërtohen facilitete të reja bashkëkohore sportive si edhe të forcohen ndjeshëm edhe në numër infrastrukturat e argëtimit dhe të gjelbërimit (sheshe, parqe, kënde lojërash për fëmijë, etj.). Në ndërhyrjet e rëndësishme me prioritet të drejtëpërdrejtë konsiston edhe kujdesi për lëvizjet e përditshme të individëve me nevoja të veçanta brenda rrjetit urban. Së fundmi, në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, duhet të bëhen përpjekje për riciklimin dhe ripërdorimin – shfrytëzimin e materialeve dhe për përmirësimin e gjelbërimit urban.

Nga ana e tyre qytetarët mund të marrin pjesë duke dhënë mbështetjen e tyre në përmirësimet e sipërpërmendura, duke kufizuar në mënyrë të rëndësishme përdorimin e automjeteve të tyre private, duke bërë ndarjen e mbeturinave në banesat e tyre dhe, mbi të gjitha, duke u kujdesur për mbrojtjen e gjelbërimit urban (ose jo).

Për vazhdimin e veprave, arritjen e qëllimeve, por, kryesisht për mbulimin e nevojave, kërkohen burime të cilët nuk janë gjithmonë të disponueshëm. Për këtë arsy, hartoher çdo vit Programi i veprave të priorititetit për çdo periudhë administrative (Programi Teknik Vjetor). Përveç zbatimit, ndërkohë, të këtij Programi, vazhdon që Sherbimin ta shqetësojë, si problemi kryesor i realizimit të veprave, vonesa në pagesa e urdhër-pagesave, fakt i cili sjell edhe vonesa të rëndësishme kohore në përfundimin e veprave. Vonesa në pagesa i detyrohet, mbi të gjitha, fluksit financiar jo të rregullt të programeve, por edhe problemeve të kreditimeve të disponueshme të Bashkisë Maliq.

Gjithashtu, rezulton një problem i rëndësishëm gjatë fazës së realizimit, në rastet kur vlera e financimit të veprave zhvillimore është më e vogël se ajo e parashikuar, duke sjellë si pasojë nevojnë e mbështetjes financiare nga burime bashkiakë.





Ashtu siç u përmend edhe në kapitullin e mëparshëm, duke patur parasysh mënyrën e funksionimit të problemeve tashmë ekzistuese, nuk ekzistonë hapësira përmirësimi të efikasitetit dhe efektivitetit të aktiviteteve të Shërbimit, pa rritjen e domosdoshme të burimeve. Faktor përcaktues do të jetë zbatimi i Sistemit të Administrimit nëpërmjet qëllimeve të matjes nga Drejtoria në fjalë, për vënien e qëllimeve më të sakta dhe të qarta dhe përcaktimin e "performancës" së qëllimeve.

Gjithashtu, gjyket i domosdoshëm zbatimi, nga ana e Drejtorisë në fjalë, e Sistemit të Administrimit EMAS, duke mbajtur të dhëna si për procedurat funksionale ashtu edhe administruese. Në kuadrin e zbatimit të Sistemit konkret, do të duhet të ekzistonë informimi i domosdoshëm i të gjithë të përfshirëve, por në përputhje me ato që parashikohen, do të duhet të kryhet kontroll nga një Audit i certifikuar.

Gjithashtu, pika kritike për përmirësimin e cilësisë dhe të efikasitetit të shërbimeve teknike përbëjnë nga njëra anë planifikimi dhe zbatimi i Sistemeve të Cilësisë, si ai i Çertifikimit të Mjaftueshmërisë Administrative të shërbimeve të Bashkisë dhe nga ana tjetër aktivizimi i njësisë së Kontrollit të Brendshëm. Theksohet se, në këtë drejtim, gjyket e qëllimshme dhe e domosdoshme mbështetja paralele e Shtetit në kuadrin e reformës administrative, që do të sjellë përshtypjen e procedurave që kërkojnë kohë. Në veçanti, rol të rëndësishëm ka kodimi tematik i dispozitave, ligjeve, urdhërave, etj, pa nevojën e nxjerrjes së qarkoreve sqaruese apo ndryshimeve, dhe regjistrimi i dispozitave të mëparshme.

Gjithashtu, do të duhet të parashikohen nga njëra anë procedura të shpejta të kryerjes dhe gjykimit të çështjes dhe nga ana tjetër venia e dënimive më të repta si për shembull përpushtimin arbitrar të pronës së paluajtshme komunale, administrimi dhe zgjidhja e të cilës do të dojë më shumë se një dyvjeçar.

Në rritjen e shkallës së kënaqësisë së qytetarëve do të kontribonte në mënyrë aktive përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të aktiviteteve të Drejtorisë në fjalë, që, siç u përmend edhe më lart, është i mundur, duke patur sigurisht parasysh disponueshmërinë e burimeve të domosdoshme, të zbatimit të Sistemeve të Cilësisë, aktivizimit të Njësisë së Kontrollit të Brendshëm si edhe të mbështetjes së shtetit.

Për më tepër, hapësira përmirësimi të procedurave funksionale të Drejtorisë mund të rezultojnë me vendosjen e sistemit të vlerësimit të shërbimeve, në bazë të indekseve të efikasitetit, mjet i cili do të ndeshet me probleme të rëndësishme, mbi të gjitha, pasi regjistrohen mungesa të rëndësishme parësore përsa i përket zbatimit të procedurave të programatizimit, ndjekjes dhe vlerësimit të veprimeve të Shërbimit në fjalë. Këto mungesa rezultojnë, por njëkohësisht edhe forcohen, nga problemet që shqetësojnë, jo vetëm Drejtorinë në fjalë, por të gjithë Organizmin e Vëtëadministratës Vendore të Bashkisë Maliq dhe i përkasin çështjeve të organizimit dhe administrimit, programatizimit, hierarikisë, prodhueshmërisë, koordinimit dhe komunikimit të brendshëm ndërmjet Sektorëve dhe, në përgjithësi, strukturës organizative.

Zgjidhja e problemeve të sipërpërmendura, zbatimi i sistemeve dhe metodave të përmirësimit të efikasitetit të procedurave funksionale të Shërbimit, si edhe administrimi / përballja e faktorëve ekzogenë (psh. vonesa në pagesa të urdhër-pagesave) që shkaktojnë probleme në realizimin dhe përfundimin e veprave, gjyket si pika kyçe të përmirësimit të cilësisë dhe efikasitetit të veprimtarive të Drejtorisë në fjalë, me bosht kryesor shërbimin më të mirë dhe më të shpejtë të qytetarit.





Përsa i përket komunikimit të Drejtorisë me marrësit e saj, theksohen pjesërisht mungesa. Përdoruesit e shërbimeve teknike (kontraktorë të Punëve Publike, furnitorë, etj.) informohen me të gjitha mënyrat ligjore të parashikuara në lidhje me shërbimet e ofruara dhe veprimet e parashikuara të Drejtorisë në fjalë. Për informimin e grupeve të marrësve në lidhje me çështje të përgjithshme, Drejtoria e Shërbimeve Teknike do të duhet të botojë Njoftime për Shtyp ose edhe çështje të Këshillit Bashkiak. Ndërkohë, regjistrohen mungesa në lidhje me informimin e të gjithë qytetarëve për llojet dhe numrin e shërbimeve të ofruara ose për vepra që janë në fazën e realizimit të tyre dhe, për pasojë, shkaktojnë probleme/acarime në lëvizjen e përditshme (psh. rrjete të reja rrugore, ndërtimë të reja, etj.). Për rrjedhojë, informimi i Veprës së prodhuar e Drejtorisë në fjalë, përbën prioritet për Bashkinë, kryesisht për informimin e qytetarëve për mosfunkcionet emergjente brenda rrjetit urban.

Nga ana tjetër, përsa i përket informimit të Shërbimit në lidhje me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve, do të duhet të rekomandohet Zyra e Shërbimit të Qytetarëve, me qëllim që të ekzistojë zgjidhje e çfarëdolloj problemi dhe kërkeze të qytetarëve brenda një periudhe kohore të logjikshme, duke patur njëkohësisht parasysh mundësinë e "pjesëmarrjes" së marrësve – qytetarëve në procesin e marrjes së vendimeve të Shërbimit. Për shembull, në rastet e Veprave – Veprimeve të mëdha, në lidhje me buxhetin dhe rëndësinë e tyre, Bashkia Maliq do të duhet të zhvillojë procese këshillimi.

Përsa i përket organizimit dhe strukturës së Drejtorisë në fjalë, kërkohet një riorganizim, për shkak të decentralizimit të kompetencave, përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të ofruara dhe shërbimit më të mirë të qytetarëve.

Më konkretisht, Drejtoria do të duhet të vijojë me krijimin e zyrate dhe sektorëve të mëposhtëm në kuadrin e vënies së qëllimeve për nevojat e shërbimit dhe të efikasitetit:

- Zyra e Drejtorisë,
- Zyra e Sigurisë së Kalueshmërisë për personat invalidë
- Sektori i Programatizimit të Zhvillimit – Cilësisë dhe Efikasitetit
- Sektori i Veprave Teknike – Kadastrës - Shërbimeve
- Sektori i Mjedisit
- Sektori i Urbanistikës
- Sektori i Planifikimit të Trafikut dhe Rregullimeve
- Sektori i Veprave Elektromekanike dhe Zbatimeve Energjike
- Sektori i Poshteve - Pemëve
- Sektori i Furnizimeve

Theksohet nevoja e krijimit dhe funksionimit të Zyrave dhe Sektorëve të sipërpërmendur për shkak të decentralizimit të kompetencave, përmirësimit të efikasitetit dhe efektivitetit të aktiviteteve në funksion dhe forcimit të veprimeve të kujdesit social të Bashkisë. Për më tepër, funksionimi i tyre është me rëndësi të madhe për përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të të gjitha veprimeve të Organizmit të Vetëadministrimit Vendor. Gjithashtu, theksohet se mund të ekzistojë bashkim i sektorëve të sipërpërmendur, në varësi të nevojave dhe burimeve të disponueshme të drejtorisë në fjalë.

Në kuadrin e organizimit të gjerë të Bashkisë, rol të rëndësishëm kanë bashkëpunimet e Drejtorisë me entete jashtme, përfundimin më të shpejtë të çështjeve dhe problemeve. Në vija të përgjithshme,





nuk shfaqen probleme në koordinim, gjatë bashkëpunimit të Drejtorisë së Shërbimeve Teknikë me Entet e sipërpermendura. Ndërkohë, ndonjëherë gjatë bashkëpunimeve, kryesisht të Drejtorisë me Entet e sektorit publik, regjistrohen, edhe pse jo në shkallë të rëndësishme, probleme konfuzioni të kompetencave, kryesisht, gjatë procesit të marrjes së vendimeve. Këto probleme supozohen në bazë si të shumëllojshmërisë dhe kompleksitetit të aktiviteteve ashtu dhe të shumëllojshmërisë së kuadrit të paqartë ligjor, elementë që shqetësojnë të gjithë Sistemin e Vetëadministratës Vendore dhe të Administratës Publike.

Sic u përmend edhe në kapitullin e mëparshëm, në përputhje me kërkesat që përcaktohen nga Ligji 07/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar; Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të zonës dhe strehimit e Bashkisë Maliq, i përmbush pjesërisht kushtet e kërkuara.

Nevoja më bazë, përsa i përket personelit të Drejtorisë, fokuson mbulimin e pozicioneve organike boshe me personel dinamik, sic parashikohet në legjislacionin në fuqi. Përveç këtyre, gjykohet gjithashtu e nevojshme plotësimi i drejtorisë me kuadro të lartë të Administratës, të cilët nga njëra anë disponojnë specializim shkencor të dokumentuar dhe të konsoliduar dhe nga ana tjetër njohuri dhe eksperiencë në marrjen teknike të vendimeve.

Përsa i përket personelit ekzistues të Drejtorisë, gjykohet i mjaftueshëm për funksionimin e saj, pasi të punësuarit, disponojnë eksperiencën dhe njohuritë e duhura për përfundimin dhe rregullimin e të gjithë aktiviteteve të saj. Ndërkohë, gjykohet emergjente nevoja e trajnimit të vazhdueshëm për personelin, dhe madje, në Programe të specializuara të formimit shkencor sipas sektorit të kompetencave. Duhet të nijhet si pikë kyçe riorganizimi për Shërbimin, mbi të gjitha, nga drejtuesit politikë dhe pas faktorëve të shërbimit, përmirësimi i personelit, për arritjen e të cilit rol përcaktues ka pjesëmarrja e rregullt e personelit në programe trajnimë.

Më poshtë paraqiten programet e trajnimit, të cilat do të ndihmojnë në mënyrë përcaktuese në përmirësimin e funksionit të Drejtorisë:

- Programe në çështje konkursesh për furnizimet dhe vepra
- Programe kompjuterizimi dhe ruajtje të arkivës
- Programe mësimi dhe formimi të programeve të veçanta logistike (ArcGIS, AutoCAD, CorelDRAW, Adobe Photoshop, MS Office, SCADA kllrt.)

Përsa i përket infrastrukturave të ndërtesave dhe atyre materiale-teknike të Drejtorisë në fjalë, theksohet nevoja e mirëmbajtjes së faciliteteve ekzistuese si edhe përmirësimi i tyre nëse kërkohet, në periudha të rregulla kohore. Më konkretisht, theksohet nevoja e mirëmbajtjes së ndërtesës në pjesën e brendshme dhe të jashtme (lyerje) dhe mirëmbajtja e kornizave të dritareve (në pjesën e brendshme dhe të jashtme), të cilat do të ndihmojnë në ekonomizimin e energjisë dhe për pasojë në reduktimin e shpenzimeve të Bashkisë. Gjithashtu, vlerësohet me prioritet të drejtëpërdrejtë konfigurimi i hapësirave ekzistuese të shërbimit ose edhe përdorimi i një hapësire të re brenda ndërtesës, nëse kjo kërkohet, me qëllim që të arrihet modernizimi i mjedisit të punës dhe të konsolidohet prodhueshmëria e shërbimit, dhe gjithashtu të mbulohen nevojat kryesore të arkivimit.

Sic u përmend edhe në kapitullin e mëparshëm, nuk ekziston mjaftueshmëri përsa i përket automjeteve të shërbimit për rregullimin e kompetencave të drejtorisë. Për këtë arsy, gjykohet e domosdoshme





blerja e automjeteve të shërbimit, të reja ose të përdorura, sipas nevojave të shërbimit. Më konkretisht, është emergjente blerja ose marrja me qira e automjeteve të mëposhtme:

1. Automjete shërbimi për pasagjerë që do të përdoren për lëvizjen e të punësuarve të shërbimit
2. Automjete shërbimi 4X4 për transportin nga vendi ku do të zhvillohen punimet
3. Kamionë për transportin e materialeve të ndërtimit
4. Ekskavator
5. Kamionë ngarkim-shkarkim
6. Transformatorë
7. Ngarkues

Theksohet se, karakteristikat teknike dhe numri i automjeteve të shërbimit përcaktohen në bazë të nevojave, si edhe të burimeve të disponueshme të shërbimit.

Përsa i përket pajisjeve teknike të drejtorisë në fjalë, gjyket e domosdoshme blerja e kompjuterave të teknologjisë së fundit dhe e pajisjeve të tjera periferike, si printerë, makineri shumëfunksionale, plotter etj., si edhe e pajisjeve që ndihmojnë në aksesin më të shpejtë në internet (Router – Modem). Gjithashtu, gjyket e domosdoshme blerja e lejes së përdorimit të programeve të reja logistike dhe përmirësimi i botimeve të fundit për llojet ekzistuese të programeve logistike.

Më poshtë, paraqitet tabela me pajisjet teknike që kërkoohen përfundimtarisht racionale për funksionimin racionale të Drejtorisë.

PAJISJE TEKNIKE	
Lloji i pajisjes	
Kompjutera të teknologjisë së fundit (përfshihen pajisjet e tjera periferike si tastierë, maus, ekran)	
Server	
Printerë	
Pajisje me shumë funksione	
Telefona	
Router - Modem	
Plotter	
GPS	
UPS	
USB - Flash për ruajtjen e materialeve – Hard Disk i jashtëm	
Programe logistike	
MS WINDOWS 2010	
MS Office 2007 është 2010	
ArcGIS	
AutoCAD	
CorelDRAW	
Adobe Photoshop	
Adobe Acrobat Reader	
SCADA	

Tabela 5.2.1: Pajisjet teknike që kërkoohen përfundimtarisht racionale





Përsa i përket kostos së investimeve për rindërtimin e Bashkisë dhe të Drejtorisë së Veprave Publike, Administrimit Territorial dhe Kontrollit, nga të dhënat e mbledhura, është e kuptueshme se Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të zonës dhe strehimit e Bashkisë Maliq në pesëmbëdhjetë vjeçarin e ardhshëm do të ketë nevojë për të rinovuar dhe plotësuar pajisjet mekanike, si edhe gjithashtu për të rinovuar pajisjet kompjuterike.

Duke patur parasysh se analiza jonë bëhet në bazë të pesëmbëdhjetë vjeçarit, në vijim do të duhet të përcaktohen nevojat e Bashkisë dhe në veçanti të Drejtorisë së Planifikimit Hapësinor dhe Kontrollit të Projekteve Investuese, përsa i përket si potencialit njerëzor ashtu edhe infrastrukturave materiale-teknike, për të gjithë spektrin kohor të analizës. Përsa i përket pajisjeve teknike (Hardware, Software, pajisje të tjera) si kompjutera, Laptop, printerë, UPS etj., mund të themi ato kanë një cikël jete pesëvjeçar, pasi pas përfundimit të pesëvjeçarit pajisjet konsiderohen të vjetra dhe kanë nevojë për instalim me qëllim që të mund t'u përgjigjen nevojave të çdo bashkie.

Sic është analizuar tashmë, investimet e parashikuara gjatë periudhës kohore 2020-2034 pritet të janë në vlerën nga 1.863,978 milionë Lekë në 925,900 milionë Lekë.





Anjetim	Buxheti	I: 20		II: 21-22		III: 23-29		IV: 30-34		
		2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
Sistemim urbane	267.800.000	144.000.000	59.400.000	59.400.000	3.000.000	2.000.000	2.000.000	2.000.000	2.000.000	2.000.000
Infrastruktura Ruugore	1.164.803.000	321.867.000	137.419.500	137.419.500	31.097.000	31.000.000	31.000.000	31.000.000	31.000.000	31.000.000
Infrastruktura e ujësjellësit & kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Infrastruktura Vaditëse dhe Kullues	235.169.000	105.189.000	0	0	19.500.000	19.500.000	19.000.000	19.000.000	19.000.000	19.000.000
Infrastruktura energjetike	1.000.000	0	500.000	500.000	0	0	0	0	0	0
Infrastruktura e menaxhimit të mbeturinave	130.000.000	40.000.000	10.000.000	10.000.000	10.000.000	10.000.000	10.000.000	10.000.000	10.000.000	10.000.000
Infrastruktura Sociale	1.120.023.000	513.873.000	117.075.000	117.075.000	37.400.000	37.400.000	36.400.000	35.900.000	35.500.000	34.000.000
Përmirësim i administratës	9.500.000	0	0	1.500.000	1.500.000	1.500.000	1.500.000	1.500.000	1.500.000	1.500.000
Mjedisi, natyra dhe kulturor	173.500.000	0	5.170.000	5.170.000	16.820.000	16.815.000	15.815.000	15.765.000	15.765.000	15.765.000
Zhvillimi i ekonomik	486.000.000	40.200.000	43.700.000	42.600.000	53.300.000	52.800.000	52.300.000	52.200.000	49.700.000	46.600.000
Mbrojtjen civile & Rendi publik	8.000.000	0	4.000.000	4.000.000	0	0	0	0	0	0
Total	3.615.815.000	1.165.129.000	377.264.500	376.164.500	171.015.000	169.015.000	168.015.000	167.365.000	166.965.000	166.365.000

Tabela 5.2.2: Investime të parashikuara në Bashkinë Maliq gjatë pesëmbëdhjetë vjeçarit të ardhshëm





Duke patur parasysh,

1. Potencialin njerëzor gjatë pesëmbëdhjetë vjeçarit të ardhshëm, pritet të forcohet dhe të zëvendësohet me potencial të ri, me kualifikime të rritura dhe konsiderohet diçka e sigurt se veprimi në fjalë do të sjellë një rëndesë shtesë të klasës 10%-12%, element i cili do të formulohet në vazhdim.
2. Pajisjet mekanike kërkojnë konsolidim dhe rinnovim, dhe konsiderohet fakt se gjatë pesëmbëdhjetë vjeçarit të ardhshëm, do të duhet të ekzistojë një cikël i plotë rinnovimi i pajisjeve në fjalë, fakt i cili do të sjellë një rëndesë shtesë të klasës 7%-8% në investimet e bashkive në fjalë.
3. Pajisjet kompjuterike, siç është regjistruar dhe zhvilluar edhe më lart, pritet të zëvendësohen gjatë pesëmbëdhjetë vjeçarit të ardhshëm, të paktën tre herë, duke patur parasysh kohëzgjatjen e jetës së tyre për shkak të intesitetit të teknologjisë, kanë një kohëzgjatje pesë vjeçare.
4. Infrastrukturat e ndërtesave, kërkojnë rinnovim ose edhe zëvendësim dhe strategjia në fjalë gjatë pesëmbëdhjetë vjeçarit të ardhshëm, është fakt se do të sjellë nevojën e investimeve edhe në këtë sektor.

Paralelisht me investimet e sipërpërmendura, shpenzim i rëndësishëm do të konsistojë edhe rinnovimi i personelit me personel të ri, që do të ketë më shumë kualifikime, fakt i cili do të përmirësojë shërbimet e ofruara të bashkive, por do të rrisë edhe koston funksionale të bashkisë.

Në tabelën paraqitet rritja në fjalë e kostos funksionale dhe e potentialit njerëzor gjatë pesëmbëdhjetë vjeçarit të ardhshëm.

SHPËRBLIME & SHPENZIME PËR PERSONELIN E BASHKISË MALIQ			
	SASIA	VLERË E NJËSISË	SHUMA E SHPENZIMIT
2020	4	9.700	38.800 €
2021	4	10.185	40.740 €
2022	2	10.694	21.389 €
2023	3	11.229	33.687 €
2024	3	11.790	35.371 €
2025	4	12.380	49.520 €
2026	4	12.999	51.996 €
2027	2	13.649	27.298 €
2028	1	14.331	14.331 €
2029	1	15.048	15.048 €
2030	1	15.800	15.800 €
2031	1	16.590	16.590 €
2032	1	17.420	17.420 €
2033	1	18.291	18.291 €
2034	2	19.205	38.411 €
<b>TOTALI</b>			<b>434.691 €</b>

**DËSHMI:** Konsiderojmë se shpenzimet e personelit do të janë në vlerën përkatëse të totalit të Bashkisë Maliq në vitin e bazës në vlerën prej 38.000 €, do të rriten çdo vit në vlerën 5% gjatë gjithë kohëzgjatjes së viteve që kemi përllogaritur. Kjo rritje do të vijë si për shkak të rritjes së shpërblimeve, ashtu edhe për shkak të rritjes së numrit të personelit, për shkak të punësimit.

Tabela 5.2.3: Parashikimi i shpenzimeve të personelit për shkak të rinnovimit të tij





Në kuadrin e riorganizimit të përgjithshëm të Bashkisë Maliq, propozohet krijimi i sektorëve të veçantë përsa i përket strukturës organizative të Bashkisë Maliq. Më konkretisht, propozohet krijimi i:

- Sektorit të Prodhimit Bujqësor dhe Informimit të Fermerëve
- Qendrës së Shërbimit të Qytetarëve
- Sektorit të Kujdesit në distancë (mund të inkadrohet në sektorin e Kujdesit Social)
- Sektorit të Turizmit

Sektorët e sipërpërmendur janë me rëndësi të madhe për Bashkinë Maliq dhe krijimi i tyre do të kontriubojë në decentralizimin e kompetencave të Bashkisë, në përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të aktiviteteve ekzistuese dhe në konsolidimin e veprimeve të kujdesit social të Bashkisë Maliq dhe në përgjithësi në përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të të gjitha veprimeve të Organizmit të Vetëadministratës Vendore.

Në kuadrin e organizimit të gjerë të Bashkisë, është me rëndësi kërkimi i bashkëpunimeve të sektorëve të propozuar me entet e jashtme, për përfundimin më të shpejtë të çështjeve, sipas rastit.





## ANEKS

### 1. DIREKTIVAT/ToR PËR PLANIN SEKTORIAL

#### HYRJE- ZONA E STUDIMIT

Bujqësia përbën burim të rëndësishëm të ardhurash dhe punësimi për banorët e Bashkisë Maliq. Gjithashtu, ajo identifikohet nga aspekti historik me ecurinë e Bashkisë dhe përbën një tipar karakteristik tradicional të saj. Kushtet e tokës së zonës në varësi të klimës kontrubojnë në krijimin e sipërfaqeve bujqësore pjellore, ndërsa potenciali njerëzor (aftësi, eksperiençë, sipërmarrje) dhe infrastrukturat (e transportit, të ujitjes) ndihmojnë në mënyrë aktive në zhvillimin e aktivitetit bujqësor. Sipërfaqja fushore, pjesë e fushës së madhe të Korçës, përshkohet nga lumi Devoll dhe ka një sipërfaqe rrëth 15.200 hektarë.<sup>3</sup> Identifikohen sipërfaqe të mëdha të tokës së kultivuar, si pemë frutore, si edhe kultura të lërueshme (psh. grurë, misër, blegtorale). Në pjesën malore të Bashkisë sipërfaqet bujqësore dhe aktiviteti bujqësor ndeshen në shkallë më të vogël në krahasim me pjesën fushore të Bashkisë.

Problemet kryesore lidhen me madhësinë e fushave që shpesh është e vogël, ndërsa ka mundësi që fushat e një pronari të ndodhen të shpërndara në vende të ndryshme. Gjithashtu, fusha të caktuara janë të paarritshme për shkak të mungesës ose të gjendjes së keqe të rrjetit rrugor rural. Së fundmi, në pikën më të ulët të fushës nuk arrihet drenazhim i mirë, duke sjellë si rezultat që fushat të përmbyten shpesh dhe të mos mund të kultivojen.

Fusha përshkohet nga rrjeti rrugor SH3, element i cili favorizon kalueshmërinë dhe transportin e produkteve. Rrjeti i ujitjes përfshin shumë rezervuarë dhe një gjatësi të madhe kanalesh të hapura ujitjeje dhe drenazhimi, por që në shumë raste duhet mirëmbajtje ose/dhe rindërtim.

Një nga qëllimet strategjike të Bashkisë, në përputhje me PPV është zhvillimi i integruar i sektorit të bujqësisë dhe përpunimit të produkteve bujqësore. Në këtë kuadër propozohet hartimi i Planit Sektorial në nivel Bashkies (PSNB) i udhëzuar nga parimet e zhvillimit të qendrueshëm.

#### QËLLIMSHMËRIA DHE RESULTATE TË PRITSHME TË PLANIT SEKTORIAL

Qëllimi i PSNB është zhvillimi i qëndrueshëm i aktivitetit rural, në të gjithë Bashkinë, dhe në zonat malore dhe fushore. Objektivat më specifikë janë:

- Rritja e konkurrueshmërisë dhe ekstraverzimit dhe zgjerimi i tregjeve të reja
- Sigurimi i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore
- Zhvillimi i balancuar territorial
- Reduktimi i papunësisë dhe krijimi i vendeve të reja të punës
- Edukimi / trajnimi i palëve të interesuara në të gjithë zinxhirin e prodhimit bujqësor (psh. kultivuesë, përpunuesë, tregtarë)
- Promovimi dhe zbatimi i metodave dhe mjeteve bashkëkohore dhe të reja në të gjithë zinxhirin e prodhimit bujqësor.

<sup>3</sup> Burimi: Plani Operacional i Zhvillimit Vendor, 2016





Rezultatet e pritshme të cilat rezultojnë pas hartimit të PSNB për zhvillimin rural, përfshijnë përmirësimin e cilësisë së jetës së fermerëve dhe më gjerë të komuniteteve rurale, forcimin dhe zhvillimin e ekonomisë vendase, tërheqjen e sipërmarrjeve të reja dhe investimeve dhe krijimin e vendeve të reja të punës, si edhe përmirësimin e gjendjes së burimeve natyrore (psh. tokës, ujë).

Propozohet që të paraprihet studimi i propozuar nga PPV dhe regjistrimi i regjimit të pronës në mënyrë që rezultatet e saj të mund të përdoren në PSNB dhe të lehtësojnë punën e tij.

### PËRMBAJTJA E STUDIMIT

Studimi i PSNB për zhvillimin rural duhet të bazohet në kuadrin ligjor ekzistues dhe të jetë në harmoni të plotë me dispozitat dhe parashikimet e tij, ndërsa gjithashtu duhet të marrë parasysh kuadrin më të gjerë të projektimit, strategjitet kombëtare përkatëse që janë në fuqi (psh. për zhvillimin rural, ujin) dhe propozimet dhe kushtet e PPV për Bashkinë.

Do të ishte mirë që studimi të koordinohet me PSNB përkatëse të Bashkisë Devoll, nëse nuk është i mundshëm hartimi i përbashkët i tyre, që përbën zgjedhjen më të mirë për shkak të karakteristikave të përbashkëta dhe maksimalizimit të përfitimeve.

Studimi do të hartohet në tre fazë. Pas se cilës prej tyre, do të vijojë këshillimi, gjatë të cilit do të synohet sa më shumë të jetë e mundur pjesëmarrje e gjerë: autoritetet përgjegjëse për çështjen në fjalë (Ministrirë, Qarku, Bashkitë) dhe OJQ që lidhen me këtë çështje, sipërmarrësit që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vend dhe të të gjithë banorëve.

Në fazën e parë do të realizohet analiza dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese dhe i problemeve që identifikohen në Bashki. Në veçanti, në këtë seksion studiohen:

- Vendi i bujqësisë në ekonominë kombëtare dhe rajonale
- Karakteristika të tokës bujqësore
- Madhësia e fermave dhe ndarja e tyre në hapësirë për çdo pronar (nëse ka të dhëna)
- Numri dhe madhësia e sipërfaqeve bujqësore të braktisura – jo pjellore
- Llojet e kulturave dhe madhësitet e prodhimit
- Metodat dhe mënyrat e kultivimit
- Inputet bujqësore: karakteristika cilësore dhe sasiore
- Tregtia dhe marketingu i produkteve bujqësore
- Ujitja dhe kullimi
- Siguria ushqimore dhe standartet
- Këshillimi, kërkimi, transferimi i teknologjive dhe informacioni bujqësor
- Mbështetja financiare për bujqësinë
- Tipare dhe tendenca zhvillimore kryesore
- Analiza e rrjetit të aktorëve të sektorit
- Analiza SWOT dhe shfrytëzimi i sektorit

Në fazën e dytë paraqiten qëllimet strategjike, përparësitetë dhe masat e kërkuara që rezultojnë në përpunje me ecuritë e analizës dhe vlerësimit të realizuar në fazën e parë. Në veçanti, do të përfshihen si mëposhtë vijon:





- Objektivat e përgjithsme
- Ruajtja dhe përmirësimi i tokës bujqësore – shfrytëzimi i tokës bujqësore të nënvlërësuar – jo pjellore
- Përmirësimi i tokës bujqësore të nënvlërësuar – jo pjellore
- Përmirësimi i prodhimit të produkteve bujqësore
- Përmirësimi i përpunimit dhe tregtimit të prodhimeve bujqësore
- Diversifikimi i fermave dhe aktiviteteve alternative
- Promovimi dhe zbatimi i risive dhe transmetimi i dijeve
- Çertifikimi i produkteve bujqësore vendase dhe kriimi i një identiteti të përbashkët unik, që do t'i bëjë këto produkte të njoitura në treg
- Forma dhe mënyra bashkëpunimi të të gjithë pjesëmarrësve në zinxhirin agroushqimor brenda dhe jashtë Bashkisë
- Forma dhe mënyra informimi – trajnimi i të gjithë pjesëmarrësve në zinxhirin agroushqimor
- Përmirësimi – modernizimi i infrastrukturës mbështetëse
- Menaxhimi i burimeve të ujit për bujqësinë me fokus mbulimin e nevojave për ujite dhe ekonomizimin e ujit
- Administrimi i rrezikut dhe futja e masave parandaluese për përballjen e shkatërrimeve natyrore dhe të tjera.

Së fundmi, faza e tretë përfshin listën përfundimtare të veprave në shkallë hierarkike dhe të dokumentuara si dhe kushtet e zbatimit të studimit:

- Mjete dhe procedura zbatimi
- Kosto dhe burime financimi të nevojshme për zbatim
- Organizimi dhe kontrolli financier dhe kronik
- Kategorizimi hierarkik dhe ndërlidhja e veprave
- Monitorimi i planit në zbatim

Raporti teknik do të shoqërohet me raportet teknike dhe tabelat/diagramet e nevojshme. Përbledhja hartografike do të përfshijë harta me prezantim të përgjithshëm të rrjetit, lidhjet, elementë cilësorë etj.

## KRONODIAGRAMA

Kronodiagrama për realizimin e PSNB për Zhvillimin Rural përllogaritet brenda 6 muajve të kohës së studimit dhe ndahet si më poshtë vijon:

FAZA I – Regjistrimi, analiza dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese: 3 muaj

FAZA II – Formulimi i strategjisë për zhvillimin e qëndrueshëm rural të Bashkisë dhe përcaktimi i Programit të Veprimit: 2 muaj

FAZA III: Formulimi i strategjisë përfundimtare dhe hartimit të zbatimit: 1 muaj

Periudha kohore për këshillimin publik pas përfundimit të dy fazave të para përcaktohet çdo herë brenda 15 ditëve, ndërsa për miratimin e studimit pas fazës së tretë brenda 1 muaji.





FAZA DHE VEPRIME TË VEÇANTA	MUAJ
	<b>FAZA 1</b>
Analiza dhe vlerësimi i gjendjes aktuale	
Përfundime - SWOT	
Këshillimi	
	<b>FAZA 2</b>
Qëllime strategjike, Akse përparësie dhe Masa	
Programi i Veprimit	
Këshillimi	
	<b>FAZA 3</b>
Kushte të zbatimit të studimit – programatizimi dhe financimi i veprave dhe veprimeve	
Miratimi i studimit	





## 2. DIREKTIVAT/ToR PËR PDV

### STUDIMI: Zona Ekonomike

#### Hyrje

Në vitet e mëparshme bashkia e Maliqit kishte një aktivitet të theksuar industrial, kryesisht në përpunimin e produkteve bujqësore. Mirëpo, me kalimin e kohës dhe pas ndryshimeve socio-ekonomike që kanë ndodhur në Shqipëri, aktiviteti industrial u ndodh në recession me pasojë shumë biznese të ndalojnë aktivitetin e tyre. Pjesa më e madhe e rezervës industriale shtetërore mbetet e pashfrytëzuar.

Duke u bazuar në planifikimin territorial në nivel kombëtar (PPK) dhe lokal (PPV) dhe duke marrë parasysh prodhimin bujqësor dhe potencialin e tij për zhvillim të mëtejshëm, propozohet të organizohet një zonë ekonomike, e cila të dallohet, nga njera anë nga specializimi dhe inovacioni, dhe nga ana tjetër nga performanca më e mirë mjedisore. Për këtë qëllim, është e nevojshme të përgatitet një PDV, siç parashikohet nga PPV e miratuar e Bashkisë.

#### Synimi/ Qëllimi i Studimit

Qëllimi i organizimit dhe zhvillimit të një zone ekonomike me theks në sektorin agro-ushqimor është:

- Nxitja e ekonomisë dhe aktivitetit të investimeve në Basjhki dhe më gjërë.
- Forcimi i extraversionit dhe konkurrencës të Bashkisë.
- Krijimi i vendeve të reja të punës.
- Përmirësimi i promovimit të produkteve vendore dhe rritja e eksporteve.
- Përmirësimi i një zone urbane joaktive dhe të degraduar.

Nga promovimi i sipërmarrjes rurale të shëndetshme dhe inovative përmes zhvillimit dhe zbatimit të PDV-së për zonën ekonomike, do të përfitojë jo vetëm Bashkia, por edhe e gjithë zona e Korçës. Do të krijohen biznese të reja, të ardhurat lokale do të rriten dhe niveli i trajnimit dhe edukimit të burimeve njerëzore lokale, kryesisht, por jo vetëm, do të përmirësohet në lidhje me përpunimin e produkteve bujqësore. Gjithashtu, do të krijohet një identitet i ri prodhues për Bashkinë dhe si rrjedhojë do të fuqizohet identifikueshmëria e saj.

#### Rajoni i Studimit

Zona ekonomike e propozuar është e vendosur në zonën e vjetër industriale të qytetit Maliq, që ndodhet në veriperëndim të tij, në kufijtë e strukturave urbane dhe pranë lumit Devoll. E vendosur në një distancë të shkurtër nga autostrada kombëtare SH3, me të cilën është e lidhur me një rrugë që anashkalon qendrën dhe gjithë zonën urbane Maliq-Libonik, duke e bërë zonën lehtësish të aksesueshme. Sipërfaqja e përgjithshme e zonës ekonomike të propozuar është 13.46 Ha. Në zonë gjenden mjaft ndërtesa industriale të braktisura si dhe disa objekte që aktualisht funksionojnë dhe do të ruhen. Përveç kësaj, një pjesë e zonës ekonomike do të strehojë një muze për trashëgiminë industriale të Bashkisë dhe një sërë ndërhyrjesh për ta bërë këtë zonë një marrës biznesi të qëndrueshëm. Infrastruktura themelore (energjia, telekomunikacioni, furnizimi me ujë të pijshëm ) ekziston, përf





ndërhyrjet janë të nevojshme për modernizimin dhe kompletimin e pajisjeve të zonës me infrastrukturë bashkëkohore dhe inovative.



*Zona ekonomike në qytetin Maliqit*

### Përbajtje të studimit

#### 1. Dokumenti për analizën e zonës

Studimi i PDV për krijimin e zonës së re ekonomike, duhet të jetë plotësishët në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues si dhe të marrë parasysh planifikimin më të gjerë hapësinor, përkatësisht planet kombëtare sektoriale dhe propozimet e PPV të bëra për Bashkinë.

Do të bëhet një analizë dhe vlerësim i situatës aktuale. Në më shumë detaje, studimi do të përfshijë:

- Kuadrin më të gjerë hapësinor dhe ligjor.
- Përshkrimi i zonës së studimit (kufijtë e pronave, statusi pronësisë) dhe caktimi i kufijve të zonës ekonomike.
- Përshkrim i detajuar i situatës aktuale të zonës e cila do të përfshijë:
  - Aktivitetet ekonomike aktuale: objekti, lloji dhe sasia e prodhimit, mënyra e disponimit, etj,
  - Karakteristikat e fuqisë punëtore
  - Analiza e zinxhirit të prodhimit
  - Përdorimi i tokës

Organizimi i trafikut në zonë dhe zonën përreth - mënyra e qasjes

Infrastruktura teknike ekzistuese

Cilësia e ndërtesave ekzistuese dhe diagnostikim i nevojave për mirëmbajtje/ rinovim/ restaurim





- Gjendja e peizazhit dhe mjedisit dhe problemet me të cilat ballafaqohet.
- Vlerësimi i ndërhyrjeve të mëparshme - prezantimi i shembujve dhe praktikave të ngjashme, lokale apo më gjërë.
- Eksplorim Gjeologjik: Të kontrollohet përshtatshmëria gjeologjike e zonës së studimit, me qëllim që të shënohet nëse toka është e përshtatshme, e papërshtatshme ose e përshtatshme nën disa kushte, me qëllim për të siguruar mjedis të strukturuar nga rreziqet natyrore ose rreziqet që vijnë nga ndërhyrjet dhe aktivitetet e njeriut.

Raporti teknik i studimit duhet të shoqërohet me tabelat e nevojshme dhe grafikët të cilët do të ilustrojnë elementet kryesore të analizës.

Baza kartografike do të përfshijë të paktën si më poshtë vijon:

- Harta të shkallës 1:500 deri 1:1.000, ku do të reflektohet situata aktuale, parcelat e tokës, përdorimet ekzistuese të tokës, ndërtesat dhe infrastruktura (rrjete të ujësjellësit, energjisë, rrugëve, etj), kufijtë, përmasat dhe emërtimet.  
Këto harta do të shoqërohen edhe nga tabela kadastrale ku do të shënohet pronësia aktuale.
- Përveç kësaj do të dorëzohen edhe harta, në të cilat do të përkruhen përshtatshmëria e tokës dhe gjendja ndërtesave ekzistuese.
- Është e nevojshme që raportin teknik të shoqërohet edhe me analiza fotografike e zonës së studimit.

## 2. Strategjia e zhvillimit të zonës

Bazuar në analizën dhe vlerësimin e situatës aktuale, zhvillohet strategjia e propozuar për zonën e ndërhyrjes, ku specifikon, drejton, plotëson rekomandime të PPV. Identifikohen objektivat strategjike dhe specifike dhe identifikohen zona, fushat në të cilat studimi do të ndërhyjë.

## 3. Propozime me përkufizime territoriale

Do të përfshihen propozime në lidhje me zhvillimin e parkut blegtoral:

- Propozimet për përdorimet e propozuara të tokës dhe funksionet/aktivitete lejuara, te kushtezuara dhe ndaluara.
- Propozimet për infrastrukturën e nevojshme: rrjete rrugore, rrjete të furnizimit me ujë, rrjete të kanalizimet, rrjetet të zjarrfikësave, rrjete të ndriçimit elektrik, sisteme të ujitjes së gjelbër, impiante të trajtimit të ujërave të zeza, menaxhim energetik, ndërtesë për administratën e sipërmarrjeve të parkut, etj.
- Propozimet për zona të përbashkëta (p.sh. parqe të gjelbëta, hapësira për parking, trotuare) dhe infrastrukturën sociale (p.sh. ndërtesë të administratës, stacion për zjarrfikëse, ekspozita produktesh, hapësira për organizimin e prezantimeve). Shënohet se duhet të sigurohet qasje barabartë dhe e pavarur për të gjithë.
- Vendndodhjet e propozuara të ndërtesave dhe vëllimet e tyre indikative.
- Mënyra e aplikimit të instrumenteve per drejtimin e zhvillimit.





#### 4. Rregullorja e PDV-së

Në Rregullore do të duhet të përbahet:

- Shpjegimet e kodeve që do të përdoren për kategoritë/nënkatgoritë/funkzionet e përdorimit të tokës, sistemet dhe kategori të tjera.
- Do të duhet të përcaktohen dhe analizohen kushtet dhe variablat e zhvillimit (p.sh. intensiteti, distanca, lartësia maksimale, parcela minimale, etj.) dhe të vendosen vijat e ndërtimit.
- Rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe peizazhit, në mënyrë që të sigurohet se zhvillimi i propozuar nuk do të ndikojë negativisht.
- Përcaktimi i zonës së mbrojtjes së elementeve ujore që gjenden në zonën e studimit.
- Të drejtat dhe kufizimet, siç ato burojnë nga kuadri i propozuar i zhvillimit.
- Rregullat për rrjetin rrugor dhe rrjetin e transportit. Do të duhet të përcaktohen kategoritë e rrjetit rrugor, karakteristikat e tyre teknike dhe të përcaktohen parametrat e lëvizshmërisë dhe transportit.

Së fundi, do të duhet të ketë përdorim të lirë të ambienteve edhe nga persona me aftësi të kufizuara.

Harta dhe informacionin gjeohapësinor të integruar në platformën GIS (në përputhje me standardin e Regjistrat Kombëtar të Planifikimit të Territorit).

#### 5. Plani i veprimit

Do të përfshijë: analizën e kostos, grafikun e zbatimit të projekteve, propozimet për stimujt për tërheqjen dhe instalimin e bizneseve dhe treguesit për monitorimin e projektit.

#### Afatet e punës dhe ndarja në fazë

Afati kohor për zbatimin e PDV llogaritet në 3 muaj dhe studimi do të hartohet në një fazë të vetme. Vazhdon procedura e konsultimit me kohëzgjatje 1 mujore, gjatë së cilës depozitohen në çfarëdo mënyre të përshtatshme vërrrete dhe komente nga Bashkia, Qarku dhe të gjitha palët e interesit si dhe banorët dhe biznesmenët e Qarkut. Më pas, Autoriteti Kontraktor jep udhëzimet përfundimtare mbi përshtatjen e studimit dhe, brenda 20 ditëve nga dërgimi i tyre Kontraktuesit, bëhen dorëzimet përfundimtare, në format elektronik dhe të printuar. Pason procesi i miratimit bazuar në legjislacionin aktual dhe publikimi në RKPT.

#### Profillet e Ekspertive, kushtet dhe detyrat

Për hartimin e këtyre PDV-ve nevojitet një Grup Pune i përbërë nga të paktën këto ekspertë:

- Arkitekt/ Planifikues urban
- Inxhinier/ Ekspert transporti
- Inxhinier Ndërtimi
- Inxhinier Topograf

Ekspert Mjedisi (me licencë mjedisi)

Ekonomit (me eksperiencë në çështje të Planifikimit Urban)





Konsulenti, duhet të sigurojë një grup kompakt, me eksperiencia të ngjashme, i aftë në realizimin eficent të qëllimit të punës të këtyre Termave të Referencës.

Konsulenti duhet të dëshmojë:

- aftësi në adresimin e çështjeve kryesore nga një këndvështrim multi-disiplinor;
- njohje të mirë të territorit, veçanërisht të zonave rurale, dhe problematikave përkatëse.

Planet e Detajuara Vendore do të hartohen në bazë GIS, ndaj Konsulenti duhet të sigurojë dhe një njohje të mirë të programeve bazë dhe eksperiencia në punë të ngjashme.

Konsulenti, për një përshkrim më të mirë të qasjes ndaj kësaj detyre të shprehur në këto terma reference mund të paraqesë staf tjetër mbështetës gjatë fazës së Propozimit Teknik.

Përbledhja e stafit duhet të japë të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e personave që do të angazhuar për të hartuar çdo PDV dhe kohën që secili prej ekspertëve do të shpenzojë në këtë punë.





## STUDIMI: «Zona Urbane»

### Hyrje

Profil i Bashkisë Maliq karakterizohet nga zona të shpërndara të zhvillimit të strehimit të organizuar. Dendësia dhe intensiteti më i lartë identifikohet në selinë e Bashkisë, në qytetin Maliq, ku është e përqendruar shumica e popullsisë dhe aktiviteteve ekonomike. Megjithatë, nuk ka vazhdimësi homogjene të strukturës urbane. Në veçanti, polet e zonave të banimit janë përgjithësisht të vendosura në kufijtë e qytetit dhe përqendrimi më intensiv i banesave dhe aktiviteteve ndodhet përgjatë SH3 dhe rrjetit tjetër rrugor, me më shumë intnsitet në zonën rreth nyjes për në Maliq-Libonik. Prandaj, ajo ka një formë lineare të theksuar dhe është e shpërndarë. Vlen të përmendet se kufijtë ekzistues të aprovuar të vendbanimeve janë të parregullta dhe nuk lejojnë hapësirë për zhvillimin e mëtejshëm të banimit në zonat e pa strukturuara. Si rrjedhojë, situata aktuale tregon dobësi në zhvillimin e strukturës urbane, si dhe pamundësi për të shfrytëzuar përfitimet lokale.

Rol kryesor në zhvillimin e Bashkisë zë zhvillimi ekonomik dhe ai urban, duke krijuar mundësi të reja për rivitalizimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Bashkisë. Në këtë kontekst, parashikohet që organizimi urbanistik i Bashkisë të integrojë zona më të gjera, me potencial zhvillimi si të rrjetit rezidencial, po aq edhe për krijimin një poli atraktive për aktivitete dhe publikun. Së bashku me promovimin e zonës breglumore, synohet krijimi dhe promovimi i mjediseve rekreative dhe rezidenciale që synojnë homogenitetin e strukturës urbane në selinë e Bashkisë dhe multifunksionalitetin e përdorimeve. Një mjet i përdorur në këtë drejtim është zgjerimi i kufirit të zonës rezidenciale në selinë e Bashkisë Maliq, nëpërmjet përpilimit dhe miratimit të Planit të Detajuar Vendor (PDV).

### Synimi/ Qëllimi i Studimit

Përgatitja e studimit të PDV-së për shtrirjen e sistemit urban në zonën urbane Maliq-Libonik ka për qëllim të paraqesë përfitimet nga zbatimi i planit urban të zgjeruar, si dhe të vlerësojë qëndrueshmërinë e tij. Objktivi kryesor është të integrohen në mjedisin urban zona të cilat do të ndihmojnë në përbushjen e nevojave të ardhshme të vendbanimeve dhe mirëpritjen e aktiviteteve të reja ekonomike dhe sociale, duke u përqendruar në rolin e qytetit si qendër urbane dhe ekonomike e Bashkisë, por edhe si një qendër rajonale rurale. Në të njëjtën kohë, me këtë ndërhyrje synohet :

- Zhvillimi urban i balancuar i qytetit sipas parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm hapësinor.
- Krijimi i standardeve të larta të banimit dhe qëndrueshmërisë për banorët.
- Përmirësimi i cilësisë së jetës të banorëve duke balancuar shpërndarjen e aktiviteteve dhe shërbimeve sociale.
- Rritja e multifunksionalitetit dhe atraktivitetit të selisë për të tërhequr një rrymë të re vizitorësh.
- Krijimi i zonave urbane që rrethojnë qendrën e qytetit dhe lejojnë zhvillimin përtëj akseve ekzistuese lineare.
- Përmirësimi i kushteve të lëvizshmërisë, organizimi i aktiviteteve rekreative dhe sportive dhe promovimi i pasurive natyrore dhe kulturore të zonës.

Përmirësimi dhe forcimi i infrastrukturës ekzistuese dhe të propozuar brenda zonës së urbanizuar dhe promovimi i ndërtimit.





Përfitimet që rrjedhin nga përgatitja dhe zbatimi i PDV për zgjerimin e zones rezidenciale në bashkinë Maliq bazohen në forcimin dhe zhvillimin e ekonomisë lokale, rritjen e fisionomisë së rajonit dhe mbrojtjen e mjedisit.

### Rajoni i Studimit



Zona e re urbane- Zona e argëtimit

Zona e zgjerimit të kufirit të banimit të propozuar për planifikim urban, është e vendosur në pjesën verilindore të qytetit Maliq, afër hyrjes së vendbanimit Libonik. Segmentet hapësinore ku do të zbatohen politikat e zgjerimit, ndodhen mbi aksin kryesor rrugor SH71, ndërsa nga veriu kufizohen me lumin Devoll. Bëhet fjalë për një zonë që shtrihet në rreth 10.5 hektarë tokë, me një pozicion të veçantë nodal në qendër të qytetit, të arritshëm nga të gjitha menyrat e transportit dhe nga çdo anë. Fqinjësohet në perëndim me një seksion të zonës rezidenciale, ndërsa në lindje të saj ndodhet një zonë e pastrukturuar e përdorur për kultivim të produkteve bujqësore. Zona nuk i përket kufijve të strukturës ekzistuese urbane dhe është e mbuluar nga sistemi natyror dhe bujqësori, ndërkohë që një pjesë e saj paraqet aktivitete sportive, sigurisht me organizim jo të plotë. Kjo pjesë e qytetit ka shumë potenciale të pashtfrytëzuara, që e bëjnë të pamjaftueshëm promovimin e zonës, dhe në të njëjtën kohë degradohet pamja e zonës bregore për shkak të mungesës së planifikimit të duhur. Propozimi për urbanizimin e këtyre sektioneve, mundëson përmirësimin e zones, nëpërmjet organizimit të përmirësuar të banimit dhe ngritisës së aktiviteteve të reja mikpritëse, rekreative dhe sportive.





## Përbajtje të studimit

### 1. Dokumenti për analizën e zonës

Studimi i PDV për një zonë të veçantë zgjerimi duhet të jetë plotësish në përputhje me kornizën ekzistuese ligjore, si dhe të marrë parasysh planifikimin më të gjerë hapësinor, përkatësisht planet kombëtare sektoriale dhe propozimet e PPV të hartuara për Bashkinë. Prioritet do t'i jepet çdo veprimi të ndërmarrë për zbatimin e projekteve përkatëse që do të realizohen paralelisht, të trajtohen në vazhdimisi në interes të përdoruesve të kësaj zone dhe publikut të gjërë. Në të njëjtën kohë, projektin bazohet në përdorimet e lejuara të tokës sic janë përcaktuar dhe planin urbanistik analog. Në kontekstin e zbatimit të zgjerimit dhe të politikave të rigjenerimit urban, përdoren instrumente si integrimi, urbanizimi dhe transferimi i të drejtës për zhvillim.

Fillimisht, studimi do të përbajë një plan të detajuar të menaxhimit, i cili do të përshkruajë objektivat kryesore të studimit, si dhe objektivat e zbatimit të projektit, duke iu referuar gjithashu rëndësisë së konsultimit me komunitetin gjatë procesit të hartimit.

Përvec kesaj, pjesë integrale e studimit është shqyrtimi i karakteristikave të zonës dhe burimeve në dispozicion. Në këtë pikë do të kryhet një analizë dhe vlerësim i situatës aktuale. Në më shumë detaje, studimi do të përfshijë:

- Kuadri më i gjerë hapësinor dhe ligjor.
- Përshkrimi i zonës së studimit (kuftjtë e pronave, statusi pronësisë) dhe caktimi i kufijve të zonës ekonomike.
- Përshkrim i detajuar i situatës aktuale të zonës e cila do të përfshijë:
  - Aktivitetet ekonomike aktuale: objekti, lloji dhe sasia e prodhimit, mënyra e disponimit etj,
  - Përdorimi i tokës
  - Organizimi i trafikut në zonë dhe zonën përreth - mënyra e qasjes
  - Infrastruktura ekzistuese teknike
  - Situata ekzistuese e peizazhit më të gjerë dhe mjedisit, si dhe identifikimi i problemeve
  - Vlerësimi i ndërhyrjeve të mëparshme - paraqitura e shembujve dhe praktikave të ngjashme
  - Studim gjeologjik për të testuar përshtatshmërinë gjeologjike të zonës së studimit, për të përcaktuar nëse toka është e përshtatshme, e papërshtatshme ose e përshtatshme në kushte të caktuara për të krijuar një ambient të strukturuar. Shqyrtohen mundësítë përrreziqe natyrore apo rreziqe që vijnë nga aktivitetet dhe ndërhyrjet e njeriut.
  - Raporti teknik i studimit duhet të shoqërohet me tabelat e nevojshme dhe grafikët të cilët do të ilustrojnë elementet kryesore të analizës.

Baza kartografike do të përfshijë të paktën si më poshtë vijon:

- Harta të shkallës 1:500 deri 1:1.000, ku do të reflektohet situata aktuale, parcelat e tokës, përdorimet ekzistuese të tokës, ndërtimesat dhe infrastruktura (rrjete të ujësjellësit, energjisë, rrugëve, etj), kuftjtë, përmasat dhe emërtimet.

Reto harta do të shoqërohen edhe nga tabela kadastrale ku do të shënohet pronësia aktuale.





- Përveç kësaj do të dorëzohen edhe harta, në të cilat do të përshkruhen përshtatshmëria e tokës dhe gjendja ndërtesave ekzistuese.

Është e nevojshme që raporti teknik të shoqërohet edhe me analiza fotografike të zonës së studimit.

Gjithashtu, shqyrtohen çështje të rëndësishme të planifikimit, harmonizimit me politikat dhe praktikat e menaxhimit të mjedisit publik urban dhe mbrojtjes dhe rehabilitimit të mjedisit natyror.

Së fundi, janë përcaktuar objektivat, veprimet e propozuara dhe treguesit e performancës. Do të propozohet një program pune për organizimin e të gjitha projekteve dhe veprimeve.

## 2. Strategjia e zhvillimit të zonës

Në bazë të analizës dhe vlerësimit të situatës aktuale, zhvillohet strategjia e propozuar për zonën e ndërhyrjes, duke përcaktuar, menaxhuar dhe përbushur rekomandimet e PPV. Baza për strategjinë e zhvillimit të rajonit, është rivitalizimi i zonave urbane përmes krijimit të objekteve rekreative dhe sportive, duke promovuar vlerat natyrore dhe kulturore. Qëllimi përfundimtar është që të gjitha këto të japid një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së jetës të banorëve. Strategjia e zhvillimit të zgjerimit të qytetit Maliq është një instrument për planifikimin dhe zbatimin, duke përshkruar mënyrën me të cilën qyteti do t'u japë përparësi përpjekjeve të tij për të përbushur nevojat afatshkurtra dhe afatgjata të strehimit. Studimi për këtë shkak përcakton disa strategji udhëzuese për arritjen e objektivave të dëshiruara:

- Përmirësimi i atraktivitetit të qytetit
- Investimi në zonën e studimit, me zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, të orientuara drejt turizmit, veçanërisht në fushën e mikpritjes dhe rekreacionit
- Shfrytëzimi i avantazheve natyrore dhe lokale
- Promovimi i shërbimeve plotësuese sociale me interes kulturor dhe sportiv

## 3. Propozime me përkufizime territoriale

